



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



TRANSKRIPT

**I mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 22.03.2018,
me fillim në orën 10:00.**

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës!

Para se të fillojmë me rendin e ditës, a ka dikush të thotë diçka lidhur me rendin e ditës?

Urdhëro, z. Gashi!

Fadil Gashi: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam një propozim, që pika e nëntë “Pyetje dhe përgjigje”, të dalë si pikë e parë e rendit të ditës, për shkak se na kanë ardhur do drejtorë të ri, të cilët nuk i kemi parë që ter muaj ditë edhe ka kërkesa të mëdha për pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi: Faleminderit!

Po, z. Halim Halimi.

Halim Halimi: Unë e kam një propozim, që seancat kur të caktohen në ora dhjetë apo kur do qoftë, me filluar me kohë, mos të udhëhiqemi me praktika të këqija, nuk kemi nevojë ta presim askënd, të gjithë e dinë se në ora dhjetë fillon edhe me e filluar seancën me kohë, e jo tash është ora dhjetë e gjysmë, se ne kemi edhe punë të tjera, nuk jemi të lidhur vetëm me Kuvend, kështu që i planifikojmë punët.

Ju kisha lutur, për herëve të tjera të gjithë të kemi parasysh, edhe ju si kryesues të keni parasysh kohën, kur të thuhet në ora dhjetë me filluar, në orën dhjetë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Keni të drejtë, nuk besoj se ka qenë dukuri kjo deri sot, por sot, për arsye të caktuar, d.m.th. kemi qenë në mbledhje të Bordit më herët, në rregull, e pranoj si vërejtje.

Po, z. Migjen.

Migjen Shala: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kërkoj që në rendin e ditës të futet edhe një pikë e rendit të ditës, “Sheshi “Adem Jashari””.

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, shkojmë me propozimin e parë, që pika “Pyetje dhe përgjigje” të kalojë në fillim, d.m.th. menjëherë pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit.

Kush është për?

Konstatojmë se më 38 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, futet si pikë e rendit të ditës pika “Pyetje dhe përgjigje”.

Faleminderit shumë!

Propozimi tjetër ishte që të futet si pikë e rendit të ditës “Diskutim për sheshin “Adem Jashari””.

Kush është për?

Urdhëro, z. Nushi!

Nol Nushi: Është e çuditshme nëse themi vetëm ta fusim si pikë të rendit të ditës sheshin “Adem Jashari”, me treguar pak se çfarë pike e rendit të ditës ose çfarë ka me u diskutuar.

Kryesuesi: Urdhëro, Egzon Azemi!

Egzon Azemi: Besoj se është e rëndësishme për me u diskutuar për këtë çështje, pasi që, nëse për asgjë tjetër, me marr informacione, me bërë pyetje ndaj personave përgjegjës këtu. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, ajo që thotë z. Nushi mendoj se është e arsyeshme, sepse edhe këtu thotë se duhet me qenë çështje urgjente dhe duhet me e pasur një arsye për me u futur në rend të ditës. A mundesh me e arsyetuar, Migjen, të lutem!

Migjen Shala: Shiko, në bazë të informacioneve që kam nga mediat që i kemi dhe portalet e ndryshme, e kemi parë që ka filluar rregullimi i sheshit “Adem Jashari”. Vendimi për sheshin “Adem Jashari” është marr në vitin 2005 nga kjo asamble, po ashtu edhe për sheshin “Ibrahim Rugova”.

Sheshi “Adem Jashari” nga ish-udhëheqjet e kaluara të Komunës nuk është marr parasysh, ka filluar tash. Aty është një problem, është trekëndëshi, që simbolizon bashkim-vllaznimin.

Shesh “Adem Jashari” nuk mundet me u quajtur asnjë shesh pa shtatore të Adem Jasharit. Po e qesim shtatoren e Adem Jasharit, mirëpo trekëndëshi simbolizon ish-komunizmin Bashkim-vllaznimin, janë dy kahe, dy rrugë të tjera.

Andaj unë kërkoj të futet në rend të ditës, të informohemi, t’i bëjmë pyetjet, është këtu edhe kryetari, dhe të gjithë të na e sqarojnë se si e parashohin sheshin “Adem Jashari”, të na e tregojnë projektin edhe çka mendojnë për të.

Këto dy sende janë të kundërta, kjo është dashur të kryhej më herët, me u ngritur shtatorja, me u rregulluar sheshi, edhe nëse nuk ka mundësi ky trekëndësh të hiqet. Pasi nuk është në UNESCO, ky trekëndësh mund të hiqet, merret vendim nga Komuna, nga asambleja apo drejtoria, si e parasheh ligji këtu në Komunë.

Kështu që unë në lidhje me këtë, pasi i përfaqësoj edhe vlerat e luftës, desha me hap diskutimin këtu në Asamble dhe të informohemi dhe të bisedojmë për hollësitë pikë për pikë lidhur me këtë çështje.

Unë mendoj se është urgjente, pasi që kanë filluar punimet, edhe t'i diskutojmë dhe t'i japim një kahe.

Edhe parafolësi më herët e tha shumë mirë, që tha të informohemi çka është në pyetje me këtë shesh.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Urdhëro, Genc Sherifi!

Genc Sherifi: Përshëndetje për të gjithë!

Edhe unë do të isha "pro" për të diskutuar këtë çështje, por me një mbledhje tjetër ose këtë çka e kërkoj Migjeni mundemi në pikën e dytë të rendit të ditës, në "Pyetje dhe përgjigje".

Nuk e pash se është aq urgjente siç e tha Migjeni.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë, diskutues të tjerë nuk ka, e hedh në votim arsyetimin që e tha z. Shala.

Kush është për, që të futet si pikë e rendit të ditës?

Atëherë, më 29 vota për, 10 kundër, 2 abstenime edhe 10 që nuk kanë votuar, futet në rend të ditës edhe pika e propozuar nga z. Shala.

Le të jetë kjo pika e nëntë, në vend të pikës "Pyetje dhe përgjigje".

Faleminderit shumë!

Po, urdhëro, Leutrim Rretkoceri!

Leutrim Rretkoceri: Përshëndetje për të gjithë.

Lidhur me rendin e ditës, që e kemi të gjithë sot para vetes, Grupi parlamentar i PDK-së kërkon që pikat 3, 4 dhe 5, që është "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme" të zhvendosen për një seancë tjetër dhe të jetë seancë e veçantë, ku do t'i diskutojmë rrjedhimisht të gjitha këmbimet e pronës së paluajtshme, në mënyrë që të mos diskriminohen edhe qytetarët e tjerë që janë në pritje për këmbim të pronës së paluajtshme me pronë komunale.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

A e kemi drejtorin këtu?

Urdhëro, drejtor!

Dren Kukaj: Vetëm për informatë, këto janë rastet të cilat na i sjellim këtu për të vetmen arsye, e ajo është që të mos bllokohen iniciativat për ndërtim kolektiv në Prishtinë. Rrjedhimisht, në saje të nevojave të lejeve të ndërtimit neve i realizojmë këto këmbime, duke plotësuar edhe nevojat e planeve rregulluese. Unë jam i vetëdijshëm që shumë qytetarë kanë çështje të pazgjidhura me Komunën e Prishtinës në raport me pronat e tyre private, mirëpo ne jemi në përgatitje e sipër që për problemet e përbashkëta të cilat i kemi identifikuar, t'u ofrojmë zgjidhje të përbashkëta.

Besoj që unë kisha me qenë i gatshëm që të diskutoj lidhur me këto probleme në një seancë të veçantë, mirëpo, për informatën e juaj, këto janë raste të tilla, pra lejet ndërtimore të cilat janë të bllokuara, sepse çështjet e pronave i kanë të pazgjidhura për shkak se prona publike brenda atyre hapësirave nuk e lejojnë dhënien e lejeve ndërtimore. Rrjedhimisht, ne i këmbejmë me pronat tjera dhe i realizojmë planet rregulluese. Kjo është natyra e këtyre këmbimeve.

Unë ju kisha sugjeruar që ti votoni, në të kundërtën, për mua nuk është që kam ndonjë interes që me çdo kusht të ju shtyjë që ju t'i votoni këto.

Nëse ju e ndani shqetësimin me ne, të mos ngelin të pezulluara iniciativat për ndërtime kolektive, në rregull, nëse jo, unë nuk kam ndonjë shqetësim edhe nëse shtyhet për ndonjë seancë tjetër, mirëpo natyra e këtyre lëndëve është kjo.

E nëse keni shqetësime për pronarët e pronave private të cilat kanë ngelur pa u shpronësuar përgjatë kohës, unë jam i gatshëm që jo vetëm këtu, por në secili forum të diskutojmë ndonjë herë tjetër. Mirëpo ta keni parasysh, kjo është natyra e këtyre rasteve, pra janë rastet të cilat marrin pëlqim paraprak prej dy drejtorive, edhe ne si Drejtori e Pronës e sjellim në Asamble për aprovim.

Kjo ishte vetëm për informatën e juaj që mos të ketë hamendje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Urdhëro, z. Agim Gashi!

Agim Gashi: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Nuk po duket racionale që këto pika të shtyhen, do të ishte shumë e arsyeshme kërkesa që të diskutohet për kërkesat tjera në çiftë se ka dyshime se ka vonesa, ka ta them qasje të çfarëdo lloj natyre në atë aspekt. Pajtohem që të diskutohet në një seancë tjetër ajo pikë e rendit të ditës, por jo këto të shtyhen, sepse edhe ashtu u tha se janë të grumbulluara këto kërkesa, e po më duket padrejtësi ndaj këtyre që kanë bërë kërkesa që këto të shtyhen për shkak të një dileme të mundshme të kësaj natyre.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Urdhëro, Eman Rrahmani!

Eman Rrahmani: Meqë u hap kjo tema e pronave pak një qasje më ndryshe, nuk e di Dreni a ka qenë në fushatë apo jo, por ne në Lëvizje ky ka qenë bashkë me neve dhe gjatë gjithë

kohës e kemi proklamuar që do të ndalet kompensimi i pronave me pronë komunale edhe do të fillohet me kompensim për sipërfaqe ndërtimore.

Nuk e di pse duhet me filluar ne tash, qysh në fillim të mandatit, me punuar kundër atyre që i kemi premtuar edhe me ju jap prona komunale, kur për neve është shumë e nevojshme t'i ruajmë ato prona të cilat i kemi. Është e mundshme me ju jap sipërfaqe ndërtimore e jo me ju jap pronë komunale, atyre kur duhet të iu merret prona për shkak të interesave publike.

Kryesuesi: Faleminderit, Eman!

Po, drejtor.

Dren Kukaj: Eman, kështu puna është, se janë disa forma të kompensimit.

Ne e kemi trashëguar një vendim të administratës, d.m.th. përkatësisht kryetarit para Shpendit, d.m.th. të Isa Mustafës, të cilin ende e mbajmë në fuqi. Përmes atij vendimi ne kemi të drejtë deri në masë të caktuar, që kështu, si me thënë me jap hava, pra leje shtesë për metra shtesë ndërtimor edhe me marrë tokë, këtë gjë e bëjmë përgjatë gjithë kohës, atë nuk e sjellim në Asamble. Mirëpo ka raste të tilla që aktualisht nuk ka asnjë mundësi tjetër jashtë këtyre këmbimeve, edhe ne meqë aty janë si të them 7- 8 parcela apo dhjetë parcela të pronarëve privatë të gatshëm që të hyjnë në ndërtim, është një rrip i vogël pronë komunale, ajo është pengesë aktualisht që të zhvillohet ndërtimi aty. Rrjedhimisht, ne e këmbejmë atë pronë që është brenda aty me një pronë tjetër private jashtë, e cila me plan rregullues ka për destinim një shfrytëzim publik.

Mirëpo unë jam i vetëdijshëm që ky këmbimi tokë me tokë, të cilin e kemi problematizuar deri më tash, e kemi bërë vetëm në raste të tilla, jemi të vetëdijshëm që humbasim, mirëpo në fund të ditës vlera e tyre përcaktohet prej Ministrisë e jo prej nesh, pra vlerën financiare të këmbimeve e përcakton Ministria.

Në raport me këtë çështje, ne jemi në përfundim të një rregulloreje, të cilën kemi me e sjellë këtu para jush, e cila thotë "pronat e tilla tash e tutje do të futen në ndërtim".

Ne tash më e kemi përcaktuar një formulë, ku nëse kemi raste kur është prona e jonë publike në hapësira ndërtuese, me një formulë ku e ruajmë interesin publik, ne do ta fusim në ndërtim atë tokë, rrjedhimisht edhe do të marrim banesa, njësi të veçanta banesore aty apo edhe lokale afariste.

Mirëpo për këtë çështje do ju informojë.

Unë jam shumë i gatshëm që t'i problematizojë të gjitha ato çështje në Drejtori të Pronës, për të cilat po më vjen mirë që po i paraqitni sot, për shumicën prej tyre besoj se kemi zgjidhje, e për ato që nuk ka zgjidhje, nuk ka zgjidhje sepse çështja e pronave, nuk e di a i keni parë zgjedhjet ndonjëherë në Shqipëri, në çdo parë zgjedhje, një prej çështjeve kryesore janë pronat.

Ne ende jemi në një stade që akoma nuk i kemi as të problematizuara, e çdo iniciativë për t'i problematizuar për mua është e mirëseardhur, mirëpo besoj se duhet me iu kushtuar një kujdes më i veçantë, e jo me trajtuar këtu në kohën kur diskutojmë për pika të rendit të ditës.

Unë jam i gatshëm në secilin forum me diskutuar për to.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Dren!

Replikë.

Urdhëro, Eman Rrahmani!

Eman Rrahmani: Problemi është, Dren, që ne po fillojmë me një pretendent jo të mirë qysh me vazhduar. Nuk mundemi ne, p.sh. tre pronarëve me ju bërë kompensim tokë me tokë, kurse të tjerëve kompensim me hapësirë ndërtimore.

Nuk mundemi dikujt me i marr tokë në Matiqan e mi jap tokë në qendër, është disi e palogjikshme kjo, pastaj secili ka me vazhduar edhe ka të drejtë qytetari mos me ta pranuar hapësirën ndërtimore, por donë me iu kompensuar me tokë.

Kryesuesi: Drejtori e ka fjalën.

Urdhëro, Dren!

Dren Kukaj: Qëllimi është që të mos bllokohet ajo iniciativë. Pra, aty munden me qenë 7-8 familje, një investitor që ka me përfituar diçka, do banorë që kanë me e gjetur një banesë kanë me e blerë, ky është ai interes i atyre, këto raste janë të përbashkëta, e këto raste i trajtojmë kësisoj.

Tash, nëse ju nuk e ndani këtë shqetësim, në rregull, a po kupton, për mua janë, nëse janë raste të tilla që krijohen përgjatë rrugës, janë shqetësuese nuk jam për me i bllokuar, jam me i zhbllokuar, tash nëse doni me i bllokuar në rregull, i bllokojmë, unë po e paraqes qëndrimin tim.

Kryesuesi: Replikë, ka të drejtë edhe njëherë.

Urdhëro, Eman!

Eman Rrahmani: Nuk jemi duke e bllokuar, Dren, mos e përdor këtë fjalë "bllokim" çdo të dytën fjalë, e parafundit, jemi duke bërë zgjidhje e jo bllokim, është zgjidhje, por zgjidhje të barabartë për të gjithë, e jo për dikën tokë e për dikën hapësirë ndërtimore. Nuk kemi me e bllokuar as këtë, nëse është nevoja kemi me e votuar, por ajo çka është, është se duhet të jemi për të gjithë të barabartë edhe mos të fillojmë me procedura tjera e me vazhduar me procedura tjera.

Nesër keni me pasur plotë ankesa se nuk donë hapësira ndërtimore, edhe kanë arsye edhe ligjore, edhe çfarëdo me u ankuar për shkak që ti dikujt po i jap tokë e dikujt hapësirë ndërtimore, këtu është problemi.

Nuk jemi duke të bllokuar, mos u tut, rri lirë.

Dren Kukaj: Jemi njerëz të pjekur edhe besoj se kuptohemi. Unë po them krejt i trajtojmë barabartë, secili rast që është i ngjuar kësisoj, e trajtojmë barabartë në këtë formë, kërkojmë ta zhbllokojmë përmes Asamblesë komunale, nuk po shoh mungesë të barazisë këtu, barabartë i trajtojmë të gjithë.

Tash, kush e ka fatin ta bëjë një marrëveshje biznesore aty, cilat familje në cilat parcela, atë nuk e përcaktojmë ne, ato marrëveshje që na vijnë, i trajtojmë, thash se të gjitha i trajtojmë barabartë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Fjalën e ka Sami Boroci.

Sami Boroci: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, asamblastë kolegë!

Unë po dua me u lidhur me propozimin, se na pa dashur ndoshta veç rrëshqitëm në temë, me propozimin e Leutirimit, ne si grup nuk pajtohemi që këto tri pika me u shtyrë për një seancë tjetër.

Ne jemi dakord që këto pika me mbetur në këtë rend të ditës, mirëpo kemi shumë komente sa i përket procesit në raport me këto pika, për të cilat do t'i japim kur të arrin rendi i tyre, mirëpo ne po propozojmë që këto pika me mbetur pjesë e rendit të ditës.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Urdhëro, z. Shefki Gashi!

Shefki Gashi: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Është interesant se gjërat po përsëriten dhe çështja e këtij këmbimit është një çështje ekskluzive e rezervuar për strukturat e Komunës, jo vetëm sot, por ka vite të tëra, 40-50 vite, kush i ka pasur punët mirë, ka mundur me bartur tokën prej Shkabajve me e pru në Velani apo Dragodan. Kthehuni pak në arkiv dhe hyni e këqyrini, zakonisht personat e njëjtë edhe në qeverinë e LDK-së, edhe në qeverinë e juaj, edhe në të tjerat gati njerëzit e njëjtë këmbajnë prona, qysh, tek, unë nuk e di, por duhet të hetohet.

Tjetra, është kah bëhet një diskriminim i paparë, drejtor, dhe besoj se ke ti raste që ka 10-15 vjet që ka aplikuar edhe nuk mundet me e lëvizur ndërtimin çoftë kolektiv, çoftë ka mbetur aty edhe nuk e prekni hiq. Nuk po dua me hy aty, se mundeni me thënë se ndoshta kam ndonjë konflikt interesi, por qe dhjetë vjet është pjesa e rrugës Mramor – Grashticë, që është e rrezikuar çdo herë edhe Gjykata e dini mirë që e ka pru vendimin, jemi ankuar një herë, dy herë, tri herë, nuk është bërë shpronësimi.

Unë e përkrahi fjalën e kolegut Agim, si dhe të kolegut Boroci, këto pika mos t'i heqim prej agjendës, jeni marr vesh me ta, OK., mirëpo mos të bëjnë diskriminime dhe të jetë universale për të gjithë të tjerët çoftë me këmbim me para, çoftë me ndërrim, çoftë me ndërtim, gjithnjë në kuadër të Ligjit, duke e pasur parasysh interesin e qytetarëve.

Ky është një diskriminim i paparë. Unë besoj se këto lëndë nuk e kanë vjetërinë më shumë se 5-6 muaj, apo një vit, e ke lëndë sigurisht që flenë aty me decenie.

Prandaj, unë po kërkoj veç një trajtim të barabartë, edhe këtë besoj se ne në grup mbrëmë e patëm, ishte një vendim, nëse dikush ka ndonjë shembull unë e prura, Agim, si shembull rrugën, a po kupton a jo, OK., edhe shembulli tjetër edhe këtë këtu para Kuvendit, i kemi lënë njerëzit e traumatizuar, i kemi traumatizuar qe dhjetë vjet njerëzit, edhe për këta është dashur me e bërë një zgjidhje çoftë ajo kompensim, çoftë ajo ndërtim, edhe e kompenson ndoshta, e jo me i lënë njerëzit se familje të tëra janë traumatizuar prej kur i kanë hequr.

Prandaj, unë jam këtu për me e mbrojtur të drejtën e secilit qytetar, aq sa mundem dhe aq sa më lejon fuqia politike.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Po drejtor.

Dren Kukaj: Vetëm sa me u sqaruar. Nuk e di a e kam deklaruar publikisht më herët, mirëpo nuk po dua tash të hyj në të kaluarat, të dal te plani, mirëpo aktualisht Komuna e Prishtinës përballet me kërkesa të tilla, të cilat, mendoj unë, janë krejtësisht të realizueshme në gjykata. Pra, përgjatë rrugës Komuna ka investuar në infrastrukturë të ndryshme publike edhe ka shumë raste që nuk i ka zgjidhur çështjen e pronave.

Pra, ka shumë prona private që janë duke u shfrytëzuar për nevoja publike, të cilat nëse shkojnë në Gjykatë të gjithë e fitojnë rastin, e nëse të gjithat shkojnë në Gjykatë dhe të gjithë e fitojnë rastin, ne rrezikojmë ndoshta në 4-5 fish buxhetin aktual vjetor të Komunës prej këtyre kërkesave.

Pra, ka aq shumë kërkesa, sepse vlera e pronës në Prishtinë është shumë e shtrenjtë, e këto probleme ne po mundohemi të paktën me e avancuar këtë çështjen përmes Hartës zonale, për atë arsye edhe kam ardhur që t'u njohët e drejta e ndërtimit në saje të asaj prone. Mirëpo, në fund të ditës ne i kemi 500 mijë euro në vit, edhe tokat publike janë duke na u tkurrur, nuk mundem me i kompensuar me toka, nuk mundem me i kompensuar me pare, këtë buxhet e kemi.

Tash ne i kemi disa zgjidhje kreative në raport se qysh me e rritur vlerën e pronës tonë edhe qysh përmes pushtetit, si me thënë, planifikimit, me ia njohur disa të drejta që me i kompensuar, se nëse hyjmë nesër në Këshill të Evropës, në Gjykatë të Strasburgut të gjitha këto rastet i duhen. Komuna e Prishtinës mundet me u ballafaquar 10-15 vjet me një shumë ndoshta qindra miliona euro borxhe për shkak të këtyre pronave.

Tash, unë jam i bindur si drejtor, në këtë mandat mundem me e shty mos me u ballafaquar, e mbaj ende, mirëpo që po e ngritni si çështje, unë jam shumë i gatshëm, ndoshta në një mbledhje të veçantë, me i trajtuar secilën veç e veç. Por, mos ta bëjmë këtu ping-pong, nëse e lëmë e lëmë të diskutojmë lidhur me këtë çështje, unë jam i gatshëm me ju treguar krejt problemet që i kemi identifikuar edhe zgjidhjet që i kemi, se në fund të ditës, mbas dhjetë vitesh ndoshta dikush prej juve ka me qenë e ka me u ballafaquar me këto probleme.

Për atë arsye nëse jeni të gatshëm me diskutuar për interesa më afatgjate të Komunës së Prishtinës, e jo me bërë këtë çështje të inateve ditore këtu, unë jam i gatshëm të diskutojmë, se për ndryshe po e kam problem se nuk zgjidhet kjo çështje kështu.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Fjalën e ka Leutrim Rretkoceri.

Leutrim Rretkoceri: Faleminderit prej kolegëve për diskutimet parimore.

Dren, me sa dëgjova deri tash, në asnjë moment nuk je informues apo nuk japë ndonjë statistikë të qartë për këtë problematikë, deri tash çka bëre ke llaf, muhabet, si me qenë në kafe, po na i arsyeton disa problem që ne krejt i dimë.

Pikërisht për këto probleme, për shkak se prona është e ndjeshme, në Prishtinë ka probleme pronësore të shumta. Unë sugjerova që me u shty këto pika të rendit të ditës, çoftë edhe pas dy ditëve të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme edhe i trajtojmë të gjitha njësoj. Nuk e kemi ne komoditetin e kafeve me i trajtuar 2-3 pronarë me një komoditet tjetër edhe mijëra tjerë me i lënë anash.

Edhe problemi i padisë nëpër gjykata, ne i kemi parë raportet financiare të buxhetit edhe e dimë sa shumë Komuna humb prej padive që i fitojnë qytetarët për shkak se e padisin Komunën, dhe për këtë është në interes edhe tuajin edhe të Komunës.

Tash, të shkojmë ne nuk e kemi komoditetin këtu që të jemi pazar si asamble, edhe të themi ju treve po ua mbyllim syrin se qenkeni në zor pak, e këta 20 mijë të tjerë nuk janë në zor hiq, të gjithë janë në zor. Ta bëjmë një parim të njëjtë për të gjithë, edhe këtë çështje në fund besoj që edhe kolegët na ndihmuan me diskutimet e tyre. Mirë që ju ka kaluar ky gripi pak, se tërë kohën ankoheshit pse po na bllokoni, nuk është problem bllokimi, unë po kërkoj vetëm me i zhvendosur këto pika të rendit të ditës çoftë pas dy ditëve, po që vullneti i kolegëve këshilltarë t'i diskutojmë edhe jo vetëm me një seancë, por me shumë seanca, mirëpo ty të takon si drejtor, i nderuar, me na informuar më saktë se sa lëndë janë duke pritur, sa janë në zgjidhje, sa janë të zgjidhura edhe sa po presin me na paditur, sepse në fund të fundit ne duhet me e ruajtur interesin e qytetarit.

Këto janë çështjet dhe t'u kisha lutur që me i diskutuar në parim, jo unë po them vetëm me i zhvendosur, para se me hy në pika të rendit të ditës me na e liruar kohën.

Kryesuesi: Faleminderit, Leutrim!

Fjalën e ka Leonora Shabani - Bajraktari.

Leonora Shabani – Bajraktari:

Thjesht, unë kisha propozuar të votojmë rendin e ditës, me gjithë ato ndryshime që janë bërë, të fillojmë, pastaj të diskutojmë për secilën temë veç e veç, kështu që mos të merremi tash me temat që janë veç në rendin e ditës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Fjalën e ka Uran Ismajli.

Uran Ismajli: Faleminderit shumë!

Po besoj që sado që ekziston një rend i ditës dhe po thirremi në strukturat ta mbajnë, diskutimi tregon vet që, është një çështje që njerëzit të cilët janë të zgjidhur po ju intereson, si e tillë po besoj që është një sinjal i mirë edhe për juve, me e kuptuar që një gjë e cila ngrit interesim edhe ka një interesim, është mirë me krijuar një hapësirë për dialog dhe me i ndihmuar.

Drejtor, unë nuk po të njoh as nuk po e di d.m.th. çka është, por konsideroj se vullnetin e ke të mirë, nuk po dyshoj në vullnetin tënd, mirëpo në mënyrën se si po drejtohesh, mos të

qeverisemi me inate, ose mos të bëjmë me inate. Nuk është inati nëse ne kërkojmë një pyetje shtesë, nuk është inati në çoftë se ne kërkojmë një lloj transparence më të lartë para se me na ardhur vendimet për votim, sepse ne duhet mbi bazën e një procesi me marr vendimin, e mbështesim apo nuk e mbështesim.

Këtu ka edhe memorie institucionale, d.m.th. edhe para nesh, po ua tërheqin vërejtjen juve, ta themi në mënyrë aq të butë, duke ju thënë, shiko, ekziston një proces i cili nuk është transparent, ngase për dikë është i mirë e për dikë nuk është i mirë, dhe në këtë mungesë të transparencës, a kemi mundësi ne që ta vëmë një formulë të cilës, të qëndrojmë gjithnjë si Kuvend komunal, dhe d.m.th. të gjithë e dimë që nesër kur të na vjen dikush, e kemi të drejtën, një qytetarë apo kushdo që na ndal, dhe ju akuzon juve dhe thotë ndoshta se po na e bëjnë pa të drejtë, ne ju sqarojmë edhe politikën e juaj edhe ju themi se nuk është kështu, sepse është marr një vendim, i cili është marr për të gjithë dhe është universale për të gjithë. Ka dyshime për këtë proces, nuk po flasim fare për njerëz, nuk po na intereson, ka dyshime prej procesit, dhe unë po të them se është e mirë për juve fillimisht që ta sqaroni procesin, që mandej të vijmë te vendimet. Ndoshta është koha shumë e shkurtër për me të thënë sot duhet me i bërë të gjitha ato, mirëpo në çoftë se na e sjell një vendim, të paktën një informatë shtesë mbi proceset si zgjedhën, Leutrimi e tha çështjen e statistikave, edhe një këshilltarë tjetër tha para neve që ka dikush ka lëndë më herët më shumë.

Ndoshta asnjëra nuk është e vërtetë, a po kupton, ndoshta ne nuk po të akuzojmë ty, nuk e akuzojmë një drejtor që ne po i themi që procesi i cili është trashëguar apo është i vendosur, nuk po na jap komoditet të duhur për me konsideruar që vendimet të cilat i marrim janë të drejta. Edhe për këtë kishim kërkuar që me reflektuar, ju na jepni informata shtesë, që të jemi në gjendje edhe ne të ju mbështesim ose të ju kundërshtojmë, të ju sugjerojmë diçka që është më e mirë.

Prandaj, nuk është e inateve, është e dëshirës për me i trajtuar barabart qytetarët e Prishtinës kudo që janë ata, jo dikë që e kanë të njohur të kenë mundësi preferenciale, ose dikush që e njeh më mirë sistemin të ketë mundësinë preferenciale, por të jetë e ditur për të gjithë.

Faleminderit shumë, drejtor!

Dren Kukaj: ...(e paincizuar)... të gjitha subjekteve, të ju them të drejtën, kemi diskutuar disa çështje të tyre, nuk ma kanë treguar asnjë problem, rrjedhimisht pikat e tilla kalojnë çdo të dytën apo të tretën mbledhje të asamblesë, pra ka precedent.

Mirëpo me çështjet që u ngritën sot, unë, me apo pa këtë mbledhje, e kam pasur në plan që publikisht t'i problematizoj, e publikisht t'i ftoj të gjithë ata që për një mend janë të interesuar të kontribuojnë në gjendjen e tyre që të marrin pjesë. Unë jam i hapur që një ide, mbase më e mirë se e imja në raport me çështje publike, me vendosur, edhe mua kështu, nëse e ka dikush ndonjë ide më të mirë, besoj se krejt përfitojnë edhe ne si qeverisje përfitojmë.

Vetëm pak, në raport me këtë, se këtu është thyer njëfarë akulli për një temë, e cila, besoni, nëse shkon me këtë trend, një kryetar pas dy mandateve ka me u ballafaquar me vendime të gjykatave, me njerëz të tërbuar që kërkojnë para para Komunës. Kërkesa të mëdha, e shumë mirë që u thye akulli për këtë, unë në raport me këto pika, njësoj kemi vepruar në mbledhjet e kaluara, nuk e kam ndier veten të obliguar t'ju informojë më shumë sesa

informatat që janë aty. Mirëpo, nëse ju doni me i zhvendosur për tjetër ditë, zhvendosni, ama ju lutem vetëm qiteni në votim, e në raport kërkesat që i patët, unë publikisht po ju them që në forume të hapura do të përpilojmë besoj strategjinë e Komunës në raport me trajtimin e pronave publike, në raport me uzurpimet që i kemi në prona publike, sepse aty ka kategori të ndryshme të uzurpuesve, e ka shumë e shumë gjëra të cilat unë jam i gatshëm t'i diskutoj pasi që jam aty gati qe dy vite. Para një viti apo një viti e gjysmë, nuk kisha qenë në gjendje me i problematizuar qysh i problematizoj tash dhe rrjedhimisht besoj që nëse përfshihen të tjerët, mund ta problematizojmë edhe më mirë, po them në forum të hapur apo pikë tjetër mundemi me diskutuar.

E këto ju kisha lutur vetëm me i qitur në votim pasi po donë ...

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Replikë, Uran Ismajli.

Uran Ismajli: Shiko, drejtor, fakti që e thua se nesër ka mundësi dikush të na vijë dhe na qet në gjyq dhe të na vendos neve Komunën, tregon sa është e rëndësishme në aspektin strategjik afatgjatë. Si e tillë, tregon brengën e drejtë të njerëzve në këtë sallë, që thonë se a bënë njëherë me na i dhënë do informata para se me na shti me votuar. A bënë me na qar diçka çka po marrim vendime ne.

Edhe e dyta, fakti që kanë qenë në një forum tjetër edhe nuk ke hasur në kundërshtime, nuk donë me thënë që mendimi nuk është i patentuar, këtu mundet me dalë dikush krejt tjetër që e jap një mendim tjetër, që na ndërron neve mendimin e sallës. Kështu që si e tillë, vetë kur po e ngrit ti si çështje, kjo "mundet me pasur konsekuenca të mëdha financiare", tregon që e vlen që ne me diskutuar pak më shumë.

Prandaj, edhe njëherë, nuk është bardh e zi, nuk është votojeni apo shtyjeni, nuk po kërkojmë ne "votojeni apo shtyjeni", ne po kërkojmë që të ketë një proces transparent, po më duket ajo që po ngritët, të na njoftosh pak më herët për një politikë që t'i po e fillon me e zbatuar.

Po mirë, në çoftë se vendosim ne, ne po hyjmë në një rrugë, po e zbatojmë një politikë, për të cilën ti po thua ndoshta është e mirë apo ndoshta nuk është e mirë. Por, shiko, hajde ne po hyjmë në një reformë të kësaj shtate, më mirë po hyjmë në reformë sesa të futemi ne të marrim vendime, duke e ditur që parakusht i kësaj pune është që ndoshta nuk është vendim i mirë, por ta zhbllokojmë situatën, sepse për momentin është e bllokuar.

Unë konsideroj që dikush që ka pritur tri javë, ndoshta pret pak më shumë nga ana jote, që të dalësh me një zgjidhje, ashtu si e quan ti "kreative", që të na bësh edhe neve aleatë të kësaj reforme, e jo ne me pasur mungesë të informatave edhe sot me kërkuar informata prej teje.

Faleminderit!

Dren Kukaj: ... para dy mbledhjeve, jemi brenda praktikave të vjetra, po jam për me i ndryshuar, mirëpo këto janë raste, si të them, kanë pasur fatin ta kenë një ndërtues aty, në fund të ditës, janë disa familje që mbase edhe janë në gjendje të vështirë ekonomike, ku shumë prej tyre sot në saje, si të them, të planeve rregulluese përmirësojnë gjendjen e tyre materiale.

Tash, unë të gjitha rastet e mëhershme i kam trajtuar kështu, të gjitha këto raste të mëhershme i ka trajtuar ky Kuvend njësoj.

Po them, derisa të vijmë në një stad ku e përmirësojmë këtë gjendje, t'i trajtoni prapë njësoj, ose mundemi me i pezulluar, si të doni, mirëpo vetëm qiteni në votim. Për mua, unë këtë interes e kam, unë po e bëjë publik interesin tim, interesi im është interesi i atyre familjeve qysh i kemi trajtuar më herët.

Kryesuesi: Faleminderit, Dren!

Edhe Nol Nushi, edhe po e hedhim në votim.

Nol Nushi: Jemi duke u sjellur thujtë këto pika po sa na erdhën, ka qe një javë ditë që na kanë lajmëruar që janë tri raste për këmbim të pronës, edhe na kanë ardhur dokumentet që janë nga disa faqe të trasha, për të cilat ne kemi mundur me u interesuar personalisht secili tek krejt drejtorët bashkë edhe me i pyetur se qysh është bërë ky rast i këmbimit, pse është kah bëhet tash. Duhet me kuptuar pak, se me parafolësin, ndoshta se tha, derisa ta bëjmë reformën, pastaj t'ia fillojmë me i këmbyer, por është problem, sepse kështu i bie pak, me ministrin e kam fjalën, nuk po shërojmë njëherë njerëz derisa ta bëjmë reformën në arsim, si me thënë.

Janë çështje urgjente që vijnë, si e tha Dreni, jo gjithkund në Prishtinë ka mundësi ndërtimi edhe ka benifit për me ndërtuar ndërtim të lartë. Pra, ka shumë problem derisa merret njëfarë marrëveshje me disa parcela aty për me u ndërtuar. Këto raste që na kanë ardhur neve, e kanë pasur këtë mundësi të tillë që kanë bërë një kesi marrëveshje, edhe aty aksidentalisht ka qëlluar një rrip i tokës së Komunës, të cilën ne jemi duke e këmbyer, faktikisht nuk jemi duke humbur, por jemi duke e marr një tokë tjetër diku për atë tokë aty, në mënyrë që aty me u ndërtuar një kompleks banesor brenda rregullave të planit urbanistik dhe këto çka ekzistojnë.

Unë nuk po e shoh se çfarë paniku është, kjo praktikë ka qenë krejt kohën në Komunë, krejt këtu u pajtuam se duhet me ndryshuar praktika, edhe nuk është praktikë e keqe, vetëm se mendoj se mundet me u bërë më e mirë, nuk është praktikë e keqe me këmbyer tokë, e merr një e jap një. Me mundur mos me dhënë tokë hiq kishte qenë edhe më mirë, kështu që për atë punë ne krejt bashkë duhet me u mbledhur me bërë tryeza, me bërë diskutime, se nuk zgjidhet kjo reformë me një mbledhje të jashtëzakonshme pasnesër, nuk kemi me e zgjidhur pasnesër këtë reformë.

Shumë nismë e mirë, por këto sot duhet me i kryer, sepse ata janë duke pritur me ndërtuar, nuk mundem me ju thënë pritni reformën e pastaj pas dy viteve, kur ne të mëremi vesh për reformë, ju fillojeni ndërtimin.

Kryesuesi: Faleminderit shumë për diskutim!

Uran Ismajli: Faleminderit shumë!

Shiko, nuk po besoj që ka nevojë me e mbrojtur drejtorin, sepse ne nuk jemi duke e sulmuar, jemi duke i thënë diçka. Shiko, është paradoksale me thënë, kanë qenë dokumentet, është praktikë e kaluar, është paradoksale, nuk tregon asnjë vullnet të drejtorit të ri për me thënë që unë e kam gjetur kështu, por do të mundohem. Prapë se

prapë, po themi ne edhe informatat mbi procesin po mungojnë, duke qenë informatat transparente pak më shumë për procesin sot për sot, po nuk ka lidhje për dokumentet, dëgjom, po unë i pash dokumentet, nuk po them se po fsheh diçka, çka po të them unë se jemi në kundërshtim të një praktike, e cila konsideron se është praktikë e kaluar dhe si e tillë nuk ka qenë e mirë, po që neve na ka mbetur në dorë dhe në der, dhe ne duhet gjithsesi ta vazhdojmë me një praktikë të kaluar.

Po besoj se ne presim prej teje që me dalë me një praktikë tjetër të re, e cila e zëvendëson për momentin praktikën dhe na jap një kohë edhe thotë, shiko, sot po i marrim këto vendime gjersa d.m.th. ne e kemi një pabarazi, konsiderojmë që sot për sot, duke vazhduar me një praktikë të tillë, unë thash ka edhe memorie institucionale, po dëgjojmë çka po thonë të gjithë, ekziston një pabarazi, është paradoksale me thënë i kemi tokat, jemi duke i ndërruar kokë për kokë, por, në anën tjetër, po na zvogëlohet fondi i tokave, d.m.th. qysh po të zvogëlohet në çoftë se je duke i ndërruar kokë për kokë.

Mirë, dëgjomë, por po them tash, d.m.th. të gjitha këto neve po na bëjnë me bërë pyetje, nuk po na bëjnë asgjë më shumë, po na bëjnë me bërë pyetje. Shiko, edhe diçka, nuk po dua me jua zgjatur një diskutim në pafundësi, se nuk është qëllimi im me zgjatur një diskutim pafundësi, është me rëndësi me i ditur argumentet. Vetëm dëgjomë, drejtor, deri në fund, është me rëndësi me i dëgjuar argumentet.

Kryesuesi: Uran, të përfundoi e drejta e replikës.

Faleminderit shumë!

Jo, Dren, vetëm një sekondë, të lutem!

Vetëm pak.

Problemi është se këtu më shumë është diskutuar rreth thelbit të çështjes se rreth rendit të ditës se a me qenë apo jo. Prandaj, nëse ka të interesuar rreth kësaj çështjeje, mundemi me futur në rend të ditës ndonjëherë tjetër me e diskutuar.

Mendoj se ka qenë një keqkuptim prej fillimit ideja që këto pika të rendit të ditës janë futur këtu, është pjesë e praktikës deri tash, deri sa të ndodh ndonjë ndryshim, duhet me vazhduar praktika që ka qenë, d.m.th. edhe jeni ministër i Shëndetësisë, duhet me vazhduar me praktikat që kanë qenë derisa të ndryshohet Ligji, kur të ndryshohet Ligji vjen atje.

Vetëm dua të them se si diskutim ka qenë goxha shumë jashtë rendit të ditës, prandaj unë e hedh në votim, e kemi propozimin e Leutrim Retkocerit për me i shty, Leutrim, dy herë ke folur, për shkak se ke qenë propozues, mandej nuk mundem, të lutem.

Janë tri pika të rendit të ditës që kërkohet të shtyhen për një mbledhje tjetër, edhe ky propozim do të hidhet në votim, d.m.th. a jeni për apo kundër që këto pika të shtyhen për një mbledhje tjetër?

Atëherë, në votim do të hedhet propozimi i Leutrim Retkocerit, që këto pika të shtyhen për një mbledhje tjetër.

Ata që janë që këto pika të shtyhen për një mbledhje tjetër, votojnë për, ata që janë kundër, do të thotë se janë që të diskutohen për këtë mbledhje, ata votojnë kundër.

A është e qartë tash?

Vetëm nëse është fjala për procedurë, të lutem!

Halim Halimi: (Diskutimi nuk ka mundur të transkribohet për shkak se diskutuesi nuk është dëgjuar fare).

Kryesuesi: Faleminderit!

OK.

Atëherë, regjia le të bëhet gati për votim.

Votojmë tash.

Atëherë, konstatojmë se u votua propozimi që të shtyhet kjo mbledhje, në fakt, të shtyhen ato tri pika dhe në këtë votim 7 (shtatë) ishin për, që të shtyhet, 34 (tridhjetë e katër) ishin kundër, 2 (dy) abstenuan dhe 8 (tetë) nuk votuan.

Atëherë, nëse Leutrimi ka votuar gabim, atëherë e konsiderojmë edhe votën e Leutrimit, e ndërrojmë, mirëpo votimi nuk përsëritet.

Faleminderit shumë!

Atëherë, e hedhim në votim komplet rendin e ditës, me ato ndryshime që u votuan tash.

Regjia, ju lutem, gati.

Atëherë, pyetje dhe përgjigje del si pika e dytë, sheshi "Adem Jashari" është pika e nëntë dhe pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Shkojmë me votim.

Regjia, votojmë.

Faleminderit!

Më 41 (dyzet e një) vota për, 2 (dy) kundër, 1 (një) abstenim dhe 7 (shtatë) që nuk kanë votuar miratohet rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi: A ka diskutime?

Urdhëro, Sami!

Sami Boroci: Faleminderit, kryesues!

Unë, lidhur me procesverbalin që na është servuar, e kam vetëm një koment. Në seancën e jashtëzakonshme, që është trajtuar problematika e ambientit, unë kam kërkuar në emër të Grupit, por edhe si asamblist kam kërkuar që Drejtoria e Parqeve, e cila është përmendur se është në përgatitje e sipër për me u formuar si drejtori e re, kam kërkuar që kjo drejtori me u ridizajnuar edhe me u quajtur Drejtoria e Ambientit dhe Parqeve, me kompetenca më të zgjeruara, me qëllim që me u trajtuar problemin e ambientit në nivel institucional si Komunë.

Kjo nuk po e shoh që është paraqitur, pra vetëm po dua të them që kjo le të korrektohet dhe le të jetë si kërkesë për me u krijuar Drejtoria e Ambientit dhe Parqeve.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Fiknete!

Fiknete Bejta: Faleminderit, kryesues!

Tek procesverbali i transkriptit që na është vendosur në pakon këtu në Kuvend dhe e-maili, por janë të ndryshme. Unë i kisha lutur ata që e bëjnë transkriptin, të jenë pak më të kujdesshëm, që fjalët tona mos të na i ndryshojnë, sepse ka raste kur unë kam thënë diskurs, aty është vendosur kurs, që e dimë që ka diçka shumë të ndryshme, pastaj përditësim të ueb- faqes, ata e kanë vendosur përgjithësim. Kemi edhe gabime drejtëshkrimore edhe emrat po na vendosen gabim, kështu që i kisha lutur me qenë pak më të kujdesshëm.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Dikush tjetër?

Atëherë, e hedhim në votim.

Regjia gati për votim.

Votojmë tash.

Konstatojmë se më 41 (dyzet e një) vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me plotësimet e kërkuara.

Pika e dytë

Pyetje dhe përgjigje

Kryesuesi: Fjalën e ka Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Faleminderit, kryesues!

Një pyetje e kam bërë javën e kaluar për drejtorin Dren Kukaj, për të cilën më ka thënë se më përgjigjet me shkrim, mirëpo asnjë përgjigje nuk e kam marrë deri sot, andaj kërkoj prapë edhe në këtë seancë që të përgjigjet në pyetjen se çka ka ndodhur me banesat, të cilat në njëfarë forme janë uzurpuar nga ish-pushtetarët e LDK-së, ku vet Dreni ka thënë, po edhe Shpendi ka thënë që këto banesa do të rikthehen dhe Komuna do t'ua rikthejë rasteve sociale, mirëpo, fatkeqësisht, një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më sot.

Kështu që edhe njëherë kërkoj që të përgjigjet në këtë pyetje.

Tjetra është që kërkoj nga organet kompetente për këtë çështje, që shtatorët e dëshmorëve mos të jenë shtatore për të cilat nuk përkujdeset askush, e aty kushdo le të veprojë çka do e si do. Shembulli i fundit është shtatorja e Zahir Pajazitit, ku ka ndodhur një skandal i madh, për të cilën Komuna nuk e di a ka informacion apo jo, nga shtatorja e heroit Zahir Pajaziti është larguar Flamuri kombëtar dhe aty janë vendosur flamujt e imponuar të Republikës së Kosovës.

Le të vendosen njëqind flamuj të Republikës, askush nuk është kundër tyre, mirëpo me ia larguar dëshmorit flamurin kombëtar, është njëjtë si me ia larguar armën. E kjo është një padrejtësi tepër e madhe, nuk mundet flamuri i Kosovës me iu imponuar qytetarëve duke ia larguar flamurin kombëtar.

Komuna është përgjegjëse për shtatorët e dëshmorëve dhe duhet të përkujdeset për mirëmbajtjen e tyre. Flamuri kombëtar duhet të rikthehet te përmendorja e heroit Zahir

Pajaziti. Vendosni edhe flamuj të Kosovës sa të doni dhe ku të doni, por jo me i larguar flamujt kombëtarë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Egzon!

Dreni veç nuk është këtu, atëherë duhet t'ia bëjmë një kërkesë që t'i dërgojë me shkrim.

Urdhëro, Eman!

Eman Rrahmani: Faleminderit, kryesues!

Para se ta bëjë pyetjen, jam duke këqyrë mos po e shoh Dardan Sejdiun diku, se ka filluar me na kërcënuar nëpër korridore, jo fizikisht, të kuptohemi, por për shkak të mos kalimit të raportit financiar, e pash që e kishte marrë shumë afër zemrës, e kish filluar me kërcënime, por e di se i ka vetëm fjalë ato.

Por, tjetër, është mirë që ka thënë se prej të trembëdhjetit do të jetë këtu duke na vëzhguar, por nuk jam duke e parë këtu.

Është mirë me u diskutuar, për shkak se pengon punën time zyrtare që vij në Komunë unë. Pyetje tjera, njëra është për drejtorin e Infrastrukturës, edhe pse jemi angazhuar pak bashkërisht, por po më intereson me i ditur afatet e përfundimit të çerdhes në lagjen "Kodra e Trimave", që ka pasur me përfunduar në shtator të 2017-s, afatin e përfundimit në shkollën fillore "Arbëria" në lagjen "Arbëria", që është duke u ndërtuar, ku edhe kjo ka pasur të përfundojë diku në tetor 2017-s, çerdhen në lagjen "Tophane", d.m.th. këto tria janë për Gëzimin, nëse është e mundur me na informuar lidhur me këtë.

Pata me e pyetur kryetarin, apo drejtorin, Arben Vitia, se kur ka me filluar funksionimin Shtëpia e pleqve në lagjen "Tophane", për shkak se, sa e di unë, ka përfunduar, mirëpo nuk është duke filluar ende.

Kisha kërkuar nga Gëzimi prapë, me e krijuar një ekip edhe me i vëzhguar, apo me i hetuar investimet të cilat janë bërë në shkollën "Hilmi Rakovica" gjatë 2017, për shkak se kanë mbetur punët në gjysmë, të cilat e rrezikojnë ndoshta edhe jetën e fëmijëve në atë shkollë, sidomos punët që kanë të bëjnë me rrjetin elektrik.

Tjetër që kisha kërkuar prej drejtorit të Shërbimeve Publike, por nuk qenka këtu, është një deponi, e cila është bërë jashtëzakonisht e rëndë për banorët e një pjesës të lagjes "Kodra e Trimave", të cilët janë, është pjesa rruga që kalon nga ETC-ja deri te Qendra e Panairëve, atje është një deponi, ndoshta këtu mundet me na ndihmuar edhe nënkryetari lidhur me këtë temë, por është një deponi e mbeturinave të forta dhe të gjitha llojeve të mbeturinave, ku çdo ditë me dhjetëra kamionë shkojnë dhe hedhin mbeturina aty.

Kërkesa tjetër është, janë dy pjesë të lagjes të cilat nuk kanë ujë 24 orë, është një pjesë në lagjen "Kodra e Trimave", të cilës i është premtuar një pompë që duhet të vendoset për të pasur ata ujë të pijshëm, sepse ata nuk kanë ujë 24 orë. Për dy rastet, është ky rasti në lagjen "Kodra e Trimave" dhe është një në lagjen "Vreshtat", nëse nuk gabo, është i informuar edhe kryetari, vitin e kaluar ka pasur procedura, po mendoj iniciativa për blerjen e atyre pompave, por ajo nuk është bërë deri sot.

Është shumë e rëndësishme që të fillohet sa më parë, për shkak se uji i pijshëm është e drejtë elementare e jetës.

Meqenëse nuk është kryetari dhe shumica e drejtorëve të tjerë, disa pyetje po i lë për herën tjetër, për shkak se nëse nuk janë prezent këtu me bërë pyetje po është kot.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Eman!

Atëherë, drejtor të cilëve iu janë drejtuar pyetjet, ju lutem!

Nuk është Egzoni këtu, se ai e ka bërë pyetjen.

Dren Kukaj: Të njëjtën pyetje e kam pranuar edhe prej gazetës “Koha ditore”, edhe të njëjtës ia kam dhënë të njëjtën përgjigje.

Ne qëndrojmë pas vullnetit të shprehur vitin e kaluar në raport me banesat në lagjen “Bregu i Diellit, vetëm se atë vendim do të kërkojmë që ta bëjmë me legjitim edhe do ta sjellim këtu para jush, pra në Asamble.

Meqenëse Asambleja ka qenë ajo që ia ka ndarë ato banesa atyre personave në atë kohë, unë shpresoj që kjo asamble ta ketë vullnetin e vet që të vendos drejtësi në raport me shfrytëzimin e mëtutjeshëm të atyre banesave.

Ne lidhur me këtë çështje e kemi një propozim, që t’i mënjanojmë që t’ua njohim shfrytëzimin e mëtutjeshëm me automatizëm kategorive të marginalizuara shoqërore, pra ka aty pjesëtar të ndryshëm të kategorive të veçanta të shoqërisë tonë, përfshirë kategoritë e dala nga lufta, përfshirë rastet sociale, madje ka, është edhe një person aty i cili është i invaliduar në punë dhe në saje të asaj tragjedie që i ka ndodhur në vendin e punës i është ndarë ajo banesë. Unë jam që rastet e tilla të cilët e kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit aty, që t’u vazhdohet me automatizëm shfrytëzimi i mëtutjeshëm, e njëkohësisht të mos kushtëzohet me pagesa. Nuk ka kuptim familjeve me rëndësi shoqërore tek ne, siç është familja Jashari dhe familje të ndryshme që gjenden aty, si të them, të personave që i kemi shpallur heronj, t’ua kushtëzojmë shfrytëzimin me 15 -20 euro në muaj, ose duhet t’ia japim pa të holla, se nuk ka kuptim që një familje të tillë t’i kushtëzohet shfrytëzimi i asaj banese me ato të holla.

Ndërsa për rastet e tjera, propozimi ynë do të jetë kështoj, që menjëherë të shpallet një konkurs për raste sociale, për banesat që duhet të vendoset që të largohen shfrytëzuesit aktualë, e në këtë drejtim unë shpresoj që të gjithë të jeni të hapur ndaj realitetit në Prishtinë, i cili është që ka shumë persona në Prishtinë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira sociale. Edhe ata njerëz që janë aty e që kanë mundësi të jenë edhe diku tjetër, ata duhet të jenë diku tjetër.

Unë nuk do të tregohem arrogant, si pjesë e ekzekutivit, e të marr vendime të njëanshme. Unë shpresoj që brenda këtij forumi ka njerëz të arsyeshëm dhe do të veprojnë në funksion të interesit publik, edhe të shfrytëzimit me interes publik të atyre pronave aty.

Në këtë drejtim unë do të kërkoj votën edhe të asamblistëve të LDK-së, edhe të asamblistëve të PDK-së, e në këtë drejtim ne do ta sjellim atë propozim këtu në asamble, edhe para se ta sjellim atë mundemi të diskutojmë hapur lidhur me këtë çështje.

Unë konsideroj që ata që nuk kanë nevojë të qëndrojnë aty, duhet të largohen prej aty dhe atë hapësirë banimi ta shfrytëzoj dikush që ka nevojë, se edhe duke rënë borë, nëse dikush mendon se unë jam duke gënjyer, i kemi evidencat e rasteve sociale, shkojmë edhe i shohim tash.

Mendoj dhe shpresoj të paktën që kësi soji të mendoni edhe ju, që vendimi juaj të jetë i njerëzishëm, por, sido që të jetë, unë atë vendim do ta sjell këtu, sepse asambleja ka marrë vendim atëherë, kundërshtimi ndaj qëndrimit tonë ka qenë mu për shkak se Asambleja duhet të vendosë, unë shpresoj që kësaj radhe Asambleja të vendosë. Shpresoj që ne mos të kemi nevojë që të tregohemi arrogantë, por ta kuptojmë përnjëmend atë çështje, sepse ka raste që po them, aktualisht shkojmë edhe i shohim se jetojnë tepër keq.

E tash ajo jo le të mbetet në ndërgjegjen e juaj, por shpresoj që të veproni ... politikisht, mirëpo kjo do të jetë për një mbledhje të radhës e jo sot.

Kjo ishte në raport me pyetjen që mu parashtrua, e të njëjtën përgjigje e kam dhënë edhe për medie.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Dren!

A ka dikush prej drejtorëve?

Urdhëro, Gëzim Mehmeti!

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të

Kontratave: Z. Rrahmani, faleminderit për pyetjet.

Ne kemi pasur edhe një bisedë rreth pyetjeve tuaja javën e kaluar, sado pak je i informuar. Unë e marr si obligim që gjatë ditës, se ne kemi përpiluar një raport për pyetjet e juaja, t'ua dërgojmë me shkrim. Duhet t'i marrë parasysh, sepse sa i përket shkollave, ka të bëjë me kopshtet e shkollave, e ne nuk mundemi të intervenojmë në këtë fazë, janar – mars, për atë arsye kemi ngecje, por prapë se prapë ne ua dërgojmë me shkrim raportin që e kemi formuluar, në mënyrë që të keni njohuri më shumë rreth pyetjeve tuaja.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Fjalën e ka nënkryetari, Selim Pacolli.

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës: Z. Rrahmani, kryesues, të nderuar drejtorë dhe këshilltarë të Asamblesë, është e vërtet që ne kemi një shqetësim të madh në rastin e deponive ilegale, nuk është vetëm ajo e lagjes në “Kodrën e Trimave”, mirëpo të tilla janë të shumta, vetëm në fshatin Hajvali i kemi dy sosh, i kemi thujse nëpër çdo cep të rrugës ku njerëzit e pandërgjegjshëm shkojnë dhe i shkarkojnë kamionët dhe traktorë të ndryshëm të mbeturinave. Kryesisht janë inerte, kemi sidomos rrugën prej Kolovicës në drejtim të fshatit Grashticë dhe Mramor, thujse se deri atje edhe kanë arritur ato.

Ne jemi duke e hartuar një plan të një deponie qendrore, të cilën së paku ne pretendojmë se është e nevojshme dhe po them që është e arsyeshme, afër fshatit Barilevë dhe Drenoc, për aty së paku tani për tani, jemi duke diskutuar dhe besoj se në mbledhjen e ardhshme do të dalim me një propozim konkret për këtë çështje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar!

Urdhëro, z. Agim Gashi.

Agim Gashi: Nuk ka pasur nevojë kurrfarë plani i ri për këtë fushë, pasi që projekti zbatues për ndërtimin e deponisë për mbeturina nga konstruksioni dhe demolimi, ekziston që pesë vjet në Komunën e Prishtinës.

E nëse nuk e dini, z. nënkryetar, pyetni edhe ata, do të ju sjellin të gatshëm, projekt i hartuar nga vetë Komuna, përmes procedurave tenderuese. Ndërsa ka qenë pikëpyetje vetëm lokacioni, edhe për pesë vite nuk është arritur të sigurohet një lokacion, për investime vlera parallogaritare e këtij projekti është katër milionë euro, d.m.th. kosto e përballueshme.

Sot mbeturinat nga konstruksioni dhe demolimi, askush nuk ka ku t'i hedhë në destinacion të caktuar, sepse nuk ekziston. Deponia ekzistuese nuk i absorbon këto tipe të mbeturinave dhe njerëzit detyrohen me i hedhur aty ku gjejnë vend. Komuna i ndjek, Inspekcioni, edhe ato i merr këtu e i qet atje, por nuk ka deponi, nuk ekziston, se Ligji për menaxhimin e mbeturinave e kategorizon këtë lloj mbeturine dhe ia lë në kompetencë Komunës për akomodim, faktikisht për deponim.

Deponia nuk është ndërtuar, dikush mund të thotë pse nuk është ndërtuar përpara, unë po them qysh është gjendja, ndoshta ka mundur me u ndërtuar edhe përpara, por sot asnjë komunë në Kosovë nuk ka kësi lloj deponie, edhe për atë arsye Kosova është krejt me mbeturina e mbushur, mos më keqkuptoni si po shprehem.

Në Mramor, që ti the se e kanë mbushur, jo ata e kanë mbushur sa kanë mundur dhe me tona mbeturina e kanë mbushur te Liqeni i Badocit për shkak të vërshimeve. Ato mbeturina inspeksioni mundet me i penguar në atë vend ku po hedhen, me i qitur pak më andej, ku nuk i merr uji për me i futur në liqe, por nuk ekziston deponi se ku duhet t,i dërgojmë ato mbeturina.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, z. Gashi!
Urdhëro, nënkryetar!

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës: Çfarë ka ndodhur më herët unë nuk e di sigurisht, unë jam kompetente për këtë legjislacion edhe mund të them se është ndarë lokacioni, lokacioni është i sigurt, fondet janë të sigurta dhe kjo sigurisht se do të bëhet shumë shpejt.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar!
Fjalën e ka drejtori i shëndetësisë, Arben Vitia.

Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë: Faleminderit kryesues!
Eman, sot do të hapet Qendra socialo – kulturore për të moshuar, bëhet në orën 15:00, bëhet aty ku është ndërtuar.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Urdhëro, Sami!

Sami Boroci: Atëherë, do t'i bëjë disa pyetje, do të mundohem të jem shumë i shkurt, në të njëjtën kohë edhe i arsyeshëm.

E para, ne si asamblistë këtu i përfaqësojmë qytetarët edhe çdo ditë marrim kërkesa prej më të ndryshmeve, apo natyrave më të ndryshme prej komunitetit, dhe të cilat ne po kërkojmë me i adresuar dhe me iu dhenë zgjidhje.

Personalisht, kam bërë disa pyetje në seancën e fundit, mirëpo në asnjërën prej tyre nuk kam marrë përgjigje, d.m.th. përveç pyetjeve që i kam shtruar tek drejtorët që kanë qenë këtu. Ato që kanë mbetur me shkrim, nuk kam marrë asnjë përgjigje prej tyre, një ka qenë edhe për kryetarin Ahmeti, të cilin, sinqerisht, po më vjen keq që nuk po e shoh sot këtu, është seanca e tretë dhe dy seanca d.m.th. jemi pa kryetarin në seancë, edhe kjo mendoj se është shqetësuese, por, sido çoftë, nuk do ta përsërisë atë pyetje, do ta pres përgjigjen. E para, ka të bëjë një pyetje me drejtorin e Inspeksionit, z. Brahim Mehmetaj. Kam marrë disa ankesa prej qytetarëve, sidomos kompanitë të cilat janë përgjegjëse dhe të cilat janë të kontraktuara për zhvillimin e transportit, që janë jashtëzakonisht të dëmtuar prej taksive ilegal ose kombi-busëve të tillë, edhe po më intereson se çfarë hapa konkretë janë ndërmarrë, ose planifikohet të ndërmerren, sepse kjo po ndikon pastaj edhe te Trafiku Urban.

Kemi parë një gjendje shqetësuese në Trafikun Urban edhe kjo po mendoj se është rrjedhojë edhe e operimit të numrit goxha të madh të taksive ilegale, veçanërisht ata në Prishtinë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorin e Investimeve Kapitale, z. Gëzim Mehmeti. Në vitin e kaluar kanë filluar disa punime prej Komunës së Prishtinës, është vendos kanalizimi, sistemi i kanalizimit në rrugët "Selim Kraja" dhe "Pëllumb Ademaj", të cilat gjenden në lagjet "Veterniku" ose "Hajvalia", aty poshtë te Fshati Ndërkombëtar, po më intereson, iu është premtuar banorëve aty që në pranverë kanë me filluar apo me vazhduar punimet për ndërtimin e këtyre rrugicave, pra po më intereson procesi se kur planifikohet me filluar.

Edhe një pyetje tjetër, po ashtu që e kam marr prej shumë qytetarëve, ka të bëjë me procesin e pranimit teknik të objekteve, veçanërisht të ndërtimeve të larta, po më intereson ky proces në çfarë dinamike është duke u zhvilluar në Prishtinë, edhe a planifikohet me shkuar më shpejt ky proces, sepse shumë qytetarë të cilët janë të interesuar me blerë banesa, e kanë të pa mundur me u financuar përmes bankave, në këtë rast për shkak të mos pranimit teknik të këtyre objekteve.

Këto ishin pyetjet e mia.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Urdhëro, drejtor!

Brahim Mehmetaj, drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit

Përshëndetje për të gjithë.

Sigurisht që është shqetësuese kjo dukuri në Prishtinë, dukuri që nga paslufta, vazhdimisht kemi takime dhe konsulta me menaxherët e ndërmarrjes "Trafikut Urban", e kanë shprehur këtë shqetësim që po e thoni ju, ju falënderoj edhe juve për vëmendjen.

Që nga fillimi kur unë jam bërë drejtor, janë organizuar dhjetëra aksione të përbashkëta edhe me Policinë e Kosovës, ku janë konfiskuar disa automjete janë disa padi në Gjykatë për Kundërvajtje. Aksionet kanë zgjatur me ditë të tëra, kemi pasur aksion që ka zgjatur shtatë ditë dhe thuajse se janë zhdukur të gjithë taksistët ilegalë, por pas dy ditëve prapë janë kthyer.

Problemet janë edhe tek institucionet dhe te mosveprimi i gjykatave në këtë rast, unë ju njoftoj që kur kam ardhur në zyrë, i kam parë mbi katërqind lëndë që janë të përshkruara dhe nuk është ndërmarr asnjë masë ndaj shkelësve të ligjit të çfarë do forme. Jemi duke e diskutuar që ne ta gjejmë një zgjidhje dhe të aplikojmë gjobat mandatore, ku pastaj nëse shkelësi nuk e paguan, sigurisht që përmbaruesi e bënë punën e vet. Pastaj e kemi edhe një problem tjetër në këtë drejtim, numri i inspektorëve në Komunë të Prishtinës është i vogël në rendin komunal. Në Rregulloren për menaxhimin e transportit publik duhet t'i bëjmë disa ndërhyrje, ku duhet të kalohet në kompetencë edhe të policisë çështja e ndaljes dhe vënia e gjobës nga policia për shkelësit e ligjit në përgjithësi, por edhe për taksitë ilegale.

Puna është duke u bërë, aksionet janë në vazhdim e sipër, ekipet e inspektorëve komunalë punojnë vazhdimisht në këtë drejtim, gjobisin, konfiskojnë, por ndërprerja 100% nuk është bërë. Unë ju them se e kam pasur edhe një takim me 146 taksi ilegale, kam biseduar me ata, e kam parë ku e kanë ata problemin dhe cila është rruga që ne mundemi me e gjetur me ta, ju them se shumica prej tyre janë hallexhi. Në rast se ata e sigurojnë një mundësi të punësimit, nuk merren më me taksi, se ata nuk mundën me fituar më shumë se që mundën me e marr një rrogë nëse mundën me u punësuar diku.

Kështu që kjo pjesë pak duhet me qenë edhe pjesë e politikave zhvillimore dhe e zhvillimit të punësisë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

A pat dikush prej drejtorëve të tjerë?

Urdhëro, drejtor!

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave: Z. Boroci, faleminderit për pyetjen tuaj.

Sa i përket rrugëve që ju i cekët në lagjen "Veterniku", mund të kemi pengesa sa i përket pronësisë, ne me z. Kukaj javën e ardhshme do ta bëjmë një marrëveshje, ta formulojmë, dhe do t'ua ofrojmë qytetarëve të Prishtinës. Do të thotë rrugët në shumicën e rasteve janë në prona private.

Po ashtu, varësisht nëse kjo rrugë është tenderuar vitin e kaluar, punimet fillojnë në muajin prill, në rast se nuk është tenderuar, atëherë procedurat e tenderimit zgjasin diku prej 3-5 muaj, do të thotë do ta marr si prioritet, por varet nga tenderimi.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Dikush prej drejtorëve të tjerë?

Nuk ka.

Faleminderit shumë.

Fjalën e ka Arbenita Murseli.

Arbenita Murseli: Përshëndetje i nderuari kryesues, nënkryetar, drejtor, kolegë asamblastë, medie dhe të gjithë ju të pranishëm.

Kërkesa ime vjen si pasojë e rrugës shumë të ngarkuar, të quajtur “Vëllezërit Fazliu”, që fillon te Xhamia e Llapit e që të shpie te Kodra e Trimave. Jemi dëshmitarë se kjo rrugë për t’u ngjitur lartë me makinë i ka dy trase të lira, ndërkaq në anën e kundërt e ka vetëm një trase. Qytetarët po ankohen se është e stërngarkuar traseja e vetme që të shpie nga Kodra e Trimave tek qendra, ndërkaq dy të tjerat të kundërtat po janë të lira.

Kërkesë e qytetarëve është që qarkullimi në këtë trase të bëhet me rotacion, që i bie në orët e mëngjesit, kur është vlugu më i madh i qarkullimit që qytetarët shkojnë nëpër puna, po ashtu ka qytetarë që vijnë edhe nga komuna e Podujevës, t’i kenë dy trase të lira. Pra nga Kodra e Trimave tek qendra, që do të ju mundësonte atyre qarkullim shumë më të lehtë, po ashtu do t’ju kursente me dhjetëra minuta më pak të vajtjes në punë, ndërkaq në orët e pasdites të kthehet ashtu siç është për momentin.

Një gjë e tillë do të mundësohej përmes shenjave të komunikacionit, që do të ju bënte të ditur qytetarëve se cilat trase janë të lira.

Ndërkaq, kërkesa e dytë vjen si pasojë e rrugës së degraduar të fshatit Ballaban i Epërm, që del tek fshati Nishevc, që të jem e qartë, sipas qytetarëve është rruga prej Kujevit deri tek shtëpia e ish-Shtabit të UÇK-s. Të jem e sinqertë, ky fshat nuk është që ka shumë banorë, shumica e banorëve janë larguar nga ajo zonë për shkak të mungesës së infrastrukturës, ndërkaq edhe ata pak banorë që kanë mbetur rrezikojnë që ta braktisin vendin e tyre, një ndër shkaqet është edhe kjo rrugë e degraduar.

Andaj, e lus drejtorin përkatëse që ta marrë iniciativën e ta rregullojë sa më shpejt atë rrugë, në mënyrë që të lehtësohet edhe qarkullimi i qytetarëve në atë zonë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Këtu nuk pati pyetje, këto ishin lloj kërkesash, nëse ka, dikush prej drejtorëve fjalën, nëse jo, mundemi me vazhduar tutje.

Urdhëro, Kushtrim!

Kushtrim Sopa: Faleminderit kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Unë po ju drejtohem me disa kërkesa prej disa qytetarëve në lagje të ndryshme. Po filloj me banorët e lagjes “Përroi i Njelmët”, karshi meje e kanë shprehur shqetësimin që ju mungojnë shërbimet publike, shkolla, ambulanca, kopshti i fëmijëve në rrethin ku jetojnë dhe ata detyrohen që gjithmonë në qytet t’i kryejnë këto shërbime. Ka raste të ndryshme kur familjet nuk kanë mundësi për t’i kryer këto shërbime.

Infrastruktura rrugore në atë pjesë tani veç është, mos të them me shifra se nuk mundemi me qëlluar saktësisht, por 50-60% e infrastrukturës rrugore është e prishur, prapa Zonës industriale, ka shumë gropa të mëdha, madje deri në 30-40 centimetra, që është shumë e rrezikshme për veturat, por edhe për njerëzit.

Kërkesë tjetër e qytetarëve karshi meje është edhe hapësira tek varrezat, hapësira e re e ndërtuar, që lidh lagjen “Arbëria” me l. “Kodrën e Trimave”, fatkeqësisht po shfrytëzohet

si deponi në disa raste ajo hapësirë. A ka plan për t' u gjelbëruar ajo me pisha apo me drurë, edhe kishte me lidh mirë dheun për mos rrëshqitjen njejt prej pemëve dhe pishave, po besoj që e kishin lidhur mirë?

Kërkesa tjetër është edhe hapësira tek xhamia e lagjes " Arbëria", është një hapësirë goxha e madhe, është me shkurre, fatkeqësisht, edhe aty me mbeturina. Me sa e dimë ne edhe qytetarët, ajo është pronë publike e Komunës. A është e planifikuar aty një këndë i lojërave apo një mini-park i vogël, sado që të është?

Këto ishin tri kërkesat e mia, pyetje ose kërkesa.

Faleminderit shumë për vëmendjen!

Kryesuesi: Faleminderit, z. Sopa!

Urdhëro, drejtor!

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale: Faleminderit për pyetjen!

Do të flas rreth pyetjes së gropave, ne kemi një plan dinamik, sipas të cilit deri në fund të qershorit Prishtina do të jetë pa gropa, d.m.th kemi marrë këtë si obligim shumë të rëndësishëm me e bërë sanimin e gropave.

Momentalisht jemi duke bërë sanim të përkohshëm me kubza, për arsye të kushteve klimatike, ndërsa nga Prilli fillojmë edhe me asfalt.

Janë evidentuar diku 385 gropa, të cilat ne i kemi evidentuar pa, jo, një moment, tani ju shpjegoj pse 385, për arsye se pusetat, do të jetë një identifikim tjetër dhe ato intervenime janë, diku arrijnë në 1000 përafërsisht.

Jo, unë po them duhet me e bërë dallimin, z. Gashi, mes pusetave, prishjeve, qarjeve dhe gropave, unë fola vetëm për gropat, keni të drejtë, diku 1000 përafërsisht do të jenë nr. që duhet me u sanuar.

Kryesuesi:

Faleminderit shumë!

Urdhëro, Milazim Vitija!

Milazim Vitija: Faleminderit kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

E kam një pyetje, ndoshta të pa zakontë për kohën meqë dje ka qenë dita e pranverës, mirëpo sot të gjitha rrugët e regjionit të Gollakut thuajse janë të bllokuara.

Prandaj nuk e di se a është drejtori i Shërbimeve Publike këtu apo jo, kishte me qenë mirë që kompanitë që janë të dalin në terren dhe t' i pastrojnë rrugët në ato pjesë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Milazim!

Atëherë, Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj:

I nderuari asamblist, nuk po e marr rolin e drejtorit të Shërbimeve Publike, por prej ekipeve që i kemi në terren të inspeksionit, më kanë raportuar tash që kanë filluar, kompanitë kanë

dalë dhe janë në terren nëpër disa fshatra në Gollak, duke e pastruar borën, ndërsa në Prishtinë të gjitha rrugët janë të pastruara.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Migjen Shala e ka fjalën.

Migjen Shala: Përshëndetje për të gjithë!

Unë i kam dy pyetje për drejtorin e Arsimit, që është këtu prezent, edhe pata dëshirë me qenë edhe kryetari këtu. E kam një pyetje, por pasi nuk është kryetari, është nënkryetari.

I nderuari drejtor, pse nuk barten me kompensim nxënësit e fshatit Trudë në shkollën "Anton Zako Çajupi", kurse relacionet më të shkurtara kompensohen nga Komuna e Prishtinës, nën një?

Nën dy, pse nuk mund të bëjnë praktikë nxënësit që studiojnë nëpër kolegje private në shkollat fillore të komunës së Prishtinës, përveç atyre që janë duke studiuar në kolegjin privat "AAB"?

Nën tre, i nderuari nënkryetar, pse Komuna e Prishtinës e vetmja dallohet prej të gjitha komunave në Kosovë, nuk financon Organizatat e Dala nga Lufta që veprojnë në komunën e Prishtinës, as mjete logjistike, as mjete financiare?

E vetmja është Komuna e Prishtinës, po hyjmë për të pestin vit, që nuk ndihmohet me asnjë cent organizata e veteranëve dhe dy shoqatat e dala nga lufta.

Kaq!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Urdhëro, drejtor!

Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Faleminderit për pyetjen!

Sa i përket shkollës fillore "Anton Zako Çajupi", unë kam informacion se të gjithë nxënësit barten, kemi pasur telashe me nja dy nxënës dhe kam urdhëruar që të rregullohet çështja e tyre, do ta verifikoj edhe njëherë këtë informacion dhe sigurisht do të jemi në kontakt.

Sa i përket praktikës, për kolegjet private, unë kam obligim parësor me ju siguruar me e bërë praktikën në kolegjet publike, po mendoj në Universitetet publike, bile unë as që kam të drejtë me i punësuar, ata duhet me iu dhënë përparësi këtyre të tjerëve. Nuk bëjë dallim në mes kolegjeve private, ndoshta është ndonjë, "AAB", që e ka kryer e ndoshta është edhe i punësuar, por sa i përket politikave të DKA-së, ne do të kemi obligim së pari t'i rehatojmë këta që kanë kryer Universitete publike, cilësia e kolegjeve private është bukur diskutabile, dhe unë jam i interesuar me e rritur cilësinë vetë. Ministria e di që i ka akredituar, për fat të keq, shumë universitete, por nga ana tjetër, vetë MASHT- i na ka thënë që në arsim duhet me i pranuar ata që kanë kryer universitete publike dhe sigurisht që Universiteti i Prishtinës është më i mirë në këtë aspekt.

Ju e dini që prej iniciuesit varet çdo gjë, kështu që unë po bëjë përpjekje që me e marrë cilësinë në pyetje. Ata është e vërtetë që kanë mesatare të lartë, shumë të lartë ndoshta, nëntë e kusur, mirëpo në të vërtetë dijet i kanë

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Sokol Havolli, urdhëro!
Më fal, Sokol, se nënkryetari e ka fjalën.

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës: Meqenëse unë sa e di, pa dashur të lëshohem në legjislaturat e kaluara, mirëpo ato çka kemi mundur t'i kuptojmë përmes mediave të ndryshme, janë më se njëqind banesa, të cilat iu kanë ndarë kategorive të luftës nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe janë dy parkingje apo tri, që kryesisht janë menaxhuar prej shoqatave të dala nga lufta.

Unë mund të them që gjatë këtij mandati, plan i yni është që parkingjet të cilat janë shfrytëzuar deri më tani nga shoqatat e dala nga lufta, ato do të duhen të futen nën juridiksionin e Komunës së Prishtinës dhe të menaxhohen në bashkëpunim pikërisht me organizatat e luftës, dhe kemi pasur takime me përfaqësuesit e juaj këtu brenda Komunës. Sigurisht që nuk janë vetëm ajo kategori, mirëpo ne kemi edhe varrezat e dëshmorëve, të cilat nuk janë të rregulluara, kemi shumë pika të UÇK-së, të cilat kanë qenë shtëpitë në funksion tonin e nuk janë të rregulluara, kemi shtabin në Zllash, i cili është i parregulluar, kemi rrugë të cilat nuk janë ndërtuar deri te shtabet apo deri te pikat ku kemi funksionuar ne në atë kohë. Janë punët e shumta të cilat neve na presin, mirëpo besoj që brenda katër viteve të ardhshme nuk do t'i kemi këto probleme.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Urdhëro, Sokol!

Sokol Havolli: Faleminderit, kryesues!

Desha t'i ngriti dy tema. E para, të kërkojmë prej Drejtorisë së Financave që të na informojë lidhur me të gjitha ato lëndë të shumta që ishin në procesin gjyqësor, nga ai raporti i famshëm për të cilin tash veç edhe paska filluar me shfaq kërcënime Dardan Sejdiu, po unë e kisha kërcënuar kush e voton atë raport, se është shumë i dobët, ka qenë tepër i dobët, kështu që po më çudit pse pretendon Dardani me qenë njëri prej ekonomistëve të mirë qysh kërcënon për atë raport katastrofal.

Megjithatë, aludim, po i përgjigjem atij aludimi, në rregull.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që t'i kemi, sepse aty, koha është duke më shkuar, unë prapë kam me e konsumuar kohën time, nuk e lejoj derisa të ndalen, sepse unë dua të flas për tema që dua t'i ngriti.

Është e rëndësishme shumë që të sjellën detajet e të gjitha atyre lëndëve gjyqësore dhe ta shohim se pse po humbin ato mjete financiare të Komunës nga ato lëndë gjyqësore, edhe nëse ka për shkak të gabimeve administrative të vetë zyrtarëve të Komunës, apo edhe vet drejtorive, atëherë ne duhet të ndërmarim masa çoftë nga ekzekutivi të merr masa, çoftë nëse nuk merr ekzekutivi masa dhe është i përfshirë në ato lëndë, ne atëherë të bëjmë denoncime, sepse duhet të jemi shumë të kujdesshëm me menaxhimin e parasë publike.

Çështja tjetër është lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, sidomos me çështjen e Trafikut Urban, tanimë ne informacionin të cilin e kemi në dispozicion është se Trafiku

Urban, me gjithë këtë gjendjen e mirë po e themi në kontekst të kualitetit të autobusëve, po arrin që t'i mbulojë shpenzimet për paga edhe për një pjesë të shpenzimeve operative. Mirëpo kjo çështje ka qenë shumë e diskutuar gjatë viteve të kaluara, duke u akuzuar LDK-ja në nivel qendror se nuk po e nënshkruan garancionin dhe nuk po e aprovon marrëveshjen me Ibi Ardin. Arsyeja ka qenë në atë kohë, edhe po e përsëris, e kemi thënë edhe atëherë se marrëveshja financiare e një komune duhet të aprovohet nga Asambleja komunale, sepse Komuna e merr borxhin. Tash Komuna e ka borxhin, sepse është aprovuar jo nga kjo Asamble, por nga e kaluara, edhe është pikërisht kjo që kanë dashur me i ikur ekzekutivi në të kaluarën.

Prandaj, tash më e dimë se prej këtij viti fillon edhe pagesa e kredisë për autobusët edhe Trafiku Urban është shumë larg kapacitetit, nuk ka kapacitet edhe nuk ka mundësi që ta realizojë atë. Do të thotë, duhet ta kemi një raport të detaizuar të Trafikut Urban, ta shohim gjendjen financiare të kësaj kompanie, por po ashtu të kemi edhe sqarime të nevojshme se si do të bëhet pagesa e kredisë, që nuk është kredi e vogël për kapacitetin e buxhetit komunal të Prishtinës.

Po ashtu është e rëndësishme të kemi raportet financiare edhe të kompanive të tjera, edhe po ashtu edhe të të gjitha ndërmarrjeve publike, natyrisht përjashtohen disa këtu që nuk kanë të hyra, por që kryen shërbime publike dhe që marrin përkrahje të drejtpërdrejtë prej Komunës, ato po besojmë të gjithë se nuk është shumë e nevojshme sepse nuk realizojnë të hyra të shumta.

Prandaj, shumë konkrete është që ta kemi një raport për ndërmarrjet publike dhe një raport në lidhje me lëndët gjyqësore në të cilat Komuna e Prishtinës po humb shumë mjete financiare dhe të identifikohet shkaktari. Nëse është administrimi i proceseve nga Komuna, apo nëse do të thotë ka kontekste normale gjyqësore sikur me prona apo me diçka tjetër, ato janë në rregull, mirëpo nëse këto ngjarje ndodhin si rezultat i neglizhencës të zyrtarëve komunalë, atëherë ne këto edhe do t'i ngremë si kallëzime penale që mos të lejojmë dëmtimin e buxhetit publik.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Sokol!

Urdhëro, Valbona Makolli!

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave

Faleminderit për pyetjen, z. Havolli!

Unë pas këtyre pyetjeve që i keni bërë dhe këto kritikë që i kam marrë profesionale prej të gjithë asamblistëve, kemi me u marrë me disa ndryshime në raport. Shpresoj edhe në bashkëpunimin tuaj edhe të gjithëve, që me dalë një raport sa më i mirë që është i mundshëm.

Sa i përket lëndëve gjyqësore, e kam bërë një raport të hollësishëm, e kam dërguar, kështu që do ta keni në fund të muajit prill, me tremujorin, për të gjitha ato lëndë që janë ende kontestuese, por e kam shtuar edhe një rubrikë aty poshtë "natyra e tyre", për çfarë natyre të problemeve janë.

Edhe për Trafikun Urban do të përfshihet në informacionin për raportin financiar për TM1, përfshirë periudhën janar – mars 2018.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Eman Rrahmani është lajmëruar për një replikë që e ka pasur.

Eman Rrahmani: Sokolit desha t'i tregoj se nuk ka qenë kërcënim fizik, por kërcënim që me u kthyer Dardani prej të 13-it me u marrë me neve për shkak që nuk po i shkojnë në vijë projektet e tij.

Drejtorit ia bëra një pyetje më herët, lidhur me ujin, gjegjësisht me pompat e ujit, për të cilat nuk më dha përgjigje, as nuk më tha që më kthen me shkrim. Kisha dashur ta di në çoftë se nuk ka mundësi me dhënë tash përgjigje, atëherë me më dërguar me shkrim, për shkak se janë dy lagje bajagi të mëdha që nuk kanë 24 orë ujë, d.m.th. nuk kanë asnjë minutë ujë dhe atyre ju duhet me bartur me kilometra ujin.

Po e shfrytëzoj edhe për një pyetje, pasi erdhi tash drejtori i Arsimit. Në shkollën në Bardhosh, nuk e di se sa jeni në dijeni, prej shtatorit mungojnë dy mësimdhënës, një për gjuhë zgjedhore dhe një për gjuhë gjermane, që do të thotë se nuk është mbajtur asnjë orë mësimi që nga shtatori, Nuk e di tash në bazë të ligjeve çka janë, sa kam mundur me parë, është i pamundur vlerësimi në fund të vitit në çoftë se nuk e mbanë 70% të lëndës, nuk e di si keni me vepruar tash kur jemi në këtë kohë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Le të përgjigjet drejtori e pastaj, vetëm nëse është për çështjen e Dardanit, mos, të lutem, se mos të banalizohemi por të jemi të fokusuar.

Atëherë, tek të ndryshme atë pikë e diskutojmë.

Urdhëro, drejtor!

Këtu është pyetje dhe përgjigje për drejtorë, nuk është pyetje për kërcënime, diçka të jashtme elemente të sigurisë.

Ajo diskutohet tek të ndryshme, e thash në fillim.

Po për çështjet që kanë të bëjnë këtu, ai e bëri shkeljen që e përmendi.

Kështu nuk mundem me debatuar, të lutem ulu atje, Sokol, replikën e merr nëse është pyetja, kështu, të lutem.

Drejtor e ke fjalën.

Sokol, vetëm për çështje që kanë të bëjnë me Kuvendin dhe brenda pikës së rendit të ditës, ajo çështje është tek të ndryshme.

Emani e keqpërdori, se replikë e kërkoi për drejtorin edhe ti e ngrite prapë në kohën.

Të lutem, nuk e lejoj këtë formë të diskutimit, të lutem, ulu të lutem, Sokol, ulu ta sqarojmë problemin.

Replikën e kërkoi me drejtorin.

Ju lutem, tash e përmendi emrin për një çështje që nuk është në rend të ditës, unë ju thash për këtë çështje diskutojmë tek të ndryshme.

Edhe nuk ishte korrekte nga Emani që e ngriti prapë këtë problem tek kjo pikë, kur u morëm vesh që te "Të ndryshme" me diskutuar.

Replikën e ka kërkuar më herët lidhur me drejtorin.

Jo, çështjet janë se nuk kanë të bëjnë me rend të ditës, Sokol çështja nuk ka të bëjë me rend të ditës.

Jo vetëm një sekondë, gjithë ditën e përmendë një çështje, ku di unë, një çështje të madhe që nuk ka të bëjë me Kuvendin komunal, replikë nuk mundem me të dhënë se nuk ka të bëjë me punën e Kuvendit.

E thatë vetë u bëtë të sinqertë dhe e thatë.

Drejtor, të lutem, e ke fjalën!

Pas drejtorit e ke fjalën.

Vetëm në momentin, regjia, në momentin kur të përmendet ajo çështje, të lutem e ndërpreni fjalën, për atë çështje jo. Jo pikërisht është detyrë e imja, askush nuk mundet me treguar se çka me folur përveç meje këtu, se janë pikat e rendit të ditës.

Replika vetëm për pika të rendit të ditës e jo çka janë tema jashtë rendit të ditës, jo ajo nuk është, më vjen keq, unë këtu dua të jem rigoroz në respektim të Rregullores.

Drejtor, të lutem, e ke fjalën!

Gëzim Mehmeti: Z. Rrahmani, unë e mora si obligim dhe detyrë që me ju njoftuar me shkrim. Sa i përket vendosjes së pompës, kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me KUR "Prishtina", do të thotë se ata janë përgjegjës për vendosjen e pompës në lagjen "Kodrën e Trimave". Do të thotë, unë do ta bëjë një kërkesë zyrtare nga ata e pastaj do të ju njoftoj.

Edhe një gjë, kam qenë prezent në atë takim i cili ka ndodhur rastësisht, edhe për hir të së vërtetës duhet t'i them këto fjalë.

Nuk ka qenë kërcënim, Eman, kemi qenë unë, z. Pireva edhe ti, vetëm ka qenë një mendim i Dardan Sejdiut, edhe nuk është mirë të bëhet tema private pjesë e debateve këtu.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Sokol, po të premtoj se do ta ndërpres fjalën nëse vazhdon me këtë temë, se është jashtë rendit të ditës.

Sokol Havolli: Kryesues, unë e kam një pyetje për juve, që ndërlidhet me punën tonë të të gjithëve këtu si asamblistë, se si i trajtojmë situatat kur vjen dikush nga jashtë, p.sh, një deputet, edhe shfaq presione apo kërcënime ndaj asamblistëve, edhe dua me ditë prej juve masat që do t'i ndërmerri. Megjithëse unë personalisht nuk i kam marr seriozisht as në tri vitet e kaluara, e jo po i marr tash, mirëpo që një pyetje kështu për juve.

Faleminderit!

Kryesuesi: Atëherë, nëse është çështje e sigurisë, nëse është çështje serioze, vetëm të lutem, nëse është çështje serioze, por kjo është banalizuar tepër këtu, është banalizuar ekstrem shumë, por nëse është çështje e sigurisë, është Policia për këtë çështje, nëse e konsideron si çështje të sigurisë, çështje të rrezikshmërisë personale, është policia që e trajton.

Atëherë vazhdojmë me Adrian Berishën.

Më fal, drejtor, urdhëro!

Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Ju faleminderit për pyetjen!

Ne kemi telashe serioze me gjuhën gjermane, sepse po e zbatojmë kurrikulën e re, d.m.th. për klasë të para, të gjashta dhe të dhjeta, dhe nga klasa e gjashtë është futur gjuha e dytë, gjuha gjermane, dhe nuk e kemi vetëm atë shkollë, kemi edhe diku - diku tjetër ku

humbim orë e janë bërë përpjekje të bëhet kuadër se po kemi telashe, se as masteri nuk përgatitet tek ne, kështu që jam në dijeni për atë punë. Po ashtu, për mësim zgjedhor, mësim zgjedhor sigurisht është lëshim i drejtorit, ne do të marrim masa për këtë punë, se mësim zgjedhor duhet patjetër të organizohet, se nëse humbet mësimi zgjedhor, sigurisht se dikush ka me u përgjigjur, llogaridhënia ka me qenë. Por unë mund të ju them çka kemi pasur pak telashe, unë e kam gjetur një proces të rekrutimit të kuadrit, jo bash i standardit të lartë.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Adrian Berisha e ka fjalën.

Adrian Berisha: Përshëndetje për të gjithë!

Fillimisht e përgëzoj ekzekutivin për punë në dyjavorin e fundit në sheshin "Adem Jashari", shkallët e lagjes Arbëria", d.m.th që qytetarët janë treguar të kënaqur shumë dhe vetëm vazhdoni kështu.

Te sheshi i qyteti kisha me u ndalur, e kisha përgëzuar drejtorin, Brahim Mehmetaj, që e ka marrë parasysh kërkesën tonë, shumë kënaqësi me kaluar në shesh e mos me e parë boks in aty edhe mos me i parë ato lodrat të Kinës pa lidhje aty.

Kur jemi tek sheshi i qytetit, e kisha pasur një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, d.m.th. si është e mundur një Kompanisë me iu dhënë leja për me bërë promovim në shesh të qytetit, kurse një kompanisë tjetër jo, d.m.th. ka qenë Kompania "FLOW" Kompani vendore, e cila ka pasur me bërë promovim të produkteve të veta, asaj nuk po i jepet leja, kurse një kompanisë tjetër jo. Një rast tjetër është kështu: Kompania "NIKE", brend botëror, ka pasur me vendosur një kuti të madhe në të gjitha kryeqytetet e botës, d.m.th. i vetmi kryeqytet që e ka refuzuar këtë kërkesë ka qenë Prishtina. Do të thotë edhe është në rrezik kompania e cila e ka përfaqësinë e brendit "NIKE", me humbur përfaqësinë që e ka për Kosovë vetëm për këtë shkas.

Isha ndalur pak te "Kurrizi", d.m.th kisha sugjeruar me i vendosur dy kunjë në udhëkryqin, apo shtylla antiparking po i thojkan në zhargone, më fal, kunjë - kunjë, por unë po eci lirshëm nëpër trotuare, është shumë e rëndësishme qysh i themi, nuk ka lidhje praktika.

Unë vetëm kisha sugjeruar që me i vendos vetëm edhe dy shtylla antiparking, sepse kerret po hyjnë deri lart në Kurriz, d.m.th. është kërkesë e banorëve, është pra vetëm edhe dy me i vendosur edhe kryhet krejt problemi.

Tani po kthehem edhe tek drejtori i Inspeksionit. "Kurrizin" edhe restorant "Nazin" e kemi shumë problem lagjja jonë, e kemi shumë problem sepse restorant "Nazi" po i hedh mbeturinat në vend jo të duhur, d.m.th. sepse me sa e di unë është një Rregullore për hedhjen e mbeturinave të kompanive, edhe nuk kanë të drejtë me i hedh mbeturinat, sidomos ato ushqimore, në shportat e mbeturinave që i hedhin mbeturinat qytetarët, d.m.th. në këtë rast po ankohen sidomos banorët, që kanë filluar me ardhur qentë endacakë edhe me u kthyer "buba-shfabat" në lagjen tonë, kështu po më thonë shkaku i hedhjes së tepërt të produkteve ushqimore.

E kam, një kërkesë prej studentëve, të cilët mësojnë në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani", është një objekt bunker afër Shkollës fillore "Ismail Qemali" i cili shfrytëzohet vetëm për me i vendosur pajisjet e tyre d.m.th "Hortikultura", pajisjet janë duke i vendosur, edhe ata po kërkojnë se si është e mundur ai objekt me u shfrytëzuar për me mësuar këta, për arsye se është tepër i ngarkuar si objekt te shkolla fillore "Dardania".

Një kërkesë tjetër e kam për objektin e "Termokosit", apo për oxhakun (qyngun) se unë pak po foli me gjuhë të rrugës, por çka me bërë, d.m.th. ka kërkesë prej artistëve të ndryshëm që atë, sepse ajo nuk shfrytëzohet më, ka kërkesë që atë qyng me kthyer edhe me e bërë me një vepër artistike, kisha pasur dëshirë me e ditur se ku me u drejtuar.

Edhe së fundmi për WC-të publike, në shesh të qytetit janë vetëm dy WC. Publike, të cilat janë në gjendje jo të mirë, kisha sugjeruar për me pasur më shumë WC publike në sheshet, veçanërisht në lagjen tonë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Adrian!

Urdhëro, drejtor!

Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj: Është një temë që ne e trajtojmë, por unë po ju njoftoj që është një marrëveshje me ndërmarrjen "Pastrimi", është një orar i caktuar kur ata dalin dhe i grumbullojnë të gjitha produktet ushqimore, eshtrat edhe prej mishtoreve, por edhe gjellëtoreve.

Ka ndonjë rast i veçantë që nuk ka bërë kontratë të veçantë me ndërmarrjen "Pastrimi", do të kujdesemi për këtë punë, unë sigurisht se i dërgoj inspektorët me e parë se si është puna me gjellëtoren "Nazi", por Kurrizi sigurisht që duhet me u trajtuar pak më specifikisht, për shkak se aty ka shumë mundësi me u ndotur ambienti edhe në forma të tjera.

E kuptoj shqetësimin e banorëve, e kemi bërë një aksion, por, megjithatë do të punojmë që me e zgjidhur këtë problem.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Edhe nënkryetari deshi një përgjigje.

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës: Adrian, nëse ka qenë kërkesa e nxënësve të shkollës fillore "Ismail Qemali" për shfrytëzimin e asaj hapësire, e cila është si strehimore, në pjesën lindore të shkollës a po, ajo është në gjendje shumë të mirë, është e vërtetë që një aneks i saj përdoret si lloj depoje prej ndërmarrjen "Hortikultura", ajo mund të eliminohet menjëherë prej aty dhe ajo hapësirë mund t'u jepet në shfrytëzim nxënësve pa asnjë problem.

I ka të gjitha kushtet, e ka ndriçimin, e ka kanalizimin, i kanë tualetet, e ka laminatin, d.m.th. dyshtemenë. Pra, janë të gjitha kushtet për shfrytëzim, mirëpo ventilimi nuk e di sa është në shfrytëzim, nuk e di ekziston ventilimi a është funksional apo jo, nuk e di, mirëpo për këtë çështje mund të vendosni ju, d.m.th. të ju jepet në shfrytëzim. Edhe në rast të nevojës që mund të shfrytëzohet për çfarëdo fatkeqësie, besoj se aty do të ketë edhe karrige

dhe inventar të imët, se nuk do të ketë diçka e cila e cenon atë hapësirë që në një të ardhme të shfrytëzohet si lloj strehimoreje. Kështu që ajo është e shfrytëzueshme edhe mund t'u jepet kjo hapësirë pa asnjë problem atyre fëmijëve të cilët mund ta shfrytëzojnë këtë hapësirë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Mustafë Krasniqi e ka fjalën.

Mustafë Krasniqi: Faleminderit, kryesues!

E para, kryesues, për me pasur situata të ngjashme siç ke pak më herët me kolegun Havolli, është mirë që të përdoren kritere për të gjithë njësoj, edhe unë po besoj që në rastet e tilla do të ketë mirëkuptim prej të gjithëve.

Arsyeja pse e mora fjalën është se kam një kërkesë prej drejtorive përkatëse, që një segment i rrugës për Grashticë, konkretisht rruga që lidhë disa lagje të Grashticës së Epërme, është në gjendje shumë të rëndë dhe kjo në mungesë të mirëmbajtjes, për shkak se aty ka erodime të shumta, apo shembje të dheut. Janë mbyllur kanalet të cilat shërbejnë për largimin e ujërave dhe të gjithë ato ujëra tash rrjedhin në sipërfaqe të asfaltit, prandaj edhe është dëmtuar në masë të madhe. Përpos kësaj, vërtet edhe ajo rrugë apo grykë e asaj rrugës, është shndërruar në deponi inerte që po e kanë, por po fshihen, por e kanë më lehtë, sasi shumë e madhe e mbeturinave prej qytetit drejtohen pikërisht në atë segment rrugor. Prandaj, kërkoj që të merren masa, sepse më pak i kushton buxhetit të Komunës që të mirëmbahet ajo rrugë sesa nesër të trajtohet e tëra apo t'i jepet një shtresë e re e asfalti. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Urdhëro, drejtor!

Gëzim Mehmeti: Kjo është kompetencë e Shërbimeve Publike, prandaj nuk jam i thirrur me dhënë përgjigje.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Shefki Gashi e ka fjalën.

Shefki Gashi: Faleminderit, kryesues!

Unë, më obligoi, kah shkoi ai djali, ai patrioti, Egzoni, OK. Patrioti, se puna e patriotizmit është bërë sikurse kërkesa për krip, se atyre që iu mungon kripa t'i hanë edhe teshat.

Ai e bëri pyetjen, banesat e uzurpuara. Dëgjoni, mos lejo, kryesues, propaganda në Kuvend, ato banesa nuk janë të uzurpuara, por i ka dhënë ky Kuvend me një Komision ... Komuna e cila i ka ndërtuar edhe nja 600 banesa për skamnorët për atë afat, e këta shokët nuk e kanë ndërtuar asnjë. Nëse ato vendime të Komunës janë të pavlefshme për ata banorë atje, të pavlefshme janë edhe për banorët që jetojnë në "Dardani", në "Tophane", ku ka banesa kolektive që ua ka dhënë Tito apo kush ua ka dhënë, edhe ne ashtu ua kemi dhënë.

Nëse është e ligjshme prona që ia kemi dhënë Fadil Hoxhës, ia ka dhënë Tita bakshish a po kupton a jo, është edhe Ramushi që ia ka dhënë kjo Komunë, është edhe e Halimi që ia ka dhënë kjo Komunë. Nëse këto janë të paligjshme, të tyre "ex officio" duhet baba, kryetari i Komunës që e ka marr banesën, edhe unë kam pasur nevojë se shtatë vëllezër në një dhomë kemi fjetur, por mua nuk më kanë dhënë, por ata ua kanë dhënë të dashurëve të tyre. E tash me i thënë po dom me ia falur familjes Jashari mos me ia marr 20-30 euro që nuk ka vendim, ai është vendim i përhershëm, ai është etalon, iu ka falur ky Kuvend, ia ka falur, kurse këtyre të tjerëve e kanë me kontratë dhjetëvjeçare, me mundësi vazhdimi, lexoni vendimet zotëri, mos përhapni propaganda e sende të ndyta këtu para opinionit.

Është vendimi, nëse këta nesër shpallin tender ose konkurs, apo si i thoni aplikojnë, e nëse ky nuk i ka paguar qiranë e caktuar dhe nëse ka bërë shkelje, i merret e drejta, e nëse jo, i vazhdohet kontrata për dhjetë vjet plus.

Prandaj duhet ta keni një ligj, e mos kërkoni ju vota këtu për me e legjitimuar demek uzurpimin e banesave, të cilat edhe me ua dhënë atyre që nuk kanë, atyre është dashur me menduar ju këtu me i ndërtuar edhe nja 500- 600 banesa tjera ose 200-300, ose 100, por nuk e keni ndërtuar asnjë, prandaj leni propagandën, por kërko falje zotëri.

E dyta, pyetja për ty, kryesues. Këta qenkan bërë dy grupe, unë sa herë kam qenë LDK jam ulur andej, kam qenë partia më e madhe, e kur isha LDD isha më e vogla, ulesha atje në qosh.

Prandaj ne duhet me e bërë riradhitjen e karrigeve në asamble, me e ditur se cili grup i asamblesë është më i madhi e ka vendin atje, e grupi më i vogël e ka këndeje.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Do të mblihdhemi me grupet parlamentare dhe do ta diskutojmë atë çështje.

Rifat Deri e ka fjalën.

Rifat Deri: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për nënkryetarin Pacolli, drejtorët, kolegë deputetë, mediet prezente.

Unë i kam tri pyetje.

Pyetja e parë është kjo, krejt është në kërkesë të qytetarëve, pyetja e parë ka të bëjë me "Prishtina Parking", ka kohë që është paralajmëruar puna e kësaj ndërmarrje komunale një herë dhe deri tani nuk kemi vërejtur ndonjë veprim konkret. Prandaj, unë kam disa pyetje lidhur me këtë çështje, që mendoj se janë goxha me rëndësi për banorët e Prishtinës.

Pyetja e parë, kur saktësisht fillon punën kjo ndërmarrje publike, a është kryer zoonimi i plotë i qytetit që ndërliidhen me tarifrat e pagesave për parking, a është zgjidhur, dhe nëse po, si është zgjidhur çështja e parkimit të veturave për banorët e zonave që preken nga kjo ndërmarrje publike "Prishtina Parking"?

Kur do të nisë ndërtimi i parkingut para Fakultetit Filozofik – Filologjik, për të cilin unë jam kategorikisht kundër, dhe a është e zgjidhur çështja e definimit të parkingjeve nëpër zonat publike që aktualisht menaxhohen nga persona fizikë, apo edhe kompani private. Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë, ka të bëjë, besoj se kjo i bie Drejtorisë së Investimeve Kapitale, kemi të bëjmë me ndërtimin e një intineratori, i cili është djegës i kontrolluar i mbetjeve shtazore dhe medicinale.

Siç pamë më parë, Adriani tash e përmendi në lidhje me këtë "Nazi" qebaptore, "Nazi" gjellëtore apo çka është, si dhe herën e kaluar dikush e ka përmendur këtu në Kuvend në lidhje me kundërmimin në Kurriz, për shkak të mbetjeve shtazore të mishtoreve të cilat gjenden në tunel, po mendoj i kanë të hedhura mbeturinat në tunel.

Besoj se kjo do të jetë një pyetje mjaft me rëndësi dhe do të jetë një investim shumë i mirë dhe i qëlluar në vend për mbrojtjen e mjedisit dhe ambientit në komunën e Prishtinës, pra ndërtimi i një intineratori, dhe besoj se drejtorja përkatëse do ta marrë mjaft seriozisht.

Pyetja e tretë, të cilën e kam për sot, është kërkesë e qytetarëve të din se kur fillojnë zgjedhjet lokale nëpër bashkësitë lokale në komunën e Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Dikush nga drejtorët.

Urdhëro, drejtor!

Gëzim Mehmeti: Z. Deri, faleminderit për pyetjen!

Në plan të veprimit për vitin 2018, nuk është paraparë ndërtimi i intineratorit për djegien e mbeturinave shtazore, do të thotë se duhet me u bërë një kërkesë e re dhe në bashkëpunim me drejtorit e tjera me u shqyrtuar.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Agim Gashi e ka fjalën.

Agim Gashi: Faleminderit, kryesues!

I kam dy pyetje të shkurta për drejtorin e Arsimit dhe ndoshta dy për Shërbimet Publike.

Pyetja e parë është: Sa shkolla të Prishtinës janë duke i përgatitur nxënësit për testin PISA/ Këtë po e them për arsye se vitin e kaluar është bërë shumë zhurmë në këtë fushë, janë akuzuar arsimtarët, janë akuzuar nxënësit pse nuk kanë ditur, pse kanë ditur, ky është një standard i ri i instaluar në jetën tonë shkollore dhe ka nevojë që të jepen udhëzime, këshillime të natyrave profesionale, në mënyrë që nxënësit t'i qasen drejt, thjesht, testit të cilit kanë me iu nënshtruar.

Nën dy, drejtori meqenëse e ka marrë mandatin e ri, ndoshta nuk e din që në shkollat e Prishtinës në aspektin procedural, si mos qasje ekzekutive e ekzekutivit të Prishtinës që përcjell fushën e arsimit, kanë humbur shumë orë mësimore, mos të them me mijëra, në shkollat e Prishtinës, si rezultat i shfrytëzimit të pushimeve mjekësore dhe pushimeve të lehonisë.

Ju e dini strukturën gjinore të të punësuarve në arsim, ku janë të punësuar mbi 80% femra, dhe i kanë ato të drejta dhe i shfrytëzojnë dhe nuk dërgohen zëvendësimet me kohë kur mësimdhënësi shkon në pushim të lehonisë ose kur merr pushim mjekësor.

Çka ka pasur udhëzime nga drejtorja, se deri në një muaj ne nuk dërgojmë zëvendësimin, por mbetet kompetencë e shkollës. Meqë se drejtorja është kompetente, ka punuar dhe e dinë çka do me thënë me munguar një muaj ditë një mësimdhënësi dhe e di se brenda shkollës nuk mund të ketë kapacitete për zëvendësimet. A është marrë masë konkrete që ajo

punë të sanohet dhe të mos humbin orë mësimore si rezultat i pushimeve mjekësore dhe pushimit të lehonisë.

Ne kemi statistika, por nuk po dua me ju marr kohë për këtë punë.

Tek Shërbimet Publike, Shërbimet Publike janë alfa dhe omega e pushtetit lokal, pyetja është e thjeshtë.

Pse kompanitë mirëmbajtëse dimërore të rrugëve nuk i pastrojnë rrugë e komunës së Prishtinës, që do të thotë nuk i pastrojnë kanalet, nuk i pastrojnë gypat, nuk e heqin dheun, gurët etj. me kohë, në mënyrë të shpejtë, por lejojnë dëmtimin e rrugëve, për të cilën patëm shumë pyetje këtu. Ato nuk janë vetëm me pastruar borën, me hedh krip, e njëjta ndodh edhe gjatë verës, mirëmbajtja verore, pse nuk bëhet pastrimi efektiv i rrugëve, në mënyrë që mirëmbajtja të shpreh atë gatishmërinë e preventivës për mos me u dëmtuar rrugët dhe kapitali i Komunës së Prishtinës.

Tek mbeturinat, shikoni, në shumë vendbanime të Prishtinës nuk grumbullohen mbeturinat nga kompania "Pastrimi". Në njëfarë kohe u rregullua disi mirëmbajtja dhe tani është ndërprerë dhe nuk grumbullohen mbeturinat. A e dini çka do të thotë prej Grashticës deri në Slivovë, atje te Llabjani, mos me u grumbulluar fare mbeturinat. Ku munden ata me i gjuajt, krejt në Liqenin e Badocit!

Ju lutem, detyrë e Komunës, sepse Komuna në bazë të Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, është përgjegjëse për grumbullimin dhe dërgimin e mbeturinave në deponi. Kjo nuk po ndodh në Prishtinë.

Edhe tek mbeturinat në qytet e veçanta, që janë mbetjet nëpër mishtore, mbetjet nëpër lokalet afariste, të kuzhinave etj., ato rregullohen me kontrata të veçanta.

Inspeksioni e ka për detyrë me shkuar dhe me kontrolluar listën e këtyre veprimtarive, a i kanë lidhur kontratat me kompanitë e autorizuara. Nëse nuk i kanë lidhur e nuk grumbullohen ato në këtë mënyrë, ato hedhen në kontejner, që është e ndaluar, rreptësisht është e ndaluar, nuk guxojnë eshtrat me u hedh në deponi në Mirash, është procedurë tjetër e veçantë, dhe këtu me këto punë nuk merret askush. Nuk merret askush që tash shkojmë në Dardani, e shohim atë vendkalimin tek Kurrizi se çka ndodh me mbeturina.

Është fushë që me të vërtetë nuk zgjidhet lehtë, por duhet me u marrë dikush me këtë punë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, z. Gashi!

Urdhëro, drejtor!

Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit: Faleminderit z. Gashi, për pyetjen!

Sa i përket vlerësimit PISA, ne e dimë në nivel të Kosovës që kemi dal në 2015, edhe unë e kam thënë edhe publikisht, tash ne presim një ngjitje në tabelë, nuk presim rezultate spektakulare. Edhe gjermanët kur ja kanë nisur kanë qenë keq, se le më ne.

Sa i përket Prishtinës, besoj se Prishtina ka me qenë prapë më e mira në Kosovë. E kemi një koordinator për testin PISA, ka takime të rregullta me MASHT-in, unë posa erdha nga një takim i tillë dhe po shpresojmë se këtë vit do të kemi rezultat shumë më të mirë. Normalisht, mostrën e kanë marrë ata, ne aty nuk kemi kompetenca edhe mirë që ne po e vlerësojmë sistemin tonë shumë saktë e jo me telefona mobilë, qysh i bëjmë ne vlerësimet

në test të arritshmërisë dhe të maturës, por na e kanë dhënë vendin ku e meritojmë. Besoj se është mirë që janë identifikuar problemet dhe e dimë ku jemi.

Unë pres për shembull, që të kemi disa telashe në shkollat profesionale, se po supozojmë në Shkollën Bujqësore kemi një mostër prej 200 fëmijëve, janë zgjedhur 42, në gjimnaze po ashtu, prej të gjitha gjimnazeve janë zgjedhur një numër i vogël, e ne prej gjimnazeve presim suksesin maksimal, por nuk presim prej shkollave profesionale suksesin maksimal, se e dimë që është pak më e vështirë situata. Ata me qëllim e kanë marr numrin më të madh atje, me ju dalë rezultati. Ne jse, e kanë mostrën e vet, është mostra e tyre, por jemi duke punuar shumë, pothuajse çdo ditë unë e takoj koordinatorin e PISA-s dhe kam takime në shkollë, dhe pres lëvizje pozitive, rezultatet i shohim. Komentet dhe rezultatet janë në vitin 2019. Kjo ishte përgjigja për pyetjen e parë. I kemi njëzet shkolla, e kemi rritur edhe për tri shkolla, se Graçanica po merr pjesë, kështu që besoj se kemi me qenë mirë, jemi duke bërë çdo gjë me qenë mirë.

Ndryshimet në arsim nuk shkojnë shpejt, ti e dinë shumë mirë.

Sa i përket kësaj të dytës, humbjes së orëve, pajtohem, humbje ka pasur, unë i kam trashëguar nja pesëdhjetë mungesa për kokë nxënësi, ka prapë humbje, por për humbje nuk janë përgjegjës vetëm ato që po shkojnë, lehonat e kështu me radhë, por përgjegjësit tek Ministria, Sindikata që po bëjnë greva, gjashtë ditë të plota i kemi humbur. Ne nuk guxojmë fëmijët me i kurbanizuar, me i bërë kurban pse nuk na u kanë plotësuar disa kërkesa, se kanë me u plotësuar. Po besoj se këtu kam me pasur mbështetje prej asamblistëve, që mos me i përkrahur këto greva ku pësojnë fëmijët, me pësuar fëmija nuk ka kuptim.

E kemi një problem të madh me Ministrinë e Financave, që e kam trashëguar, unë sot e kësaj dite prej 3200 të punësuarve në komunë të Prishtinës, i kam 15 vetë jashtë listave të pagave, ku nuk mundem t'i jap pagë, se ata thonë tepër janë. Kur janë hapur paralelet e gjimnazeve, ata nuk e kanë qitur buxhetin, neve na kanë thënë hapini paralelet edhe pastaj njerëzit na i kanë lënë pa i financuar, se le më lehonat, dhe ne i kemi sot, sot muaji i tretë po hymë, ku 14 të punësuar, profesorë, nuk marrin pagë dhe mu ka dashur të takohem sot me ministrin, me kryeministrin, që me bërë apel me e zgjidhur këtë problem, sepse ndryshimet në arsim financat nuk i kuptojnë, se një lehonë shkon sot dhe duhet me e zëvendësuar menjëherë. Kur të zëvendëson për një muaj ai nuk e fut në listë të pagave, nuk e paguan atë, kështu që këto janë probleme të mëdha të krejt sistemit tonë, nuk është vetëm Prishtina, por Prishtina ka më së shumti, se ne kemi më shumë fëmijë, i kemi gati 50 mijë fëmijë.

Jemi duke punuar në këtë drejtim, jemi duke punuar që mungesa të ketë shumë më pak, në shkolla profesionale kemi më shumë se në gjimnaze, varet shumë prej cilësisë së fëmijëve, normalisht, por besoj kryesorja varet prej nesh. Trupi arsimor, udhëheqja e shkollës, ku kemi drejtor të mirë, ku kemi personel të mirë kemi pak mungesa, ku kemi drejtor jo të mirë, jo efikas, po ashtu kemi shumë mungesa, shumë parregullsi.

Një problem tjetër që po dua me e shfrytëzuar për të ju informuar tash, është se kemi telashe serioze me disa arsimtarë nëpër shkolla, të cilët janë të sëmurë nga sëmundjet malinje, të cilët detyrohen të vijnë në shkollë. Kam kërkuar dhe po ju kërkoj edhe juve, që ta mbështetni iniciativën që këta njerëz me u dërguar në pension të parakohshëm me një pagë prej 70%, sepse ata janë të sëmurë, por kemi edhe me probleme mentale diku-diku.

Kemi probleme të mëdha dhe ata fëmijë pësojnë nga ne të rriturit, kështu që nuk është puna vetëm e lehonave, se ato i zëvendësojmë disi, por problemin e kemi një njeri që i maltreton fëmijët me vite të tëra dhe nuk është larguar nga sistemi, nuk e kemi lehtë me e larguar, do duhej një Komision mjekësor e kështu me radhë.

Jam duke bërë përpjekje, bashkë me juve sigurisht, kam me ju njoftuar për çdo gjë, në mënyrë që me i zgjidhur këto probleme.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Po, urdhëro!

Agim Gashi: ... financat dhe pagesa e pagave. Komuna e Prishtinës i ka rikthyer shërbimet e çerdheve, kuzhinës së çerdheve në kompetencë të vetën. Shumë shërbime në shkolla mund të privatizohen, shërbime teknike, dhe të lirohet buxheti për të krijuar hapësirën në të cilën pastaj nuk bllokohet procedura e zëvendësimeve. Ju e dini se është një formulë që rregullon çështjen e financave atje, dhe ajo formulë nuk mundet me u zbatuar, për arsye se duhet t'i mbyllim shkollat paralelet gjugje dhe shkollat ku numri i nxënësve është i vogël, nuk po hyj në atë temë se është shumë e gjerë. Por, duhet të gjendet forma, kur po gjenden paret me u paguar kontratë mbi vepër me këta njerëz pse nuk gjenden pare me u paguar arsimtarët që zëvendësojnë, për arsye se buxheti i rregullt i Komunës nuk e mbulon, por ka mundësi që ky Kuvend të marrë vendim që nga mjete shtesë të ndahen mjete dhe të paguhen ato që nuk janë dallim shumë i madh, do të thotë ka zgjidhje në këtë punë, por duhet gatishmëri.

Nën dy, Zyra, kjo që po bën pranimin e punëtorëve, si po i thonë "për burime njerëzore", nuk mundet me e përcjell fushën e arsimit, kompetenca duhet t'i kthehen drejtorisë, sepse i ka katërmijë të punësuar dhe nuk mundet kjo zyrë me e përcjell lëvizjen e punëtorëve në arsim dhe duke thënë se ne jemi transparent! Transparencë mundet me pasur edhe atje, por kompetenca duhet me iu kthyer asaj drejtorie dhe ajo drejtori me e përcjell këtë ndryshueshmëri.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Po, drejtor.

Jonuz Salihaj: Faleminderit, Agim!

Ke të drejtë në këtë konstatim, jemi duke punuar, Zyra e personelit rekruton kuadro për Komunë, DKA rekruton kuadro për arsim.

Zyra e personelit po ti kishte edhe njëzet të punësuar, nuk do ta njihnte strukturën e arsimit qysh e njoh unë, dhe me kryetarin jemi marrë vesh që komisionet ti formojë vetë, normalisht edhe me një zgjedhje shumë më të gjerë edhe nga jashtë, edhe nga OJQ-të, kjo është me Ligjin e arsimit universitar, asgjë nuk po shpikim. Nëse Zyra e personelit e ka bërë përpara, e ka thyer ligjin, ka bërë shkelje ligjore, tash kjo më nuk lejohet dhe ka me u bërë ashtu, andaj dhe kërkoj mbështetjen tuaj.

Sa i përket këtyre orëve të humbura për një muaj, vërtet kemi pasur problem, si të kalon mbi një muaj disi i futim listat, por kemi kuota, p.sh. ata thonë në parashkollor nuk e keni tejkualuar numrin, në shkollë të mesme të lartë e keni tejkualuar, ne detyrohemi me i marr tash disa parashkollorë e me i qitur kuotat me i bërë shifra, sepse, për fat të keq, Ministria e Financave na sheh si shifra e jo si të punësuar, se ata i kanë shifrat, ata operojnë me shifra. Deri tash e kemi tejkualuar disi, por unë kërkoj një zgjidhje të qëndrueshme, se nuk shkon çdo muaj me shkuar si me u lutur atje, sikurse me qenë kjo pronë private e jona, punëtori i ka orët, punon dhe le të paguhet. Nuk ka ende gatishmëri, por po besoj se po e përgatisim terrenin që kjo të ndodhë.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, Fiknete, të lutem, vetëm një sekondë!

Atëherë, po propozoj që drejtori me e dhënë përgjigjen për z. Rifat Deri, më herët që e bëri pyetjen për parking nëntokësor, edhe të shkojmë në pauzë, nëse jeni dakord.
Urdhëro, drejtor!

Genc Bashota: Faleminderit, kryesues!

Parkingu tek Fakulteti Filologjik është një storie pak më e gjatë, por po mundohem me e përmbledhur sa më shkurt që mundem.

Është projekt në partneritet publiko-privat, i kërkon procedurat që do të thotë ne kemi punuar nja gjashtë muaj me Dielait-in, si kompani që e kemi të kontraktuar në Komunë për me e kompletuar dokumentacionin, i cili më pastaj dorëzohet në Komitetin ndërministror të partneritetit publiko-privat, të cilët e japin vizën për më tutje. Ligjërisht, kanë një muaj të drejtë Komiteti ndërministror me e aprovuar apo me e refuzuar.

Qeverisja e kaluar, Komiteti ndërministror i qeverisjes së kaluar, dhjetë muaj nuk ka dhënë përgjigje definitive, kanë bërë opstrukcione të pafundme, do të thotë një grup ministrash në krye me Avdullah Hotin, edhe së fundmi nuk janë përgjigjur, nuk kanë bërë vendim, kanë bërë disa kërkesa që janë jashtë kompetencave të tyre, si me thënë bërë njëherë një marrëveshje me Universitetin, hiqni do dyqane, jo kjo nuk po na pëlqen këtu, është jashtë kompetencave. Rifat, sa me ta sqaruar.

Në ndërkohë është krijuar Komiteti i ri, në këtë qeverisje, i partneritetit publiko - privat ndërministror. E kemi mbajtur takimin e parë para dhjetë ditësh, informues, na është premtuar që shumë shpejt do ta japin përgjigjen pozitive, presim javën e ardhshme që kjo punë me u përfunduar sa i përket një rekomandimi nga ky Komitet, për me hy më tutje në procedurat të cilat janë në bazë të ligjit.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Sokol Havolli e ka fjalën.

Sokol Havolli: Nëse nuk gabo, ishte çështja e parkingjeve, se me vonesë u kyça, por vetëm sa për sqarim, dua ta demantoj këtë që e tha drejtori Bashota, se Avdullah Hoti me Këshillin ndërministror e ka vonuar dhe nuk e ka vonuar.

Kjo çështje është adresuar me një shpejtësi relativisht të mirë, mirëpo ekziston edhe një arsye, se ekziston edhe Komiteti ndërministror për ndërmarrjet publike. Tash, me Ligjin e Prishtinës, e dimë se Komuna e Prishtinës ka me pasur të drejtë pa aprovimin e Qeverisë të themelojë ndërmarrje publike, mirëpo deri në atë fazë do të thotë Ligji ka qenë i tillë, dhe natyrisht është trajtuar komfor Ligjit, edhe është dhënë jo dhjetë muaj, asnjëherë nuk ka qenë dhjetë muaj, do të thotë është çështje 2-3 muaj, nëse nuk gaboj, se kur është dhënë pëlqimi për ndërmarrje publike, prandaj kjo e para nuk qëndron, se ka pasur vonesë.

Dhe e dyta, e vërteta është se tashmë janë bërë po thuajse dy vjet prej se është dhënë leja për ndërmarrjen publike "Parking", po edhe ajo tash kjo ndërlidhet edhe me çështjen e parkingjeve.

Faleminderit!

Kryesuesi: Po drejtor, urdhëro!

Genc Bashota: ... kompani publike, z. Havolli, është çështja e projektit me partneritet publiko-privat, nuk ka këtu kompani publike, as nuk kemi kërkuar krijimin e ... ajo është çështja për "Prishtina Parking", diçka tjetër çka ju jeni duke deklaruar.

Ok., sa i përket kësaj, unë jam shumë i saktë, lexoni Ligjin e partneritetit publiko-privat, e shihni që një muaj ditë Komiteti obligohet me Ligj me e dhënë aprovimin apo refuzimin, të cilin nuk e kanë dhënë që dhjetë muaj.

Me kërkesa është storie e gjatë, e kemi dhënë edhe në media vjet, nuk po dua me ju marrë kohë, por është muhabet i gjatë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

A po shkojmë në pauzë?

Po, po jemi ...

Në rregull, e kemi rregulluar atë.

Atëherë shkojmë në pauzë deri në orën 1:30.

Faleminderit shumë!

Atëherë vazhdojmë pasi kemi kuorum.

Fiknete Bejta e ka fjalën.

Fiknete Bejta: Ju kisha drejtuar drejtorit Mehmeti, me një pyetje apo me një kërkesë nga banorët e Lagjes së Spitalit afër EULEX-it.

E kam një pyetje me kërkesën e banorëve të Lagjes së Spitalit, afër EULEX-it, është rruga "Holger Petersen", ku rruga është e shkatërruar, ka gropa, mungon trotuari dhe pjesërisht është e ndriçuar. Banorët kërkojnë të dinë se a është në plan të veprimit për rregullim gjatë këtij vit, si dhe një pyetje tjetër, edhe pse nuk jam shumë e sigurt a është në kompetencën e Komunës apo i takon Postës. Është fjala për shkallët tek Posta e madhe. Ju e keni parë edhe vetë, nëse keni kaluar andej, që janë në gjendje të mjerueshme.

A ka ndonjë plan për rregullimin e atyre shkallëve?

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, drejtor!

Gëzim Mehmeti: Sa i përket rrugës “Holger Petersen”, unë e ceka edhe më herët se është bërë një plan i identifikimit dhe e kemi një plan dinamik të veprimit sa i përket gropave. Do të thotë, fillojmë në muajin prill, tash kemi bërë sanimin me kubëza, por me asfaltim fillojmë që nga muaji prill.

Shkallët aty përmbi platonë e Kurrizit, më duket se janë pronë e PTK-së, kështu që ne duhet, në marrëveshje me ta, janë të nevojshme për sanim dhe renovim, kështu që është pyetja në rregull, por duhet një marrëveshje me PTK-në.

Faleminderit!

Kryesuesi: Naime Osmani e ka fjalën.

Naime Osmani: Faleminderit, kryesues!

Unë i kam disa pyetje me radhë, por drejtori nuk qenka këtu, Dreni më duket. Në mbledhjen e kaluar na informoi që do të mbahet një takim me përfaqësuesit e Komunës dhe me përfaqësuesit e KEDS-it apo KEK-ut, nuk po e di. Nëse është mbajtur, pse nuk na ka njoftuar, por nëse nuk është mbajtur, unë kërkoj që të na njoftojë neve si asamblastë, po edhe kryetarët e bashkësive lokale.

Tjetra, në Rimanishtë, më kanë informuar banorët e fshatit Rimanishtë që afër shkollës në Rimanishtë, në afërsi prej 80 metrave, kanë dal ujërat e zeza, gjë që është rrezik për nxënësit se mos të përhapet ndonjë epidemi, pasi tash nuk pritet, por pak më vonë kur të nxehet koha mundet me u hapur ndonjë epidemi. I lus organet kompetente që të ndërmarrin masa, atje nuk është kanalizimi i rregulluar, por, megjithatë, të ndërmarrin masa paraprake që të sanohet ajo vijë me ujëra të zeza.

Tjetra, drejtori, ja erdhi Brahim Mehmetaj, edhe pak më parë e biseduam, po e ndiej edhe të arsyeshme që ta them këtu në Kuvendin komunal, se a janë ndërmarrë masa tek njerëzit e pandërgjegjshëm të cilët janë duke i shkatërruar pyjet, sidomos në pjesën Besi-Rimanishtë-Vranidoll. Janë duke i shkatërruar pyjet në masë të madhe, bile-bile kanë filluar edhe në prona private, gjë që unë personalisht po i frikohem ngatërresave, mos të vjen e të bëhet ndonjë gjë më e madhe, dhe ju lutem drejtor të ndërmerrni masa.

Rrugën që e ceka në mbledhjen e kaluar, drejtorja ka intervenuar, me thënë faleminderit, nuk po them faleminderit se është detyrë e tyre, është obligim, por, megjithatë unë po e ndiej për obligim me i informuar kolegët e mi që është intervenuar, por 99% është dhe i kuq dhe 1% gurë të bardhë, gjë që nesër, pasnesër nëse prapë dëmtohet ajo, unë prapë do ta them këtë.

Ju faleminderit, nuk po e zgjati më shumë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Brahim Mehmetaj e ka fjalën.

Brahim Mehmetaj: E nderuara asamblastë, është e vërtetë ajo që po e thoni ju.

Marrë parasysh gjendjen e përgjithshme të pyjeve në komunën e Prishtinës, si zonë më e dëmtuar zona Besi - Rimanishtë - Bërnice, edhe atë prej keqbërësve të cilët dihen, janë

gjobitur disa herë, ka fletëparaqitje ndaj tyre, mirëpo ne si Drejtori e Inspeksionit, jemi duke e bërë një plan tjetër të veprimit, me pa se cilat janë masat tjera që kishin mundur me parandaluar dëmtimin prej personave të papërgjegjshëm, që dihen me emër sa janë, nuk janë shumë, por janë të pandalshëm. Kështu që me siguri shumë shpejt e bëjmë një plan të veprimit, e kemi ftuar edhe rojën e pyllit në raport për të biseduar me të, ai na i qet përpara mjaft shumë fletëparaqitje, por nuk e zgjidh problemin vetëm shkrimi i fletëparaqitjes, por se si duhet ta ndalojmë këtë dukuri negative. Por ne do të punojmë në atë drejtim.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!
Gëzim Mehmeti e ka fjalën.

Gëzim Mehmeti: Znj. Osmani, posa i pyeta personat përgjegjës, ata do të dalin dhe do ta bëjnë verifikimin, testimin e materialit d.m.th. zhavorrit guror.
Ata më thanë gojarisht se qenka ngjyra e kuqe, por qenka material guror, por për çdo rast kur bie shi, thanë se duket se është sikur baltë, por ne do ta bëjmë testimin dhe do t'ua japim juve dhe do ta shikoni.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Valbona Ajeti e ka fjalën.

Valbona Ajeti: Faleminderit i nderuari kryesues!
Përshëndetje të nderuar drejtorë, këshilltarë dhe ju media!
Pyetja ime ishte për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, pasi që nuk është këtu prezent, unë do ta bëjë pyetjen rreth regjistrimit të nxënësve në shkollën fillore "Shkolla e Gjelbër" në Prishtinë.
Do të thotë, problemi i lagjes është se vijnë nxënësit nga lagjet e tjera, kinse banojnë aty afër shkollës, e nxënësit që banojnë afër shkollës me të vërtetë mbesin pa u regjistruar në atë shkollë, sepse dihet se "Shkolla e Gjelbër" është një shkollë me standarde të larta. A do të bëhet diçka lidhur me këtë problem, pres përgjigjen e drejtorit ose me shkrim, ose në mbledhjen e ardhshme.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë.
Sami Salihu e ka fjalën.

Sami Salihu: Faleminderit, kryesues!
Dua t'i ndajë me ju dy shqetësime rreth kërkesave të banorëve, njëra ndër to është nga banorët e lagjes "Përroi i Njelmët," ku në këtë lagje ekziston një hekurudhë e trenit në mes të rrugës, e cila e lidh Zonën industriale me lagjen "Përroi i Njelmët", e që u rrezikohet jeta këtyre qytetarëve dhe nxënësve, pasi që detyrohen të kalojnë atë hekurudhë, por që nuk janë të vendosura rampat dhe shenjat sinjalizuese në këtë hekurudhë. Ata kërkojnë që të vendosen shenjat sinjalizuese dhe rampat.

Po ashtu, edhe në lagjen "Dardania" ekziston një burim, i cili quhet "Kroi i Bardhë", i cili është në gjendje të mjerueshme nga papastërtia dhe është jo funksional.

Nga kjo gjendje jo e pastër mund të përhapet epidemi, prandaj kërkojmë që të bëhet pastrimi i këtij kroi dhe të funksionalizohet.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Urdhëro, Genc!

Genc Sherifi: Faleminderit kryesues!

Unë i kisha dy pyetje, kisha një pyetje për rrugën "Agim Ramadani", kurë do të fillojë rregullimi i saj dhe për ndërtimin e shkollës në lagjen "Matin 1", kur do të fillojnë këto punime? Nuk po di, pyetja i drejtohet drejtorit të Infrastrukturës apo Investimeve Kapitale, nuk po e di sigurt.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Gëzim, a përgjigjesh?

Gëzim Mehmeti: Rruga "Agim Ramadani" parashihet sivjet të intervenohet, sanohet, të jetë njëjtë si rrugët "Galibardi" dhe "Luan Hardinaj", nuk është vendos, por për informatën e juaj, jemi në bisedë me një ndërmarrje private, e cila do ta marrë komplet donacion, ta bëjë investimin e rrugës "Agim Ramadani", kishte qenë mirë sado pak ta ruajmë buxhetin e Komunës, do të thotë do të jetë një donacion i firmës, është firmë po ashtu që merret me asfaltimin e rrugëve.

Sa i përket pyetjes së shkollës, unë mund t'ia dërgoj raportin me shkrim, siç i thash kolegut tuaj, zotëri Rrahman.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Halim Halimi.

Halim Halimi: Unë mendoj që pyetjen të cilën do ta parashtrij, më shumë i përket Kryesuesit të Kuvendit. Këtë pe e them për hir të transparencës, se të gjitha vendimet të cilat ne i marrim në këtë Kuvend, vendimet tona qohen për verifikim në ministrinë përkatës, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Ministrinë, nëse janë për urbanizëm në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor.

Ne para kësaj mbledhje, në mbledhjen e dytë më duket, kemi marrë disa vendime, por anëtarët e Kuvendit nuk janë të njoftuar se Ministria e Pushtetit Lokal çfarë përgjigjesh ka kthyer, kështu që është mirë që ju kryesues të gjitha vendimet të cilat kthehen nga Ministria e Pushtetit Lokal nga një kopje të na e dërgoni anëtarëve të Kuvendit, në mënyrë që ta dimë ne se vendimet tona a kanë qenë të ligjshme apo nuk kanë qenë të ligjshme. Këtë po e them më tepër, sepse unë e di se kemi marrë disa vendime këtu, të cilat janë kthyer nga Ministria e Pushtetit Lokal, e cila e bën monitorimin e vendimeve të kuvendeve komunale, për të cilat konstatohet se nuk janë të ligjshme.

Çka është vepruar në atë drejtim konkretisht ju e dini. Me rastin e formimit të komisioneve dhe atë të Komisionit të Aksionarëve të ndërmarrje, unë e di që Vendimi na ka ardhur i kundërligjshme, çka është bërë në atë drejtim a keni ndërmend me njoftuar këtë Kuvend, se ato vendime janë të ligjshme apo të paligjshme. Nëse janë të paligjshme, e kemi afatin kohor 30 ditësh që të bihen të rishqyrtohen në këtë Kuvend, nëse janë të ligjshme, janë të ligjshme për hir të transparencës t'i njoftoni anëtarët e Kuvendit, se jam i bindur se një pjesë e madhe e anëtarëve të Kuvendit nuk e dinë fatin e vendimeve tona të cilat merren këtu në Kuvend, kjo ishte një pyetje.

Kryesuesi: Faleminderit shumë, ato realisht publikohen, Ministria i publikon, mirëpo do ta marrë për sipër që t'iu dërgohen edhe juve. Në rregulle është, po në rregull është, faleminderit!
Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Faleminderit, kryesues!

Kur ja parashtrova pyetjen Drenit, Dreni nuk ke këtu, kur u përgjigj Dreni, mungova unë, po besoj që dytë e kemi të qartë çka kërkuam njëri prej tjetrit. Komuna e Prishtinës do t'i largojë nga banesat që janë pronë e saj, në lagjen "Bregu i Diellit", familjet të cilat nuk janë raste sociale dhe invalidë të luftës. Ky vendim do të hyjë në fuqi menjëherë, kështu tha në një konferencë për media drejtori i Pronës në Komunës e Prishtinës, Dren Kukaj, raportojnë të gjitha portalet. Tash paske thënë se Asambleja duhet me marrë këtë vendim. Atëherë e ke pasur në fushatë, ky ka qenë premtim, kështu që besoj edhe atëherë është dashur me përmend se Asambleja duhet me vendosur këtë punë, mirëpo edhe nëse vendos Asambleja, numrat besoj që i kemi, kështu që ta hedhim qysh sot në votim dhe ta realizojmë këtë premtim, zotëri drejtor.
Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, drejtor!

Dren Kukaj: Tetëshe, qëndrimet që i lexove janë të vërteta, nuk mund t'i mohoj ato. Arsyeja pse ne nuk kemi vepruar, ka qenë për shkak të një rreziku ligjor të cilin e patëm identifikuar, edhe përmes formës të cilën ne është dashur me bërë shkëputje të njëanshme të kontratës, ka pasur rrezik që lëndët të shkojnë në gjykatë, dhe dalin prej, si të them, prej kontrollit tonë. Edhe tjetra, e vërtetë ka qenë që pastaj ka pasur zgjedhje, edhe nuk është që ka qenë çështje e zgjedhjeve, meqë kam qenë i përfshirë edhe vetë në këtë çështje, nuk kemi dashur me e politizuar këtë çështje në kohën e zgjedhjeve, nuk kemi provuar kështu me bërë kapital politik prej saj. Ndërsa tash, të njëjtin vullnet që e kam deklaruar atëherë, të njëjtin vullnet unë po kërkojë që bashkërisht ta deklarojmë këtu. Tani, të hidhet në votim kjo sot është e pakuptimtë, për shkak se duhet të mendojë unë fillimisht me i kaluar disa filtra të analizës, ku unë i kam disa ide të mia, fillimisht në KPF, pastaj këtu, mirëpo unë qysh e thash edhe herën e kaluar, unë në raport me këtë e di që i kemi numrat, mirëpo unë po lypi më shumë numra, për shkak se është me rëndësi që kjo Asamble me votuar drejt në këso çështjesh, nuk është se unë po lypi me hy brenda aty, as me nxjerr dikën e me shti ndonjë shok. Unë emrat dhe mbiemrat e përfituesve nuk i di, për mua mjafton nëse e kanë një status të caktuar material, që i bie që janë të varfër, e ata të hyjnë aty, tjetër çështje në raport me këtë nuk kam. Tash, nëse nuk të pritët ty, nuk kam çka me bërë, nuk po di çka me të thënë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Po.

Egzon Azemi: Nuk është çështja a të pritet, a nuk të pritet, Dren. E ke dhënë premtimin dhe besoj që duhet me e realizuar. Nëse është dashur me i ditur ti të gjitha në momentin kur ke dalë para mediave dhe ke thënë që Komuna e Prishtinës ka me marrë vendim, që këto banesa me ua marrë anëtarëve të LDK-së që i kanë marrë me anë të pushtetit, edhe me ua dhenë njerëzve që kanë nevojë. E në Prishtinë ka jashtëzakonisht shumë raste që njerëzit kanë nevojë me banuar diku, kështu që përmbushë atë premtim, edhe nuk është situatë për me qesh kjo, po më çudit që po qesh edhe nuk është mirë kjo punë. Jo, veç mbaje premtimin, hedhe në votim dhe mor ironizo me këtë punë, se është çështje e banimit për rastet sociale. Nëse jo, bile dil e thuaje, ju kam rrejt atëherë, ose po ju rrejt tash, njëren po, po cilën?

Kryesuesi: Vazhdojmë.

Besnik Mujeci.

Besnik Mujeci: Përshëndetje!

Desha ta pyes drejtorin për tri rrugë që e lidhin lagjen "Mati" me Taukbahçe, janë tri rrugë në gjendje shumë të mjerueshme: "Kushtrim Hoxha", "Andrea Varfi" dhe "Rruga e Komonit", qytetarët në ato rrugë jetojnë në baltë, si para 50 vjetëve, dhe a ka në plan Komuna e Prishtinës që, asfalti duket pak si luks, por që t'i shtrojë në kubza ato tri rrugë?

Kryesuesi: Faleminderit!

Gëzim Mehmeti: Besoj që detyrë e jona është që të intervenojmë sa i përket rrugëve të Prishtinës. Me kubza, bazuar në kompetenca ligjore që i kam, mund të intervenohet pa i ndjekur procedurat e tenderimit. Sa i përket asfaltit, duhet të shkohet me tenderim, ndërsa me kubza mundemi me intervenuar, vetëm, të lutem, ma dërgo me shkrim se cilat rrugë janë ato.

Kryesuesi: Faleminderit!

Naime Ossmani.

Naime Osmani: Unë kur e shtrova pyetjen, drejtori, Dreni, nuk ishte këtu. Drejtor, në mbledhjen e kaluar na keni thënë se një takim ka me u bërë me përfaqësuesit KEK-ut, KEDS-it e këto, a është mbajtur ai takim? Nëse është mbajtur ai takim, pse nuk na ke ftuar, se ke thënë që ju ftoj? Nëse nuk është mbajtur, atëherë unë të lutem na informo, se edhe ne kemi probleme nëpër fshatra, dihet më në qytet janë bërë kabllot e rrymës sikur merimangat, po edhe në fshatra kemi problem, kështu që të jemi drejtpërdrejt me ta, po mundësisht i ftoni edhe kryetarët e bashkësive lokale. Dhe tjetra pyetje, por edhe si informatë, ishte ajo për fshatin Rimanishtë për atë vijën e ujërave të zeza, nuk më dha kurrkush ndonjë përgjigje, po bile me thënë që do të ndërmarrim masa, sepse ajo është më se urgjente.

Faleminderit!

Kryesuesi: Po, Dren.

Për atë pyetjen që është direkt për ty, përndryshe, për Shërbime Publike nuk është drejtori këtu.

Dren Kukaj: Kështu, në raport me atë çështje ne jemi takuar, i kemi identifikuar personat që janë përgjegjës në KEDS, KEK, KOST edhe në ZRE, me të cilët kemi me e mbajtur një takim konsultativ paraprakisht, në mënyrë që me e mbajtur një takim të paktën gjysmë ditor, ku secili subjekt i ka nga dy përfaqësues, shefin e grupit dhe dike që është në çështjet e energjisë, e përfaqësohet secili aty në atë mbledhje, mirëpo veç kemi pasur më shumë punë sesa që kemi parashikuar, na kanë ardhur do prioritete tjera, nuk është që e kemi mënjanuar. Nëse e konsideroni që është kaq me urgjencë, mundemi me e bërë të hënën, por sipas të gjitha gjasave do të bëhet kah mesi i javës tjetër, kështu që nuk është mbajtur takimi, për atë nuk jeni ftuar, se do të ftoheni.

Kryesuesi: Faleminderit, Dren!
Vjosa Hamiti-Krasniqi.

Vjosa Hamiti-Krasniqi: Përshëndetje të nderuar!

Unë e kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale.

Banorët e lagjes "Ndue Përlleshi" pyesin se, edhe pse ajo rrugë është shtruar shumë vonë, është shtruar me kubza, është shkatërruar tërësisht, andaj a planifikoni që këtë vit, ose gjatë këtij mandati të rregullohet kjo rrugë?

Faleminderit!

Kryesuesi: Drejtor.

Gëzim Mehmeti: Zonja Vjosa Hamiti-Krasniqi, faleminderit për pyetjen e juaj. Është paraparë që rruga "Ndue Përlleshi" të ketë intervenime dhe të sanohen ato prishjet që janë bërë. Për këtë vit fillojmë diku në muajin prill, siç e ceka, deri në muajin qershor.

Kryesuesi: Faleminderit!
Eman Rrahmani.

Eman Rrahmani: Unë e kam një pyetje nga Shoqata e të Burgosurve Politikë, veç desha me e lexuar: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës ka propozuar më herët që një rrugë në Prishtinë t'i vihet emri Ramadan Rexha, i dënuar politikisht me 15 vjet burg. Figura e tij ka qenë gjithmonë e nderuar për qëndrimin e tij parimor e dinjitoz në mbrojtje të çështjes kombëtare, ka qenë propozim dhe nuk është vendos ky emër. A është e mundur me e ditur a është Komisioni për emërimet ende funksional, apo qysh është puna, edhe me pasur arsye pse nuk është emëruar asnjë rrugë me këtë emër?

Kryesuesi: Prej drejtorëve nuk po e shoh që ka dikush këtë informacion.
Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj: I nderuar parashtruesi i pyetjes, i nderuari Eman, unë po ta jap një mocion. Kam qenë anëtarë i komisionit paraprak në legjislacionin e kaluar në Asambleenë komunale, dhe po e them publikisht, se nuk kam qenë absolut i kënaqur me punën që është bërë në atë komision, po edhe me emërimet e rrugëve që janë bërë aty, kështu që prej pozicionit që e kam,

nuk më lejohet me e iniciuar proces të ri për ato punë, por, megjithatë, dikush prej juve le ta marrë le ta inicion formimin e ri dhe le ta shqyrtojë gjendjen e rrugëve në Prishtinë, se absolut nuk është e drejtë dhe ka shumë mungesa, ka shumë gjëra që nuk janë të mira për Prishtinën.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Tash është Rifat Deri.

Veç, kërkoje fjalën, shtype.

Regjia, Sami Borovci, regjia.

Sami Borovci: Përshëndetje edhe njëherë.

Atëherë, në lidhje me komisionin e përmendi drejtori edhe vetë, në mandatin e kaluar personalisht kam pranuar shumë ankesa të njerëzve, të qytetarëve të Prishtinës, që kanë qenë të pakënaqur me procesin e emërimit të rrugëve, ndoshta me konsulta publike, ose në mënyrën qysh janë bërë këto konsulta. Unë kisha kërkuar ndoshta një informacion prej ekzekutivit, ose prej dikujt këtu se qysh është procedura, qysh mundemi me e iniciuar edhe një komision, me i trajtuar edhe një herë ankesat për disa rrugë përkatëse në Prishtinë, sepse përnjëmend për çdo ditë marrim ankesa, dhe tash ankesat të infrastrukturës po janë shumë më të vogla sesa ankesat për emërtim të rrugëve. Kështu që nëse ka mundësi me na njoftuar dikush, ndoshta Zyra ligjore ose ekzekutivi, për procesin, qysh është e mundur, ose a duhet me e formuar një komision të ri, që unë kisha propozuar që nëse kjo është e mundur me e formuar një komision të ri, i cili ka me i trajtuar të gjitha ankesat e njerëzve për një periudhë të caktuar, me e mandatuar një komision që i trajton të gjitha këto ankesa dhe merr vendime, mandej me i rishikuar këto rrugë.

Kryesuesi: Atëherë, sa i përket kësaj çështjeje, mund të kontaktoni me Zyrën ligjore, për t'i parë si janë procedurat.

Kryesuesi: Rifat Deri.

Rifat Deri: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mysafirë dhe

Gazetarë,

Sot do të flas për një çështje, që nuk është e re për komunën tonë, por sikundër do të shihni, do të flas për një dimension të panjohur të kësaj çështjeje, konkretisht, do të flas për emërtimin e rrugëve, që e ceku kolegu im më parë, Emani, të institucioneve kulturore, arsimore, shkollave dhe subjekteve të ndryshme kulturore në Prishtinë. Më janë drejtuar një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, i kryeqytetasëve tanë, me vërejtjet, ankesat nga më të ndryshmet, kështu që kam ardhur në përfundim se lidhur me këtë çështje janë bërë hile dhe padrejtësi, dhe është punuar jo profesionalisht. Është punuar kështu jo vetëm viteve të fundit, sepse gjithsesi që vazhdimisht dhe për një kohë të gjatë nuk është punuar drejt, ngase nuk është dëgjuar zëri i qytetarëve tanë që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Jam habitur dhe zhgënjyer shumë, kur kam kuptuar që janë bërë emërtimet e rrugëve në Prishtinë. U është hyrë në hak aq shumë patriotëve prishtinas, të cilët u lindën, u rritën, u shkolluan dhe u flijuan për këtë qytet, ndërkohë që ata që vendosin këto emërtime as dje, as sot nuk kanë bërë asgjë për ta. Vazhdoj të mos e kupto arsyen pse, por e di se kjo është e neveritshme. Si ka pasur mundësi që deri më sot

të anashkalohen aq iritueshëm ata prishtinas, që para më shumë se 6 dekadave kanë bërë shumë për lirinë të cilën ne sot e gëzojmë! Kjo punë e tyre, që morën përsipër emërtimin e rrugëve në kryeqytet, nuk ka assesi ndryshe të shpjegohet, përveç si papjekuri nacionale, papërgjegjësi politike, shtetformuese, si dhe mungesë e dijes dhe informacioneve për të kaluarën e qytetit tonë.

Për çka e kam fjalën konkretisht, më së miri do të jap një ilustrim të shkurtër të kësaj çka po flas sot. Në vitet e 60-ta, gjegjësisht në vitet famëkeqe që njihen si “Koha e Rankoviqit”, disa të rinj prishtinas, që në fakt ishin ajka e rinisë në qytetin e asaj kohe, shumica prej të cilëve ishin nxënës të liceut “Sami Frashëri” në Prishtinë, që ishte institucioni më i lartë arsimor në Kosovë, u organizuan, vepruan kundër dhunës së asaj kohe që pushteti serb ushtronte ndaj shqiptarëve. Këta të rinj prishtinas vepruan në ilegalitet dhe kundërshtuan shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, mbledhjen e armëve nga shqiptarët, diskriminimin kulturor dhe nacional, dhe dhunën e madhe të asaj kohe që ushtrohej në një errësirë të plotë. Po këta të rinj prishtinas, para më shumë se 60 viteve, u rreshtuan kundër mbetjes së shqiptarëve në Serbi, vepruan bashkë dhe kishin një karakteristikë unike, që nuk do ta hasim edhe për shumë kohë në Prishtinë, por jo vetëm në Prishtinë. Këta prishtinas, për të cilët unë e kam nderin të flas sot, si bashkëvendësit e mi, ishin antikomunistë të përbetuar. Në të vërtetë, sikur që kuptohet nga puna, fjalët dhe veprat që kanë lënë ata ishin kundër sistemit komunist të çfarëdollojshëm dhe shquheshin me një atdhedashuri të pashoq. Pra, pjekuria e tyre politike dhe nacionale ishte mahnitëse. Koha ka dëshmuar se ata kishin të drejtë. Ky grup i të rinjve veproi në ilegalitet të plotë plot 7 vjet, duke i dhënë shpirt lirie dhe frymë guximi Prishtinës, e cila asokohe po dënohej sistematikisht. Zbulimi i kësaj organizate, që në Jugosllavinë komuniste njihet si NDSH, pati jehonë të madhe jo vetëm në Prishtinë, por edhe në gjithë Jugosllavinë e asaj kohe. Paramendojeni, një grup i të rinjve prishtinas pa përkrahjen e askujt, mori guximin t’i kundërvihet një aparati aq të fuqishëm shtetëror siç ishte Jugosllavia. Gjithsesi duhej shumë guxim dhe pjekuri për të bërë kundërshtim dhe veprime të asaj natyre. Për kërkesat dhe qëllimet e tyre u bënë të njohura edhe në ditën e gjykimit të tyre, si pjesëtarë të kësaj organizate, te Gjykata pranë Tregut të gjelbër, patën shkruar edhe mediat botërore. Por, ajo që dallonte këtë grup, është një karakteristikë unike e këtyre djemve prishtinas, se ata qysh në atë kohë ishin properëndimor, pra për një kohë kur shqiptarët këtej dhe andej kufirit i kishte kapluar mortaja komuniste. Rrjedhimisht, mendoj se shikuar në kontestin kohor të ngjarjeve, sigurisht që bëhej fjalë për një organizim progresiv dhe të paimagjinuar të asaj kohe. Prandaj, edhe jam shumë i bindur se këtij grupi atdhetarësh i është bërë

Kryesuesi: Më fal, veç pak, z. Deri. Kjo pikë realisht është “Pyetje dhe përgjigje”, nuk është për fjalim, për shkak të racionalitetit të kohës, po për shkak të racionalitetit thash, mos, e lexon te “Të ndryshme” prapë, por, të lutem, me qenë më përmbyllës se 5 minuta kaluan, se kjo është pyetje- përgjigje, kjo është me iu drejtuar. Ideja është që kjo është te pika “Të ndryshme”, nuk është te “Pyetje - përgjigje”, por nuk desha me ndërprerë.

Rifat Deri:...(Jashtë mikrofonit), Rexhep Parteshi 9, Qamil Novakazi 8, Nysret Novakazi 7, Ibrahim Galimuna 5, Kadri Deva 5, Vehbi Ruva 4, Fehmi Henci 4, Osman Krasniqi 3, shoqja e tij, besoj që e dini, Emine Krasniqi, që e ka qëndisur, unë po e kallëzoj grupin që nuk ia keni ngjitur emrin, po e tregoj grupin, e ju tani demantomëni cili qytet e ka, Osman Krasniqi, Gani

Xhemajli, Ibrahim Bunjaku, Nikë Kajtazi me 2 vjet, Mazllum Novakazi, Neki Shehu dhe, në fund, me qëllim e lash Rashit Krasniqin, pasi i vetmi është gjallë prej këtyre që i përmenda, gazetari shumëvjeçar i Rilindjes, botuesi i parë i fjalëkryqit në shqip dhe kompozitor i famshëm, besoj se krejt e dini këngën e Mallëngjimit, është kënga e bacës Rashit.

Për këtë besoj se duhet me mbajtur përgjegjësi ai grupi ose komisioni i cili ka vendosur për emrat e këtyre njerëzve e nuk i kanë përfshirë këta. Unë u përpoqa që këta patriotë t'ua sjell në kujtim sot. Shpresoj se do ta kem përkrahjen e juaj që kjo nismë mos të mbetet me kaq.

Ju faleminderit edhe për kohën që më dëgjuat!

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, z. Deri!

Shefki Gashi.

Shefki Gashi: Unë nuk e mora fjalën me iu përgjigjur z. Derit, por, për ko incidencë, më qëlloi fjala tash, edhe jam në mesin e atyre që kam qenë një mandat, në një legjislaturë anëtarë i Komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve në Prishtinë, sipas...(Fjala nuk kuptohet), të Komunës. Po dua me ju treguar veç atë rrugëtim, i kemi informuar mjetet e informimit në Asamble, në Bashkësi lokale, na i sillni emrat, na i sillni emrat, nuk i kanë sjellë, çka kemi mundur e çka i kemi ditur, edhe sot e kësaj dite ka vende ende. Komisioni tjetër është i legjislaturës së kaluar, jo, është ndryshuar ai komision, ai ka mandat, atij komisioni duhet me ia verifikuar mandatin edhe të gjitha komisioneve tjera kjo legjislaturë tash, ne nuk e kemi ende programin e punës. E dyta, sa i përket këtyre që i përmendi z. Deri, me gjithë respektin me të tëra, disa emra prej tyre po më kujtohen, janë të tyre jo krejt, por nuk kemi pas ndonjë regjistër tjetër. Po e shfrytëzoj rastin se foli njëri qatje, a po kupton a jo, edhe po të them ty djali i mirë, i kujt je nuk e di, prej nga je nuk e di, 150 vjet prapa mashkull i familjes time nuk ka vdekur as nuk është përcjellë me xhemat në varrim, por u qua me u varros, u gropos, u pushkatua, i ke edhe njeriun që i ka varrosur, këtu ulur e ke, a po kupton a jo. Prandaj ka me pa, ata emra nuk i kam ngjitur unë, janë ngjitur nga Komisioni i Qeverisë së përkohshme, pra, po gabon se është Hamdi Mramori, Hamdi Gashi, Shemsi Haziri vëllau i Hamdiut, komandanti i fundit i NDSH-së, pas tij ka ardhur Adem Jashari, ...(Fjala nuk kuptohet) shqiptar nuk ka pas në Kosovë, Komiteti i Lipovicës, Gjonë Sereçi që u kanë themelues i tij, mandej me radhë ashtu ata emra i kanë të gjithë komandantët, Coli e ka një emër, që nuk jam kanë në komision unë hiq. Kështu që lëkundu pak kur t'i përmendësh ata emra, nëse ke një trohëz, nuk kemi luftuar me fëmijë as me gra, por kemi luftuar, nuk ka më shqiptar, a more vesh. Ndërsa sot luftojmë me polemika, kush të donë urdhëroni, hyjmë deri në skaj dalim, edhe ti djalë, edhe ti më parë që the për banesa, lexo diçka, nuk mund të bien vendim t'i këtu me e qitur njeriun prej shtëpie, a je normal, a je normal!

Kryesuesi: Pyetje dhe përgjigje, të lutem.

Z. Gashi pyetje dhe përgjigje, të lutem!

Shefki Gashi: A je normal, qite ti atij që ia ka dhënë Tito qe 70 vjet, po nuk je normal, a po kupton a jo, nuk je normal ti, po e qesim në Kuvend po ia marr njeriut shtëpinë! Po a është normal ajo punë, duhet me iu dhënë një vendim tjetër, me ua caktuar një afat 3-4-5 -6 vjet a

munden me bërë zgjidhje, a nuk munden, tani tek atëherë e merr, ka sende këtu shumë, e hajde ti qitëm mua nëse jam unë aty, hajde ti qitëm. Vallahi atë ditë që të shoh, pandlat në hava ti qoj, a po merr vesh?!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Egzon Azemi.

Ju lutem, pyetje përgjigje nëse kemi, sepse, siç e dini, në pika kryesore ende nuk kemi hy, është edhe për të mirën e juaj të jemi të fokusuar.

Egzon Azemi: Ja, e dëgjuam këtu të gjithë një fjalim, që po më vjen keq me u shpreh në këtë mënyrë, por, fatkeqësisht, nuk mundem me quajtur tjetër fjalim këtë, veç një fjalim i turpshëm, për banesa që janë përfituar në mënyrë të paligjshme, janë përfituar nga kjo Asamble.

Kryesuesi: Egzon, më fal ,veç një sekondë, të lutem!

Egzon, të lutem, nuk është kjo pikë e rendit të ditës, është pyetje dhe përgjigje në raport me ekzekutivin.

Egzon Azemi: Po, meqenëse edhe ky e shfrytëzoi rastin se e pati fjalimin , veç po dua me replikë,

Kryesuesi: Mandej po ankoheni pse nuk po vazhdojmë më shumë, çështje replike kjo.

Egzon Azemi: Po kjo në njëfarë forme është replikë, se e përmendi çështjen, ma rëndësi ka me e ngritur çështjen se emri, kështu që.

Kryesuesi: Po nuk është çështje e replikës, është pyetje dhe përgjigje me ekzekutiv, veç nëse ke pyetje.

Egzon Azemi: Unë e kërkova fjalën për me i bërë dy pyetje, kështu që ato pyetje po i bëjë, veç desha me thënë që nuk është në rregull me bërë këso kërcënimesh, as këso fjalimesh, me kësi toni për banesa që i keni përfituar me anë të kësaj Asambleje, keni me i humbur me anë të kësaj Asambleje, gjithsesi, nëse vazhdon Dreni me e mbajtur premtimin që e ka dhënë edhe ekzekutivi në përgjithësi.

Kryesuesi: Egzon, pyetjet, të lutem!

Pyetje - përgjigje.

Egzon Azemi: Ka ankesa nga qytetarët që në rrugën “Bedri Shala”, e kanë njoftuar edhe Inspektoratin, mirëpo qytetari i cili mu ka ankuar, nuk kam informacione, z. drejtor, se a është vërtetë qysh po thotë a jo, ma ka shkruar edhe emrin e inspektorit, për të cilin dyshon që është i afërt me Kompaninë “Pozhegu Bradhers”, dhe ankohen se tash e sa kohë ka bllokime të rrugës, ka këtu të dërguara edhe foto, ku shihet se nuk ka qarkullim në këtë rrugë për shkak që betonierkat vazhdojnë me ndërtuar banesa aty. Kështu që është një shqetësim i qytetarëve, të cilin kisha pas dëshirë me e pas parasysh.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Drejtore, a donë me emarrë fjalën?

Brahim Mehmetaj: Po nuk është shqetësim vetëm i asaj pjese, po në pjesë të madhe të qytetit ku ka betonime ose gjëra tjera, kompanitë e caktuara e bëjnë bllokimin e ndonjë korsie. Zakonisht ata duhet me shkuar në Shërbime Publike me marrë një leje të tillë për me e shfrytëzuar atë korsie, po aty ku bllokohet rruga plotësisht, nuk krijohet as zhbllokimi. E bëjnë, Inspektorati del i merr masat e veta, nuk them që nuk ka njerëz të papërgjegjshëm, por, megjithatë, nëse ke ndonjë emër, kështu nuk kemi të drejt në publik, po eja ma refero në zyrë dhe ne i marrim masat për atë punë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Haki Dragusha.

Haki Dragusha: Unë i kam nja dy kërkesa, e para, më datën 8 mars në fshatin Bërnice e Epërme, ka pas një fatkeqësi elementare, një erë e madhe atje ka fryrë dhe një servisi ia ka hequr kulmin. Nuk e di a ka dalë dikush me e verifikuar atë punë, ai servis e ka pushuar biznesin, edhe ashtu është kah falimenton, sepse nuk e kanë gjendjen e mirë, prandaj kishte me qenë mirë me i ndihmuar. Pyetja tjetër, ose kërkesa tjetër është çerdhja në lagjen "Dardania", aty është hapur, nuk e di drejtori i Drejtorisë së Arsimit a e ka marrë këtë ankesë, është hapur një servis i internetit dhe e ka bllokuar krejt parkingun para çerdhes, kështu që edhe çerdhes edhe neve banorëve që banojmë aty, unë e kam banesën përballë çerdhes, edhe Hendikosit, prandaj kemi shumë problem me atë parking.
Faleminderit!

Kryesuesi: Po, drejtor.

Brahim Mehmetaj: Është dashur me ardhur me na informuar neve në Inspektorat, ose me u ankuar ju direkt dhe ne i marrim veprimet tona. Nuk ka me u lejuar asnjë uzurpim ose bllokim i hapësirave publike, nga kushdo qoftë ai. Nëse ka ndodhur, ne shkojmë e verifikojmë, nëse ka leje, pra edhe mund të ketë ndonjë leje të lëshuar, por, megjithatë, ne e vërtetojmë, ju na informoni, po nuk po prejudioj tash.

Dren Kukaj:... (Jashtë mikrofonit), kemi negociuar që një çerdhe shtesë ka me qenë në saje të fondeve të Komisionit Evropian në Dardani dhe, sipas të gjitha gjasave ka me qenë afër shkollës "Xhemail Mustafa", pra një çerdhe me kapacitet më të madh sesa ajo e vogla aty, veç thash si informatë ta ndaj.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë konstatojmë që e përmbyllën edhe këtë pikë "Pyetje - përgjigje", dhe para se të dalim te pika tjetër e rendit të ditës, jemi të obliguar të ju njoftojmë, për shkak të renditjes që do të bëhet tash në prioritet për marrje të fjalës, që ka edhe në shkresë, me të cilën njoftohem që 9 këshilltarë komunalë tani më funksionojnë si Grup i Pavarur, dhe sipas

kësaj emrat janë: Nol Nushi, Genc Sherifi, Vala Peshku, Visare Gorani-Gashi, Bashkim Beha, Adrian Berisha, Qëndrim Sahiti, Mimoza Sylejmani dhe Drilon Pireva, si shefe të këtij grupi të pavarur e kanë caktuar Vala Peshkun, dhe pas këtij ndryshimi e kemi këtë gjendje: LDK 15, Grupi i Pavarur 9, LVV 7, PDK 6, AAK 5, këto tjerat nuk kanë ndryshuar AKR-AA 5, LB 2, Nisma 1, i pavarur 1, do të thotë është edhe një e pavarur.

Po, a e deshe fjalën?

Po, të lutem!

Valbona Petrovci.

Valbona Petrovci: I nderuari kryesues,

Të nderuar asamblistë,

Motivi dhe shtysa ime për të konkurruar për asambliste të Kuvendit komunal, ishte vullneti dhe dëshira për të kontribuar për Prishtinën, ndërkohë rrethanat që u krijuan në LVV, ishin të papritura për mua, e jam e bindur edhe për pjesën më të madhe të opinionit. Dua të ju njoftoj se në rrethana të tilla të paparashikuara për mua, nuk dëshiroj të jem pjesë e ndasive, nuk preferoj të rreshtohem pranë asnjërës palë, do të veprojë si asamblistë e pavarur dhe e bindur në mirëkuptimin tuaj. Ju siguroj se me punën dhe votën time, do të përkrahi çdo iniciativë dhe vendimmarrje të cilën e vlerësojë pozitive dhe të dobishme për qytetin. Për këtë i detyrohem prishtinasve dhe votuesve të mi.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Shkojmë te pika e tretë.

Po, po, urdhëro!

Halim Halimi: Meqenëse tash u informuam se është ndarë një Grup i Pavarur këtu, unë i uroj sukses Grupit të Pavarur, d.m.th. u rrit numri i grupeve të këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, prandaj kërkoj që edhe renditja të bëhet siç është praktik d.m.th. grupi më i madh i këshilltarëve, ose ta quajmë grupi më i madh parlamentar të dalë në vendet ku ka qenë LVV-ja, që i ka pasur 17 këshilltarë, ne kemi qenë partia e dytë me 15 këshilltarë. Andaj, kërkoj prej Administratës komunale, që ta ketë parasysh për mbledhjen e ardhshme, që GP i LDK-së të dalë si grup i parë në vendin ku janë LVV-ja. Kjo është praktikë gjithëherë, nuk e di kush më tha, pra, grupi i parë, ju i dyti dikush tjetër, ku i treti, grupi i parë del në atë pjesë, i dyti del këtej, i treti në atë pjesën andej, i katërti, kështu, kështu bëhet radhitja. Kështu që për mbledhjen e ardhshme GP i LDK-së ulet ku e ka vendin.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Jo, në rregull është, nuk ka nevojë me u shndërruar në debat, kjo ka ardhur si kërkesë vonë dhe rregullohet kjo çështje.

Ju lutem, po.

Në rregull, faleminderit shumë!

Pika e tretë

Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së “Kodra e Trimave 1”.

Kryesuesi: Atëherë, shkojmë sipas renditjes,
OK., drejtor nëse do diçka?
Po, urdhëro!

Genc Bashota: Një sqarim të shkurtër për ata që, ne e kemi diskutuar në KPF, do të thotë Plani rregullues i hollësishëm “Kodra e Trimave 1” u miratuar në këtë Kuvend, në maj të vitit të kaluar, është në fuqi, ne jemi duke punuar me këtë plan, mirëpo në momentin kur ka filluar Zyra e planifikimit me punuar me këtë plan, zyrtarët e kanë hasur një gabim teknik të kompanisë, me ç’rast disa tabela nuk përputhen me pjesën grafike dhe tekstuale. Jam i bindur që gabimi ka qenë i paqëllimshëm. E kemi thirrur kompaninë edhe menaxherin e kontratës, të gjithë bashkë jemi takuar, kanë kërkuar që ky përmirësim të bëhet në Kuvend, për arsye se ne duke e ditur se janë gabim, ne nuk mundemi me vepruar, pra, para se Kuvendi ta aprovojë këtë ndryshim. Pra, aty vetëm janë bartur si duket “copy-paste” disa tabela dhe kanë ikur prej menaxherit të kontratës, nuk i ka vërejtur, kjo është çështja.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Atëherë, në emër të LDK-së.
Halim Halimi.

Halim Halimi: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë që është marr një vendim në këtë Kuvend, në vitin 2017, për Planin rregullues të hollësishëm “Kodra e Trimave 1”. Po atë që e thash edhe me herët, vendimet tona duhet të dërgohen në ministrinë përkatëse për me e marrë sugjerimin, vlerësimin e ligjshmërisë. Ne na është kthyer se ky plan, ai vendim që është marr në këtë Kuvend është i kundërligjshëm, kështu që si atëherë kur kemi thënë kur është marr vendimi që Kodra e Trimave e donë një Plan rregullues të hollësishëm të bazuar në ligj, të bazuar në Hartën zonale, ngase e dimë që me Ligjin mbi planifikimin hapësinor, të cilat janë tri dokumentet bazike në të cilat duhet të mbështetet Plani rregullues. Prandaj, për Kodrën e Trimave duhet Plan rregullues i bazuar në Hartë zonale, ai është i ligjshëm, unë mendoj që ai plan është i kundërligjshëm në bazë të shkresës së Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, unë e di, drejtori e ka një arsyetim, sepse e kemi pasur edhe par disa ditëve, por unë në emër të GP të LDK-së, theksoj se ai vendim ka qenë i kundërligjshëm. Prandaj, qytetarët e Kodrës së Trimave duan vendim të ligjshëm, duan vendim të bazuar në Hartën zonale, e jo një Plan rregullues të kundërligjshëm, dhe ka plot e plot vërejtje sa i përket atij, po i them “plan” në thonjëza, sepse edhe koeficienti, edhe ka paqartësi të mëdha, kështu që vështirë është me u zbatuar ai Plan rregullues, kështu që është e juaja si votoni, për mua po votojmë diçka për një plan inekzistent.
Faleminderit!

Genc Bashota: Kështu, është e vërtetë që shkon konfirmimi i çdo vendimi që e sjellim në Kuvend, jo vetëm për plane rregulluese, por edhe për rregulloret tjera shkon konfirmimi në ministrinë përkatëse. Është e vërtetë që 15 ditë i ka me ligj Ministria me e kthyer përgjigjen, nëse nuk përgjigjet për 15 ditë, ai vendim hynë në fuqi, pra bëhet i ligjshëm. Unë nuk jam zyrtar ligjor këtu, por ne si Komunë e kemi Zyrën ligjore, shumë shpesh Ministria dinë me i vonuar në momentet kur është në lajthitje, është çështje e tyre, ata e kanë vonuar shkresën, që do të thotë pas 15 ditëve Zyra jonë ligjore e kanë konfirmuar që ky Plan rregullues është i ligjshëm. Në momentin kur Zyra ligjore na udhëzon, unë atë plan e kam nënshkruar, e ka nënshkruar edhe kryetari asokohe, nuk e ka nënshkruar zoti Halim që është këtu, është e drejta e tij me nënshkruar, apo mos me e nënshkruar. Ai plan ka hy në fuqi. Para se me hy në fuqi, ne e kemi pyetur Ministrinë se a duhet me i pasur tri nënshkrime, na janë përgjigjur jo, kurrkund në ligj nuk është e përcaktuar që duhet me e nënshkruar tre persona, do të thotë edhe pa nënshkrimin e kryesuesit nuk kemi kurrfarë vërejtje, ne jemi duke punuar me atë plan. Pra, sot këtu çështjen e ligjshmërisë të atij plani, as nuk e kemi në rend të ditës, sa është funksional. Veç edhe këtë e kam obligim me u përgjigjur. Ne atë plan e kemi prezantuar në këtë Kuvend, e keni votuar edhe ju, koeficientet qysh kanë qenë janë po ata, nuk kanë lëvizur, bile mendoj që i njëjti do të inkorporohet edhe në Hartë zonale. Nuk po hyj në atë çështje, mirëpo e keni votuar ju, tash po thoni jo janë disa koeficient, jo janë, do të thotë për ligjshmëri, unë nuk e kisha hapur atë temë të ligjshmërisë, sepse mendoj që është, është në ueb-faqe, ne jemi duke punuar si drejtori me te, mirëpo e kemi këtë problemin e disa tabelave të cilat kanë qenë gabim teknik. Në të kundërtën, sa i përket Hartës zonale, e dini prej mbledhjes parapake, Harta zonale hynë në fuqi edhe minimalisht 18 muaj, kështu që nuk jam i disponuar, nuk e mendoj që “Kodra e Trimave” e meriton tash me e zvarritur edhe nja dy vjet tjera.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Vala Peshku, Grupi i pavarur.

Vala Peshku: Faleminderit, kryetar,
Kryesues dhe
Gjithë të tjerëve.

Në parim, Grupi ynë është pro vendimit për përmirësimin e gabimit teknik, siç po shihet në të gjitha pikat këtu që janë thjeshtë çështje teknike të figurave, apo të numrave, për shkak të ngjyrës në disa raste, se është fshehur numri, kështu që nuk ka këtu kurrgjë ligjore të diskutohet rreth kësaj pike.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Leonora Shabani- Bajraktari, ose dikush në emër të GP të LVV-së.
Eman Rrahmani.

Eman Rrahmani: Edhe ne si GP i LVV-së, e përkrahim këtë. Unë desha me u informuar, por e shpjegoi shumë mirë Genci, që ky Plan rregullues është funksional, për shkak se

qytetarët nuk kanë qenë të informuar se është funksional, dhe faleminderit për informatën.

Kryesuesi: Faleminderit!

Në emër të PDK-së?

Leutrim Retkoceri.

Leutrim Retkoceri: Përshëndetje edhe një herë!

Pika për përmirësimin e gabimit teknik, meqë drejtori i dha arsyetimet e veta, ne do ta përkrahim, mirëpo të merret parasysh diçka, që vendimet e Ministrisë, pavarësisht shtyrjeve, t'i respektojë, sepse është hierarki. Ne i dimë afatet kohore, mirëpo nuk jemi këtu për të bërë shtet mbi shtet, po e kemi një shtet dhe një institucion, për këtë është vërejtja. Nëse brenda 15 ditëve nuk ju ka lajmëruar Ministria, shkruani prapë bre se nuk bëhet nami, a po kupton, po de, qysh pse? Po nëse e kthen që nuk është konform Planit rregullues, çka? Atëherë na shtynë edhe neve na qet në lajthitje, kjo ishte sugjerim drejtor, mos të mbetet hatri tash.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të AAK-së?

Valbona Ajeti.

Valbona Ajeti: Edhe grupi ynë është për përmirësimin e gabimit teknik në pjesën tekstuale të Planit rregullues për lagjen "Kodrën e Trimave".

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

GP AKR-AA?

Vesel Makolli.

Vesel Makolli: Sa i përket përmirësimin teknik nuk ka problem, por unë e kam një vërejtje te ky material që e kemi marrë, kjo vërejtje vlen edhe për ato tjerat pika. Duhet ato skemat me qenë pak më të qarta. Unë e di që "Kodra e Trimave" është një kuptim më i gjerë, unë sa e di, tash nuk e di a e ndani ju ashtu, është ajo rruga për Podujevë, e cila e ndanë atë Përroin e Zatriqit, që ne e quajmë, është Kodra e Trimave një pjesë, dhe kjo pjesa tjetër. Unë kam pasur vështirësi me u gjendur në ato shema, dikur në bazë të varrezave cila pjesë është, po më duket është kjo pjesa këtëj, andaj është mirë që me i përkufizuar tjetër herë, p.sh. është kjo pjesa prej kësaj rruge e kësaj rruge që na me i pas pak më të qartë, me u gjendur pak më mirë, dhe kjo po më duket shkon deri në Shkabaj, qashtu qysh unë e kuptova, kaq.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

E hapë diskutimin.

Nuk ka.

Atëherë, e lus regjinë të përgatitet për votim.

Votojmë tash.
Faleminderit!

Atëherë, më 31 vota për, 1 kundër dhe 5 abstenime, miratohet përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së "Kodra e Trimave 1".

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi.

Në emër të Grupit Parlamentare të LDK.

Halim Halimi ne e kemi shqyrtuar si GP është çështje të cilën e ka rregulluar ligji, d.m.th. Ligji mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme dhe këmbimin e pronës komunale me pronat e pronarëve fizikë, duke pas parasysh interesin e përgjithshëm, kështu që ne jemi, e përkrahim, por me një vërejtje, një kërkesë që atë që e biseduam më herët, d.m.th. të bihen kërkesat, mos të seleksionohen dikujt po dikujt jo, të jemi të barabartë për gjithë. Kështu që GP i LDK-së e përkrah, d.m.th. kur flas i përkrah, i përkrahi tri pikat, kështu meqë janë të ngjashme, besoj se duhet të tria edhe vendosim, apo ndoshta me Rregullore duhet për secilin rast veç e veç, kështu që Grupi ynë parlamentar voton për.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë, sipas rekomandimit të zotëri Halimit, deklarimi le të bëhet tash për të tri rastet, ndërsa votimin shkojmë një nga një.

Vala Peshku, Grupi i pavarur.

Vala Peshku: Faleminderit, kryesues!

Në këtë pikë pajtohem kryesisht me zotëri Halim Halimin, të shkojmë për deklarin e tri pikave në parim, Grupi ynë i pavarur nuk ka asgjë kundër rreth këtyre tri propozimeve, por kisha pasur dëshirë që drejtorit Dren Kukaj, ti them që herën tjetër të vij me përgjigje sa më të sakta, sepse Asamblesë i intereson rreth kësaj veç të jeni pak më konciz dhe më të përgatitur.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

GP i LVV-së.

Eman Rrahmani.

Eman Rrahmani: Edhe Grupi i LVV-së e përkrah edhe idenë e Halim Halimit, ajo çka kërkova edhe më herët prej Drenit, kisha dashtë me arsyetuar pra këtë punën qysh, në bazë të cilave kriteret vendoset që një ose një grup i parcelash të bëhet këmbim me komunën e territorit, dhe në bazë të cilave kriteret vendoset mi jap hapësirë ndërtuese, për shkak se nuk është praktike, siç e thamë më parë, se për shkak se praktike ka që i jap edhe më herët hapësirë ndërtuesve e jo këmbim i pronave. Po më interesojnë kriteret në bazë të të cilave vendos, përndryshe jemi pro të triave dhe nuk ka problem.

Kryesuesi, në emër të Grupit të PDK –së?

Leutrim Retkoceri.

Leutrim Retkoceri, sa i përket pikave 3, 4 dhe 5, ne japim propozimin tonë dhe sigurisht nuk pajtohemi që të bëjmë diskriminim në parime. Unë po habitem pak prej disa kolegëve këshilltarë këtu që kanë dashtë me na tranuar për disa parime, ndërkaq parime të barabarta për qytetarë nuk mbajnë. Thash edhe një herë, janë të papranueshme, jam i gatshëm edhe në njërin prej këtyre pronarëve që kanë mundur me pasur konflikt interesi, me informacionet që i kemi marrë tash, pa dashtë me u lëshuar në privatësinë e tyre, sepse nëse ne i votojmë këto, po qesim presedent të keq për këtë Asamble, pavarësisht kësaj situate dhe praktikave që i kemi pasur më herët, por për këtë e merrni më vonë vesh edhe ju, kryesues, e po besoj para qytetarëve dalim faqebardhë dhe nuk dalim të skuqur.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të AAK-së?

Yll Bogaj.

Yll Bogaj: Faleminderit, kryesues!

GP i AAK-së pikat 3, 4 dhe 5 i përkrah në parim.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Grupi i AKR –AA?

Vesel Makolli.

Vesel Makolli: Edhe ne i përkrahim, por prapë unë po e jap një vërejtje me qenë pak më të qarta këto materiale. Unë e mora vesh bukur me vështirësi që kjo parcelë qenka te “Inter Eminex”, aty te shtëpia e Veli Deves po më duket, nëse se kom unë gabim. Kjo parcela që ne po e marrim atje, është diku në kodër të Matiçanit, për mbi rrugën “B”, atje po jepen 6 arë e këtu po merren 3 arë, vlefata këtu ku është ky i yni, po mendoj kur them ky i yni, e kam fjalën, i Komunës, është disa here është më e madhe se ajo vlera atje, jo ndoshta një dhjetë, por ndoshta një 5 a 6 po, prandaj ai në këta 3 ari nuk mundet, ne jemi të vetëdijshëm se ai aty s’mund të ndërtojë, por sigurisht ka me bërë ndonjë marrëveshje me i marrë disa banesa me 3 ari aty, sigurisht i merr një 5 banesa, e ne kemi mundur me i marrë atje 5 banesa, ne Komuna, e me i strehuar 5 familje, e atje 6 arë nuk mund të kushtojnë mbi 100.000 €, kurse një banës këtu kushton afër 100.000 €. Prandaj, parimisht, meqë shumica po e përkrahin, po e përkrahim edhe ne, por tjetër here të mendohet mirë, të mendohet interesi i Komunës, ne këtu e përfaqësojmë interesin e Komunës, e ata që propozojnë ta propozojnë edhe më qartë dhe ta kenë parasysh interesin e Komunës, interesin e përgjithshëm në rend të parë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë, diskutime nuk ka, shkojmë me votim.

I lutem regjisë, a deshe, nuk ka diçka të re, nuk ka.

E lus regjinë, të përgatitemi për votim të shkojmë tash me votim, shkoni votim, ju lutem!

Më 30 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, konstatojmë se miratohet Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi.

Shkojmë tash me votim për pikën e pestë.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha.

Po, ka ndryshuar, se ka hy ajo, ka ndryshuar renditja, atëherë regjia gati, shkojmë.

Më 33 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, konstatojmë se miratohet Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha.

Shkojmë tash me votimin e pikës së gjashtë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi.

Regjia, shkojmë me votim.

Me 32 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, konstatojmë se miratohet Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi.

Faleminderit shumë!

Shkojmë te pika e shtatë e rendit të ditës.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Atëherë, në emër të kryetarit e prezanton z. Osman Bllaca.

Osman Bllaca: ... ne më herët për subvencionet që i kemi, nda prej kategorisë së kryetarit, Drejtorisë së Arsimit, të Shëndetësisë, të Kulturës, të Zhvillimit Ekonomikë dhe të Bujqësisë, nuk kemi pasur rregullore për ndarjen e këtyre subvencioneve, por Kryetari në vitin 2014 e ka nxjerrë një vendim, ku i ka përcaktuar disa kritere dhe kushtet për ndarjen e atyre subvencioneve, është parë nevojë e madhe. Në bashkëpunime me DEMOS-in, një Fondacion zviceran, na kanë thirrur disa komuna dhe në përbërje të Komunës së Prishtinës kemi qenë unë dhe kryesuesi, ish-kryesuesi, zotëri Halim Halimi, dhe bashkërisht i kemi paraqitur të gjitha nevojat dhe problemet me të cilat po

ballafaqohemi ne me ndarjen e subvencioneve. Prandaj, me këtë rregullore, ku kemi punuar bukur shumë për këtë rregullore, më pas e kemi sjellë këtë draft në Kuvend për me ta marrë aprovimin paraprak për dëgjim publikë, ku me ligj konsiderohen si konsulta paraprake. Në kuadër të kësaj rregulloreje janë përcaktuar kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat mundësojnë subvencionet. Për ata që nuk janë ekonomista, subvencionet janë mjete pa kthim për personat fizikë dhe juridikë, janë paraparë për disa kategori, që i ceka më lartë, dhe është një kategori për shpenzimet e funeraleve, që është politikë e kryetarit, e që ka filluar ta zbatojë. Në kuadër të kësaj politike janë futur edhe kriteret, të cilat duhet t'i paraqesin familjarët e personave që kanë vdekur. Këto i kemi paraparë edhe te limitet buxhetore, të cilat janë, i shihni aty për të gjitha kategoritë, këtu te Shëndetësia, është e ndarë, dhe Mirëqenies Sociale, te shëndetësisë hynë të personave të cilët kanë sëmundje të ndryshme, këto kancerogjene, dhe te Mirëqenia Sociale janë të familjeve që janë shumë të varfra dhe që ne i japim një ndihmë të njëkohësishme me sociale. Më pastaj, në kuadër të kësaj rregulloreje janë paraparë që ta kemi edhe Komision për ankesa, që më herët nuk ka pasur, e në qoftë se nuk u është dhënë, p.sh. kanë konkurruar 100, kanë bërë kërkesa për subvencione dhe nuk janë dhënë të gjitha, atëherë nuk kanë pasur të drejtë për ankesa, ndërsa tash formohet një komision i veçantë që do t'i shqyrtojë edhe ankesat e atyre të cilëve nuk u janë ndarë subvencione për çka kanë kërkuar.

Anëtarë, të nderuar, ju lus të votoni këtë rregullore, sepse rregullore të tillë deri tani nuk kemi pasur, dhe do të formojmë, do të kemi dëgjim publike prej 15 ditësh për këtë rregullore, do t'i marrim në konsideratë vërejtjet tuaja që do ti jepni tash, po ashtu edhe ato rekomandime dhe sugjerime që dalin nga kjo mbledhje dhe në dëgjimet e tjera, e më pas do ta sjellim përsëri për aprovim final dhe shpresojmë që ta begatojmë sa më shumë këtë rregullore.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit, Osman!

Shkojmë me GP-të, me radhë.

Po, po, veç prit, tash ky vjen prezantim.

Halim Halimi.

Halim Halimi: Faleminderit, kryesues!

Qëndron ajo që tha, po them përfaqësuesi i kryetarit, se kryetari rrallë herë vjen në këtë sallë, kështu që kemi rastin që shumë komunikojmë me nënkryetarin, se kryetari duhet me ardhur ndonjëherë këtu.

Sa i përket Projektregullores për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës, është vërtetë për herë të parë kjo rregullore, kanë punuar në bazë të një vendimi, dhe unë mendoj se është punuar mirë, por vërejtja ime është, por më mirë mos me e thënë, me lënë pasi të dërgohet në konsulta publike, por pasi që veç e përmenda, duhet me thënë se i është lënë kryetarit një kompetenca jashtëzakonisht e madhe, duhet të limitizohet, duhet të kufizohet deri në çfarë shume mundet kryetari për ndonjë shumë të madhe të subvencioneve, unë mendoj, por jo që unë mendoj, por ka qenë në draftrregullore gjatë punimeve, që deri në 10.000€ vendos Komisioni dhe Kryetari, për shumën mbi 10.000€ të

sjellët në këtë Kuvend dhe të shqyrtohet, të diskutohet, ngase mund të çrregullohet çështja e buxhetit komunal. Unë s'po them, ne ndoshta e kemi kryetarin e përgjegjshëm, po mos ndoshta ndonjëherë ndonjë kryetar i papërgjegjshëm mund të bëjë çrregullime në aspektin financiar të Komunës.

Faleminderit! I presim vërejtjet dhe atëherë do të ...,

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Vala Peshku.

Vala Peshku: Më falni se isha mbrapa duke u konsultuar, kërkoj falje.

Kështu, Grupi ynë është në përgjithësi, pajtohet edhe me Vendimin për konsulta paraprake lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Unë kërkoj falje, kolegja ime këtu, Visarja, e cila është edhe njohëse e barazisë gjinore, ajo ma tërhoqi vërejtjen se duhet të inkorporohet në disa raste kategoria e nënave vetushqyese. Unë besoj që ajo për shkak të një angazhimi që nuk ka mundur me shty, nuk munda të qëndrojë, por me siguri i dërgon vërejtjet e saj në secilën pikë, rast, të kësaj kategorie lidhur me këtë raport, pra i dërgon me shkrim.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit të LVV-së?

Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Edhe ne parimisht jemi pro rregullores, veç pajtohem me kërkesën e zotëri Halimit që subvencionet e Kryetarit duhet me qenë një shumë e kufizuar, për shkak se kjo shumë lehtë mundet me shërbye vetëm për interesa të ngushta të tij, kështu që të jetë një shumë e kufizuar ku konsultohet e gjithë Asambleja dhe besoj që do të jetë më pozitive se ku do të ndahen ato subvencione.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit të PDK-së?

Leutrim Retkoceri.

Leutrim Retkoceri: Përshëndetje edhe një herë.

Sa i përket kësaj pike, Grupi i PDK-së e përkrah në parim, duke i pas parasysh dy faktet, atë se subvencioni d.m.th. për bujqësi në mandatin e kaluar ka tepruar jashtëzakonisht, shumë mjete kanë dalë suficit, s'kanë mund të shpërndahen, të paktën kjo Rregullore do të mund t'i shpërndajë, ndërsa te kufizimet, besoj që pas dëgjimeve publike dhe diskutimeve do të japim edhe rekomandimet tona, për shkak se ne e dimë se kryetari në mandatin e kaluar e pati çmendur Komunën me kontrata mbi vepër, dhe këto mjete me shumë të lartë me ja lënë, po më duket e vizaton krejt këtë subjektin e vet nëpër Prishtinë. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të AAK-së?

Valbona Ajeti.

Valbona Ajeti: Edhe Grupi ynë pajtohet me Propozimvendimin për subvencione, edhe pajtohem i sipas rregullores është bërë formimi i komisioneve në komunën tonë, pra drejtoritë përkatëse, ekspertë të jashtëm që kanë me qenë në ato komisione edhe pjesëtarë nga Shoqëria civile, mendojmë që kjo ka ndikuar që të merret si gjykim i drejtë dhe të jetë transparente ndarja e atyre mjeteve familjeve me nevojë ose të atyre të cilët i përfitojnë këto subvencione.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit të AKR-AA-së?

Rifat Deri.

Rifat Deri: Faleminderit!

Duke mos dashur me marrë shumë kohë, unë kisha kaluar menjëherë në vërejtjet të cilat Grupi ynë parlamentar i ka në këtë projektregullore për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Prishtinës. Vërejtja e parë është në nenin 6, ku merret me përjashtim ndarja e subvencioneve, respektivisht në pikën 6.3 të saj, ku thuhet: “përjashtim nga paragrafi 6.2 bëjnë subvencionet e ndara për personat fizikë në fushën e shëndetësisë, për nevoja ushqimore, mirëqenie sociale dhe në fushën e bujqësisë.” Pyetja ime është: Pse duhet këto subvencione të ndahen në këto dy fusha dhe të vihet ky përjashtim?

Vazhdojmë me nenin 9: “Kryetari i Komunës e emëron Komisionin me mandat trevjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve, në përbërje të përfaqësuesve nga fusha specifike”. Kjo për ne është shumë e paqartë, ngase këtu duhet specifikuar saktë se cilët janë ata përfaqësues dhe duhet të definohet se për cilat fusha specifike bëhet fjalë saktësisht, në mënyrë që të shmanget çfarëdo paqartësie lidhje me përbërjen e këtyre komisioneve.

Vërejtja tjetër është në nenin 14, ku thotë: Komuna ndan subvencione për arsim, duke përfshirë këtu, duke mos u përkufizuar vetëm në, pastaj në mes pikave h) dhe e) thuhet kështu: “Nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar”, ndërsa pika ë) thotë: “Mësimdhënësit kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar”. Pra, bëhet fjalë për dy formulime shumë të përgjysmuara, sepse në asnjë vend nuk ceket se si do të maten këto rezultate, e as si do të vërtetohen këto rezultate. Pra, pyetja është: Pse nuk është cekur më saktë se cilët do të jenë ata parametra me të cilët do të bëhet vlerësimi në fjalë, çoftë të nxënësve, çoftë të mësimdhënësve për këto subvencione? Rrjedhimisht, këto dy pikat duhet të qartësohen në detaje, në mënyrë që të mos prodhojnë paragjykime e as dyshime.

Po ashtu, në pikën 15.3 thuhet: “Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës, nëse brenda një vitit kalendarik ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror, ose ndonjë donator tjetër në fushën e njëjtë.” Do me thënë pyetja është: Si mund të vërtetohet kjo, respektivisht cila është procedura që do të mundësojë kontrollimin e nevojshëm, meqenëse askund nuk argumentohet se si do të bëhet kjo punë?

Më tutje, neni 16, subvencioni mbi zhvillimin ekonomik, respektivisht në pikën 16.2 thuhet: “Komuna do të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik, duke përfshirë edhe duke mos u përkufizuar vetëm në..//”, pastaj në pikët i), j), k) thotë: “Bizneset e reja ose fillestare, aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit” dhe nën k): “Aktivitetet për hulumtimin e tregut”. Mendoj pikës ë) duhet shtuar edhe pjesa: “... ku përparësi kanë bizneset e reja dhe fillestare, që kanë përpiluar saktë bizneset e tyre, planet e tyre dhe planet ekzakte të punës”.

Përderisa pikat j), k), sipas mendimit tim janë konfuzë dhe të paprecizuara. Shkojmë në pikën 16.4, në të njëjtin nene thuhet: “ përfitues të subvencioneve për zhvillim ... (nuk kuptohet fjala) ekonomik mund të jenë bizneset, që nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara Komunale dhe ATK -së”. Këtu mendoj se nuk vlen ky definim, paraprakisht duke ditur shkaqet që kanë ndikuar në mospagesë, sepse fundja mendoj se me kusht se ekziston një argumentim i vlefshëm, këto biznese duhet të stimuloheshin, në mënyrë që të mbijetojnë, sepse me mossubvencionimin e tyre me automatizëm , automatikisht, në mënyrë indirekte mund të ndikoni në mbylljen e tyre, respektivisht në rritjen e mëtutjeshme të papunësisë në Komunë.

Më tutje, neni 17, respektivisht 17.1 thuhet: “Gjatë ndarjes për zhvillim ekonomik në kushte të njëjta, të barabarta, Komuna i jep përparësi rasteve specifike, si në vijim”, ndërkohë që në pikën b) thuhet: “... grave, të rinjve, veprimtarive në zona rurale, personave me nevoja të veçanta dhe minoritete etnike.

Pyetja ime është: Pse duhet dhënë përparësi subvencion për komunitete etnike? Kosova ka Kushtetutë, është shtet i qytetarëve sipas Kushtetutës, që nënkupton se të gjithë shtetasit e saj janë të barabartë para ligjit, prandaj mendoj se theksimi i përkatësisë etnike të dikujt për t’i dhënë subvencione për zhvillim ekonomik, është krejt absurd, njësoj siç duket absurd edhe pika e), ku thuhet: “OJQ të cilat aplikojnë për projekt biznesi që mundësojnë gjenerimin e vendeve të punës”, kjo sipas meje, kupton vetëm humbje të mjeteve dhe të kohës. Shumë e arsyeshme do të kishte qenë, për shembull kjo nënpikë që do të zëvendësoj “ OJQ -të që sigurojnë trajtime specifike dhe vende specifike pune, për të cilat ka deficit në komunën tonë”.

Më tutje, neni 20, dokumente të nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi, respektivisht pika 2, d), e) f), ku thuhet “Në mes të dokumenteve të nevojshme janë: dëshmia për pagesën e taksave komunale; dëshmia për pagesën e tatimit në pronë dhe dëshmia se nuk ka obligime ndaj ATK-së”. Këto tri pika mendoj se janë të panevojshme, madje ndoshta edhe kundërshtuese, sepse në start e eliminojmë një aplikues potencial, në qoftë se edhe atëherë ky i fundit ka një projekte shumë profitabil, dua të them se këto tri kushte mund të futen si një aneksi i veçantë, sipas të cilës nëse aplikuesi ka kësi obligime të pa shlyera, ai obligohet t’i shlyej ato paralelisht me realizimin e projektit për të cilin kërkon subvencion ose, më së largëti deri në përfundimin e plotë të projektit, por jo t’i pamundësohet aplikimi për këto arsye. Po ashtu, jam kundër pikave e) f) të pikës 20.2 të këtij neni, sepse edhe ato sikurse në rastin e mësipërm paraqesin një eliminim të panevojshëm të aplikuesit potencial.

Më tutje, neni 22, subvencionet në lëmin e mirëqenies sociale për individë dhe familje, gjegjësisht pika 22.7, thuhet: “Kërkesa për ndihmë të menjëhershme mund të bëhet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas momentit të ndodhjes së rastit të jashtëzakonshëm”.

Ky formulim mendoj se është totalimisht i palogjikshëm, sepse nuk e kuptoj për çfarë rasti të jashtëzakonshëm po flasim, kur kërkesa mundë të bëhet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë ata duhet, se një rast i jashtëzakonshëm të trajtohet me urgjencë dhe nëse ky afat maksimalisht një apo dy javë e jo dy muaj. Nëse dikujt i duhen ato mjete, ndonjë rast sërish i paspecifikuar, të jashtëzakonshëm mendoj, edhe afatet duhet të jenë të tilla, pra afate të jashtëzakonshme qoftë nga kërkuesi, apo nga ofertuesi i subvencionit.

Më tutje kemi vërejtjen në nenin 23, dokumentacioni i nevojshëm për parashtrimin e kërkesës për ndihmë momentale të një hershme, gjegjësisht në pika b) thuhet: "Se parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë edhe kopjen e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj, azilkërkuesit, refugjatët dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme". Mendoj që Komuna nuk duhet fare të merret me këto punë, por është Ministria e Punëve të Brendshme, në raste të këtilla Komuna veçanërisht mund të ofrojë ose të procedojë veprime të deleguara nga niveli qendror, pra nga ministria gjegjëse, dhe këtu e kemi bërë një gabim të madh.

Më tutje, neni 25, shpenzimet funerale, unë mendoj që këtu të shtohet edhe një pikë, në të cilën do të trajtohej caktimi i lokacionit të varrezave për pjesëtarët e ... (nuk kuptohet fjala) katolik dhe lokacioni i ri për varrezat për pjesëtarët e ... (nuk kuptohet fjala) mysliman.

Në fund, neni 29, transparenca në ndarjen e subvencioneve, mendoj në pikën 21.2 duhet të ceket e kundërta, pra që Komuna i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara, e jo nuk i publikon, siç thuhet tani, kjo për arsye se vetëm me këtë vërtetohet vet transparenca e Komunës në ndarjen e subvencioneve.

Kaç kisha për këto vërejtjet e mia.

Faleminderit për vëmendje!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

E hap diskutimin.

Fiknete Bejta.

Fiknete Bejta: Te materiali që na është dërguar kam, vërejt se kjo rregullore apo projekt propozim, ka mangësi në përkufizimin e qartë të termit subvencion, në përcaktimin e kriterëve për subvencion shuma e komisionit vlerësues etj., tek vlera e shumave ... përjashtimisht tek financimi i

Kryesuesi: Nuk po dëgjoresh mirë.

Fiknete Bejta: Përjashtimisht te OJQ-të, ka një përkufizim sa i përket kriterëve, ndërsa te kategoritë tjera nuk janë të përcaktuara, për shembull vërejtje të shkalla e përcaktimit është te bujqësia, është një shkallë e lartë e bashkëfinancimit ose vetëfinancimit nga aplikuesi, që unë mendoj se 20% është vlera e lartë, marrë për bazë zhvillimin ekonomike që e kanë këta aplikues në tërësi, ndërsa në tërësinë e kësaj rregullore, mund të konstatoj se nuk janë respektuar 4 elementet bazë, pagesa ndaj kujt duhet të bëhet, mënyra e pagesës e cila është saktësuar vetëm pjesërisht, qëllimi apo arsyeshmëria e pagesës, si dhe kufizimi

me pagesë brenda një viti fiskal, kjo ka qenë në vazhdimësi. Edhe një vërejtje nga Zyra e auditori, që kemi hasur vitet e kaluara, që u janë bërë pagesa dy herë brenda vitit, siç është rasti i OJQ "Oda", pastaj kemi problemin e komisionit të vlerësimit, ku janë paraparë anëtarët me mandat më shumë se 1 vjet, e që sipas ekspertëve nuk është e arsyeshme që 5 anëtarët e komisionit të jenë, së paku një anëtar i komisionit të jetë me një mandat njëvjeçar, ose ... me rotacion nuk është precizuar, do me thënë profesionalizmi i këtyre anëtarëve të komisionit dhe departamentit që marrin pjesë, nuk është precizuar gjithashtu eliminimi i problemit të konfliktit të interesit dhe nepotizmit, duhet të gjendet një mënyrë për ta eliminuar këtë problem, pasi kemi hasur disa raste të subvencionimit të familjarëve nga ana e drejtorëve të Komunës në mandatin e kaluar, pastaj nuk parashihet që komisioni që të ketë, do me thënë kjo projektregullore nuk parasheh të ketë komision monitorues dhe një element tjetër i rëndësishëm, mekanizëm i matjes së performancës. Në komisionin vlerësues nuk respektohet barazia gjinore, pasi që nuk përkufizohet që komisioni të ketë në përbërje gra. Gjithashtu, kur jemi te barazia gjinore, nuk është paraparë siç parashihet në të gjitha thirrjet për projekte dhe subvencione një fushë e veçantë për subvencionimin afariste gra ose të paktën në start të jepet mundësi një 5% poentim më shumë tek gratë e interesuara për zhvillim të firmave, apo të sektorëve të tjera të zhvillimit ekonomik ose të kulturës. Pastaj nuk janë përkufizuar sa është mosha e bizneseve të reja, thuhet vetëm bizneset e reja, por nuk është përkufizuar, se te....(nuk po kuptohet fjalia) e dimë që është me muaj, ndërsa te bizneset e reja duhet të përkufizohet në vite. Mendoj se kjo rregullore duhet t'i japë grupeve të interesit një bazë të ndarjes të rregullt dhe të barabartë të parasë publike, ndërsa në disa raste vërej një (nuk kuptohet fjala) në mes të neneve dhe fushave që janë përcaktuar.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë, regjia, se di çka ndodhi!

Sokol Havolli.

Faleminderit!

Sokol Havolli: Faleminderit shumë, kryesues!

Në fakt, është lajm i mirë që po bëhet rregullorja për subvencionime dhe do t'i nënshtrohet sigurisht edhe diskutimi publik, ku do të trajnohet në detaje secili aspekte. Njëra prej çështjeve, veç në fakte u ngritën disa prej çështjeve që pata në plan t'i ngriti, por dua ta theksoj edhe në Qeverinë e Kosovës shuma përmbi 10.000 € ndahet në vendime kolektive, pra me vendime të Qeverisë, kështu që nuk është mirë shuma mbi 10.000 € të mbetet në ekskluzivitet të Kryetarit, por t'i nënshtrohen ashtu siç e propozoi shefi i Grupit tonë, pra t'i nënshtrohen edhe votimit në Kuvend, besoj se e rritë transparencën, sepse transparenca është njëra prej elementeve kyçe sa i përket ndarjes së

subvencioneve, prandaj do të ishte shumë në rregull, shumë korrekte dhe shumë transparente nëse shumat mbi 10.000 € sillen për votim në Asamblenë komunale, sidomos 10.000 € është shumë e konsiderueshme edhe për buxhetin, gjë për të cilin është përgjegjëse edhe Asambleja komunale.

Si pjesë e dytë, po ashtu po aç e rëndësishme, është ritheksim i çështjes së evitimit të konfliktit të interesit, nëse i kthehemi praktikës së kaluar, kemi drejtoreshën e Arsimit, që ka ndarë shuma për motrën e vetë dhe nuk janë realizuar, do të thotë ato për çka i kanë marrë mjetet financiare, kështu që të evitohet keqe përdorimi, sepse ai është keqpërdorim eksplicit i parasë publike. Prandaj, duhet të jetë shumë e drejtpërdrejtë çështja e konfliktit të interesit dhe nepotizmit, se nuk guxojmë që drejtorë të Komunës së Prishtinës, as asamblist, e as Kryetar, askush të keqpërdorë me paranë publike të qytetarit të Prishtinës, duhet të jenë të shfrytëzuara mirë. E kemi rastin e ish-drejtoreshës, tani deputete, nëse nuk gabo, ku ka ndarë shuma nga 2000 - 3000 € për motrat e veta e për familjarët e vetë dhe realizimet e atyre subvencioneve që nuk janë realizuar asnjëherë, pra nuk ka ardhur produkti final për çka e kanë marrë, kështu që këtë ta evitojmë. Madje edhe është në përgjegjësi të ekzekutivit të Komunës, të bëjë denoncimin e këtyre keqpërdoruesve, siç ishte rasti me Arbërie Nagavcin.

Kryesuesi: Faleminderit!

Kushtrim Sopa.

Kushtrim Sopa: Kryesues, nisu para vetes, si pikë të rendit të ditës e kemi “Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve”, ne siç e dimë, është e paraparë me Ligj që kjo pikë e rendit të ditës, gjegjësisht ndarjen e subvencioneve nga Komuna e ka si të drejtë ekskluzive Kryetari i Komunës, ku në disa raste unë e konsideroj se është e panevojshme pjesëmarrja e tij, sepse ka punë edhe më të mëdha, përgjegjësi edhe më të mëdha. Qëllimi apo planifikimi i ndarjes së këtyre subvencioneve nënkuptohet se është i mirë, si dhe motivuesi i madh për përfituesit eventual. Unë do të dëshiroja që para nesh ta kishim edhe planifikimin financiar për ndarjen e subvencioneve për secilën fushë, secilin sektor, dhe besoj se do të ishte shumë më e qartë se a do të bëhet në mënyrën e duhur planifikimi, si dhe i a plotëson nevojat e fushave. Unë kam disa rekomandime të mijat që do t’i paraqes për diskutim për publik, që do t’i shtohen këtij diskutimi publik për subvencione, d.m.th. pika 1, kategorizimi i subvencioneve; pika 2, sektorët me prioritet arsim, shëndetësi, kulturë, rini dhe sport, bujqësi, zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale dhe inovacione.

Planifikim buxhetor për secilin sektor, monitorim i komisioneve vlerësuese për ndarjen e subvencioneve nga komitetet përkatëse të fushave dhe, si pikë e fundit, lehtësim apo thjeshtësim procedurash të disa sektorëve përkatës, sidomos në ato me prioritet, me theks të veçantë, shpenzime për funerale, se familjet kanë brenga më të mëdha në ato momente, duke mbetur gjithmonë me shpresë se ndarja e këtyre subvencioneve do të bëhet drejt dhe në shërbim sa më të mirë të qytetarëve të Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Agim Gashi.

Agim Gashi: Faleminderit shumë!

Unë kam shkurt dy-tri fjali.

Së pari, ne duhet të kuptojmë se kjo Rregullore shkon në diskutim publik, andaj sugjeroj të jemi më të shkurtë, mos të harxhohemi shumë sot, se edhe një herë kemi me pasur në dorë këtë punë, t'i lëmë më shumë grupeve të interesit që të japin vërejtje.

Nën dy, mos të brengosemi shumë rreth kompetencave të Kryetarit, se ato kompetenca ia ka dhënë ligji, për arsye se subvencionet janë e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Komunës dhe asnjë rast, asnjë përkrahje e subvencionuesve nuk e kalon 10,000 €, s'e kalon as 2.000 - 3.000€, ato janë para të imëta që Kryetari e ka për detyrë me u kujdesur për t'i mbuluar nevojat e grupeve të interesit në të gjitha sferat e jetës të qytetarëve të komunës së Prishtinës, por kjo nuk e justifikon gabimin qysh e ka bërë, d.m.th. rasti i drejtoreshës së Arsimit, ku është krijuar konflikti i interesit atje, plus asaj iu ka dhënë qytetarit që nuk është banor rezident i komunës së Prishtinës, sepse subvencionet janë të destinuara për qytetarë rezidentë të komunës së Prishtinës. Kështu që mund t'ju kursej kohë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Arbenita Murseli.

Arbenita Murseli: Të nderuar, sa i përket Propozimvendimit për konsulta paraprake lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve, e përgëzoj iniciativën, se këto subvencione janë të mirëseardhura për cilën do fushë që janë cekur në këtë rregullore, por kuptohet duke u plotësuar disa kriteret. Dua të filloj nga arsimit, kjo fushë jetike për zhvillimin ekonomik dhe social, e nga e cila lulëzojnë gjenerata të tëra, duke u nisur nga rezultatet e pakënaqshme të testit PISA, inkurajoj të gjithë nxënësit e mësimdhënësit që të paraqesin kërkesat e tyre për nxitjen arsimore - edukative. Ndarja e bursave për nxënësit të bëhet për dy qëllime. Në njërin anë, të stimulohen ata nxënës të shkëlqyer, që përfaqësojnë gjini të fushave të ndryshme, duke i stimuluar dhe motivuar që sukseset e tyre mos të kenë të ndalur, në anën tjetër, të stimulohen edhe ata nxënës që vijnë nga familjet me gjendje të rëndë ekonomiko e sociale, të cilat nuk lënë hapësirë që talentin i tyre të shfrytëzohet, duke i demotivuar kështu edhe më shumë.

Një fushë tjetër që unë dua ta nënvizoj, është bujqësia, kjo fushë me kaq perspektivë për një rajon kaq të përshtatshëm siç është Prishtina, e sidomos për rajonin e Gollakut, rajon ky ideal për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Le të stimulohen me subvencione ata bujq që në vend që të qahen për papunësinë, janë vetë gjeneruesit më të mëdhenj të vendeve të punës, duke krijuar punë për veten dhe të tjerët e duke i dhënë hijeshi tokave tona pjellore.

Dhe e treta, që dua ta potencoj, janë subvencionet që do t'i kontribuojnë zhvillimit ekonomik të Prishtinës, t'ju bëjë thirrje të gjithë atyre personave që kanë ide të shkëlqyera në të bërit biznes, të ashtuquajturit "engjëjt e biznesit", ndërmarrësit e rinj, idetë e të cilëve mund shumë lehtë të shndërrohen në histori suksesi. Kjo do të bëhet fal përpjekjeve të tyre dhe fal subvencioneve që ne do t'i ofrojmë si Komunë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë gjenerues më të mëdhenj të vendeve të punës dhe është këtu mundësia që ata t'i marrin hapat e parë, duke shpresuar se shumë shpejt do të krijohet edhe Parku i biznesit për rajonin e Prishtinës, e që do të shërbejë si fole, ku do të lulëzojnë me dhjetëra inkubatorë të biznesit, duke i provuar kështu idetë e tyre novatore, e më pas duke u shndërruar në kompani gjigante.

Për fund, këto subvencione duhet të ndahen sipas disa kriterëve që ne i kemi të përshkruara në këtë rregullore, të jenë rregulla strikte, që të zbatohen për secilin aplikues. Komisionet e përzgjedhura për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, të na raportojnë në vazhdimësi, po ashtu edhe Komisioni për vlerësimin e ankesave. Gjithashtu, të kemi edhe një raport të qartë rreth monitorimit të shfrytëzimit të këtyre subvencioneve, kështu që për asnjë kusht paraja publike mos të ketë keqpërdorim, por ta ketë destinimin ashtu siç e ka edhe qëllimin.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Adrian Berisha.

Adrian Berisha: Nuk po dua me e zgjatur shumë, veç disa këshilla, d.m.th. që ju me i marrë parasysh, neni 6, pika 2, personi fizik apo juridik, vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna, unë nuk pajtohem me këtë pikë, për arsye se çka nëse një organizatë i ka tri projekte shumë të mira, kurse përfitues është një organizatë tjetër, e cila e ka një projekt jo të mirë. P.sh. e kemi rastin e OJQ "Termokis", e cila i ka 3-4 projekte, por ajo mundet me aplikuar vetëm një herë. Unë kisha thënë që me pasur parasysh këtë pikë, sepse ka projekte që përfitojnë nga subvencionet në kulturë, rini dhe sport, të cilat nuk krahasohen me projektet dytësore të një organizate, apo personi fizik tjetër. Nëse një person fizik i ka dy projekte shumë të mira, unë jam pro, me ia dhënë atij personi fizik dy projekte shumë të mira, në vend që me ia dhënë personit tjetër, i cili e ka një projekt primar, më të keq se projekti sekondar i këtij personit paraprakë. Procesi i ndarjes së subvencioneve, neni 12, me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është bërë d.m.th. shpallja dhe kanë aplikuar shumë persona fizikë dhe juridikë apo cili ke ai, veç procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljes publike, të cilat publikohen në ueb-faqen e Komunës në tabelat e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës. Duhet me pasur parasysh, d.m.th. që kishte me qenë mirë me pasur edhe shpallje në televizionet lokale dhe radio, sepse shumë organizata apo persona nuk e kanë marrë lajmin dhe po na kritikojnë, nuk e kam ditur, po thonë, dhe tash afati veç ka kaluar, dhe kisha sugjeruar që me bërë (fjala nuk kuptohet) pak më të mirë sa i përket subvencioneve në përgjithësi. Kisha dashur me pyetur: A ka rëndësi kriteret e subvencioneve, p.sh. këtu te kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave, p.sh. a është më e rëndësishme pika "a" se pika "h"? Veç

një pyetje d.m.th. kështu, apo sepse ky kategorizim as nuk është bërë, nuk ka rëndësi, atë desha me e ditur. Sepse po më duket p.sh. banimi në zona rurale, zona rurale dhe zona urbane, nuk kisha me thënë me pasur dallim, duke e marr parasysh që ne jemi qytetarë të njëjtë të Kosovës, më e rëndësishme është d.m.th. me e futur një familje me gjendje të rëndë sociale, se ke ti banorë në zonën rurale që i ka kushtet më të mira sociale sesa një banorë në zonën urbane. Pra, d.m.th. mua po më duket e çuditshme kjo, banorë në zonën rurale, duke e marrë parasysh që zona rurale ka shumë familje që i kanë kushtet shumë të mira. Gjithashtu, edhe te neni 15, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, te ndarja e bursave d.m.th. për shkollim, këtu kurrkund nuk po ceket p.sh. dokument të trajnimeve, ose dokument të vullnetarizmit. Qysh me e motivuar ne vullnetarizmin, ne e qesim një kriter që nëse t'i bën punë vullnetare, ne kemi me e pas parasysh atë, dhe t'i me mundur në të ardhmen me pasur përparësi në bursën që ke me e përfituar, kishte me qenë shumë e mirë edhe kjo. Dhe, për fund, e kam një pikë te funerali, d.m.th. këtu nuk po cekën kriteret që duhet me i plotësuar. Unë jam kundër p.sh. me ia mbuluar shpenzimet një familjes e cila nuk ka gjendje të rëndë sociale, këtu është mirë me e cekur, familjet të cilat kanë përparësi, janë familjet me gjendje të rëndë sociale, ose familjet e dala nga lufta, për krejt, d.m.th. nuk ka këtu kujt donë kryetari dhe komisioni, nuk e kam lexuar bash mirë, Leutrim. Në rregull është propozimi im, qenka ashtu, shumë mirë, merreni parasysh, nuk kam mundur me e lexuar, qysh nuk e ka lexuar as kolegu yt, a e din ministër, aty që erdhe më herët i pati dokumentet krejt këtu, thoshte sepse ka gjasa që kemi punë gjatë javës shumë dhe tash i marrim dokumentet, a po e dinë që është normale. Në rregull, më mirë është me dhënë sugjerim, sesa gjithmonë kritikë edhe ofendim, kështu që në rregull.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Naime Osmani.

Naime Osmani: Faleminderit kryesues!

Unë nuk dua me u zgjatur shumë, por pasi kolegja ime, Fiknetja, i tha të gjitha çka kisha edhe unë për të thënë, por vetëm një gjë po e ceku, që pajtohem me dokumentacionin i cili kërkohet kur aplikojnë për subvencione, si p.sh. siç është dëshmi për kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së edhe ndaj Komunës, sepse nuk është e njëjtë si ai që i paguan ato obligime, tatime, si ai që nuk i paguan. Gjithashtu, kërkoj që të përkrahen sidomos gratë në bizneset e vogla që i kanë, të cilat gjenerojnë vende pune Normal që kërkoj të përkrahen edhe meshkujt, por në përgjithësi gratë, sepse fëmijët kërkojnë nga nënat, nga nënat kërkojnë si për ushqim, për veshmbathje, si për të gjitha detyrimet e prindit që janë ndaj fëmijës. Gjithashtu, po dua me u ndërlidhur edhe me kolegun paraparak, që thotë zonat rurale ndoshta ka raste që i kanë kushtet e mira, por është edhe tjetra, që nga zonat rurale ndodhë një familje i ka 2-3 studentë apo nxënës, i ndërrojnë nga 2-3 autobusë, dhe varet edhe nga orari i ligjëratave në fakultete, i duhet me qenë tërë ditën, i paguan dy bileta, plus edhe ushqimin, ndërsa banori i qytetit, studenti apo nxënësi, i drejtohet shtëpisë së vetë, kështu që kolegë nuk pajtohem.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Vala Peshku, në emër personal, 5 minuta.

Vala Peshku: Djem dhe çika urtë, a vazhdojmë tash?

Kështu, unë kam vërejtje tek vërejtjet që i dha z. Rifat Deri, meqenëse ai paska shkuar, por vërejtjet e tij se pika 16.4, mandej te neni 18, nënpikat e, f, g, mandej te neni 20, pikat komplet d.m.th. i paraqiti si vërejtje, të cilat nuk i lejojnë bizneset për të marrë pjesë në subvencione, e në fakt janë të qarta se në këto pika në qartësi thuhet se këto biznese nuk guxojnë të kenë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së. Në rastin që ne themi se mundemi me i dhënë subvencione organizatave të cilat kanë obligime të papaguara, atëherë çfarë mesazhi po iu dërgojmë, mundeni mos me paguar, mundeni me e thyer ligjin, dhe ne ju japim subvencione a?! Është e papranueshme, edhe nëse e ceku një arsyetim z. Deri, se janë biznese profitabile. Mirë, nëse janë profitabile, le t'i paguajnë tatimet, u krye.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Suzan Kika

Suzan Kika: Faleminderit, kryesues!

Unë desha me u ndërlidhur tek subvencionet për bujqit. Konsideroj se politikat e subvencioneve duhet ndryshuar në favor të lehtësirave sa i përket përgatitjeve të dokumentacioneve, sidomos për fushën e bujqësisë, në mënyrë që mos tua marrim kohën e çmuar të punës, të mos krijojmë tollovi para zyrave pritëse për aplikuesit. Në të njëjtën kohë, Drejtoria për Zhvillim Rural, duhet të ngre një komision verifikues, që në terren të rritet kontrolli, që mjetet e fituara të investohen për qëllimet e subvencioneve, ngase jam e bindur se ka parregullsi në këtë drejtim. P.sh. cila është logjika që një qiradhënës i tokës, krahas qirasë të merr edhe subvencione?! Për këtë do të propozoj që, aty ku ka mundësi, që të bëhet subvencionimi për njësi prodhimi. Është mirë që të ndiqet kjo praktikë, ngase do të kemi arritje pozitive, si dhe nxitje të rritjes së rendimentit, p.sh. drithërat e të ngjashme, duke aplikuar masat agroteknike intensive, dhe në të njëjtën kohë do të jemi të sigurt që subvencionimi do të jetë i drejtë dhe inkurajues për të punuar tokën.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Nol Nushi.

Nol Nushi: Faleminderit, kryesues!

Unë kam pak diskutim, te neni 14, tek subvencionet në arsim, ku një ndër pikat është këtu, bursat për studentë, është fjala me siguri për studentët që vijnë janë rezidentë në Prishtinë dhe kanë suksese të mira në fakultetet përkatëse. Mendoj se ndoshta duhet me e qit edhe një pikë që po ashtu edhe Universiteti i Prishtinës ndan bursa, edhe nëse nuk e di a është, nuk është jo korrekte po mendoj, po kishte me qenë mirë ata që marrin bursë nga Universiteti i Prishtinës, mos me e marrë këtë të Komunës, në mënyrë që Komunës me iu liruar disa vende dhe me iu dhënë atyre që nuk kanë mundur me marrë bursë në

Universitetin e Prishtinës. Po ashtu, edhe te kriteret se si merren bursat, po kufizohem këtu pak, sidomos në arsim, d.m.th. në bazë të suksesit apo jo, mendoj që ky kriteri i gjendjes ekonomike, nuk e di këtu te neni 15, a janë kriteret e radhitura sipas rëndësisë ose jo. Nëse janë sipas rëndësisë, mendoj që kriteri i gjendjes ekonomike duhet me qenë pothuajse i njëjtë me atë të notës mesatare, e ndoshta nganjëherë edhe më i lartë, sepse duhet me pasur parasysh, studentët që kanë gjendje më të mirë, ose nxënësit që kanë gjendje më të mirë ekonomike, fillimisht kanë shumë më shumë edhe me mësuar më shumë edhe me pasur kushte shumë më të mira me mësuar. Dallon ai student i cili banon këtu, qysh me thënë, nuk i ka prindërit në punë, detyrohet me punuar vetë edhe me studiuar, me e mbërri një sukses, prej atij i cili i ka krejt kushtet, d.m.th. nuk ka nevojë për me punuar edhe mundet me e mbërri suksesin pa..., (Fjala e pa përfunduar), e ka krejt kohën e ditës për me studiuar këtu. Këtu e kisha vendos njëfarë, nuk e di çfarë formule kishte mundur me u bërë, po dua me thënë që po ka studentë që e kanë notën mesatare 10.0, me kushte ekonomike shumë të mira, dhe ka student që e kanë ndoshta 9.0, por me kushte ekonomike jo të mira. Unë iu kisha dhënë përparësi këtyre me 9.0, që me mundur me i qar në 10.0, sa ata 10.0, veç janë dhe si me thënë, nuk kanë nevojën për ndihmë ekonomike, ose për këtë lloj stimulimi. Do të ishte më mirë nëse kishim mundur me e rritur mesataren e notës në përgjithësi, se sa këtë nivelin maksimal d.m.th. 10,0 ose 9.0, me i mbajtur aty ku janë, me mundur me i qitur njerëzit prej 8 në 9, prej 9 në 10, sesa me iu ndihmuar veç dhjetësheve, të cilët vijjnë zakonisht, e kam përshtypjen, nuk kam statistika, por vijjnë zakonisht prej familjeve të cilët e kanë të rregulluar gjendjen financiare. Po ashtu, tek pika 9 e kriterit, duhet pasur parasysh aftësinë e kufizuar të studentit. Nuk e di, ndoshta është ligjore kjo si term, por unë e kam megjithatë problem këtë lloj termi, me pasur parasysh aftësinë e kufizuar të studentit, d.m.th. a po dinë, kurrkush nuk kemi aftësi të pakufizuar këtu, secili i kemi disa aftësi të kufizuara, po besoj është çështje e termit ligjor.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Valbona Petrovci.

Valbona Petrovci: Faleminderit!

Është mirë që kjo rregullore do të jetë edhe në diskutim publik, sepse sigurisht se ka me pas shumë vërejtje. Ajo në çka isha fokusuar unë për momentin, është neni 24, pika e), ku bëhet fjalë për subvencionimin e manifestimeve. Unë po ju flas nga përvoja, se kam qenë parvjet, vjet në të vërtetë, në komision për ndarjen e subvencioneve, dhe kisha sugjeruar që personave fizikë të mos iu mundësohet aplikimi për organizim të manifestimeve kombëtare, atyre që janë të karakterit kombëtar dhe që janë shpenzime enorme. Unë mendoj se ato manifestime duhet të organizohen në kuadër të Komunës, d.m.th. Komuna të marrë përsipër t'i organizojë, e jo personat fizikë apo qoftë edhe këto OJQ-të. Po ashtu, një kriter i cili do të duhej të merret parasysh kur aplikohet për ekspozita, koncerte etj. etj. shumëkush prej aplikuesve kanë kërkuar d.m.th. mjete goxha të mëdha financiare, duke e mbuluar me arsyetimin se janë ftuar që të marrin pjesë nëpër ekspozita, të organizojnë koncerte nëpër vende të jashtme. Në atë rast si kusht ishte dashur të paraqitet ftesa prej

vendit të huaj, sepse çdokush mund të thotë unë jam i ftuar në Paris, a në Amerikë, apo kudo qoftë, por pa mbulesë, kështu që për mjetet financiare duhet të kihet parasysh, pra të ceket edhe ky element, në mënyrë që të jetë sa më korrekte ndarja e subvencioneve.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Faleminderit!

Besoj se ke në rregull kjo pjesa krejt çka tha Adriani, veç me një pjesë nuk u pajtova, kur kërkoi që dikush që merr brenda një viti, është e specifikuar me marrë veç një herë një subvencion. Besoj që kjo është shumë në rregull, për shkak se nuk kishte me qenë mirë që një organizatë ose një person fizik me marrë dy herë subvencione, ndërsa e dimë se ka tepër shumë aplikantë që aplikojnë me disa vite dhe mbase asnjëherë nuk e marrin një subvencion, plus ka projekte tepër të mira që bëhen prej vullnetarëve dhe asnjëherë nuk janë subvencionuar prej Komunës. Tjetra çka është e rëndësishme, çka duhet me marrë shumë parasysh Komuna, është, përveç dhënies së subvencioneve, edhe monitorimin e tyre, për shkak që e dimë se tash e sa vjet ka organizata e persona fizikë të ndryshëm, që i dinë shumë mirë këto kriteret ligjore dhe janë shumë të aftë me bërë projekte për me fituar atë subvencion, mirëpo nëse e shohim projektin me të cilin ata e fitojnë, praktikisht realizimi i atij projekti është pothuajse zero. Ka shumë raste të tilla fatkeqësisht edhe në Komunën e Prishtinës dhe besoj që këtu duhet të jetë një fokus i veçantë i Komunës tash e tutje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Adriani, replikë.

Adrian Berisha: Unë veç para se me e qitur d.m.th. personin ose organizatën primare, kisha me thënë me e qitur projektin primar, d.m.th. nëse është një projekt shumë i mirë, atëherë me i vlerësuar projektet e jo personat që po vinë. Ndoshta ashtu kishim mundur me e hequr, çka me i thënë kësaj, korrupsionin në këto subvencione, kur nuk e dinë kush po aplikon, por e këqyrë projektin, d.m.th. e sheh projektin dhe thua, ua grupi shumë i mirë, ky projekt të ecën përpara.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit!

Fiknete Bejta.

Fiknete Bejta: Desha me e sqaruar këtë punën brenda vitit. Është e rregulluar me ligj për subvencionim edhe në nivelin qendror, edhe duhet me e dalluar subvencionimin prej konkursit. Nëse kemi konkurs, atëherë mundet me fituar 10 herë dikush me një krijimtari, por këtu e kemi fjalën për subvencionim, ku bazohet në kriteret e barabarta, d.m.th. duhet me qenë të barabartë, nuk mundet me ia dhënë dhjetë herë një personit një grant ose një

subvencion, por duhet me qenë pak më të barabartë dhe më gjeneroz, d.m.th. me u përfshi më shumë qytetarë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Eman Rrahmani.

Eman Rrahmani: Te neni 16, pika 16.3, "Përfitues i subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në komunën e Prishtinës", propozoj që t'i shtohet: "... dhe që janë banorë të Prishtinës", duhet të jetë banorë i Prishtinës dhe biznesi në Prishtinë, jo veç biznesi në Prishtinë e banori të jetë prej tjetër qyteti.

.... (Jashtë mikrofonit)

Kryesuesi: Faleminderit!

OK., pra u dha sugjerimi.

Vala Peshku.

Vala Peshku: Veç pakëz, nuk mundemi me qenë diskriminues në këtë rast, jo, nuk mundesh, nëse personi juridik, se a jemi duke fol për personat fizikë, apo personat juridikë? Nëse personi juridik e ka veprimtarinë në komunën e Prishtinës, pse duhet patjetër ai me qenë banor i Prishtinës?! Qysh, ku është logjika, ose ku shkruan ligji që një person mundet me pasur veç një biznes? Po bre, ai të gjitha tatimet i paguan këtu, komunës ia paguan, për çka me qenë diskriminues në këtë rast, po nëse është person fizik, po.

Kryesuesi: OK., veç një sekondë, se këtu tash mos të shndërrohet si debat në përmbajtje, se kjo është në njëfarë mënyre, për konsulta paraprake po votohet, a ti jepet leja, për përmbajtje kemi me pasur kohë pastaj me diskutuar, secili i jep vërejtjet dhe ka me u votuar këtu si rregullore.

Vala Peshku: Po jo, por kur përmendet edhe që është biznes, nënkuptohet që është person juridik, jo fizik.

Kryesuesi: Po ideja është që propozimet po i jep secili, mandej merren propozimet dhe këtu vjen votohet si dokument, tek atëherë mundemi me.

Faleminderit shumë!

Atëherë, shkojmë me votim.

Regjia, të lutem, gati,

E votojmë Propozimvendimin për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Shkojmë me votim.

Atëherë, më 39 vota për, 0 kundër, 0 abstenime, konstatojmë se miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Shkojmë tutje.

Pika e tetë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi: A e donë dikush fjalën për me prezantuar, jo.
Atëherë GP i LDK-së.

Halim Halimi: Faleminderit, kryesues!

Zakonisht për projektpropozimet, ose projektregulloret të cilat shkojnë në konsulta publike, ne e kemi analizuar këtë, jemi për. Kemi ndoshta disa vërejtje të vogla, mirëpo të shikohet pas diskutimit publik, atëherë ne do të diskutojmë.

Ne e përkrahim.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Grupi i pavarur.

Vala Peshku.

Vala Peshku: Jo, ky është për diskutim publik, për diskutim publik është, na falni. Grupi ynë i pavarur është në parim në pajtim me Propozimvendimin për konsultat paraprake. Tash në vazhdim secili prej nesh, nëse kemi ndonjë vërejtje, ose që kanë diçka me shtuar, vazhdon secili veç e veç. Unë veç kisha me shtuar që tek neni 24, duhet me u fut si pikë shtesë, po, por që të jetë vendosja e kutive në secilin prej bizneseve, për vërejtjet e punëtorëve të atij biznesi, për respektimin e orarit të punës, kontratave të punës, pagesave e çka do që të jetë. Kjo është njëra prej vërejtjeve.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

GP i LVV-së?

Vjosa Hamiti-Krasniqi.

Vjosa Hamiti-Krasniqi: GP i LVV-së është po ashtu dakord lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

GP i PDK-së?

Leutrim Retkoceri.

Leutrim Retkoceri: GP i PDK-së në parim e përkrah. Sa i përket orareve, në njërin nen ku specifikohet te punëtorët që punojnë në ndërtimtari, besoj që gjatë konsultave publike do të futet edhe ajo se gjatë kohës së pikës së të nxehtit nuk është paraparë, është mirë me u paraparë që punëtorët në ndërtimtari të paktën me pasur prej orës 11:00 - 13:00 ose 14:00,

njëfarë pauze, ose me u futur si orar, në mënyrë që me i ruajtur, sepse e dimë që ka pas edhe në objekte ndërtimore në Prishtinë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

GP i AAK-së.

Le ta shtypi kush donë me e marrë fjalën prej grupit.

Valbona Ajeti.

Valbona Ajeti: Edhe ne GP i AAK-së, jemi për Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën tonë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

GP AKR-AA?

Sami Borovci.

Sami Borovci: Edhe ne si Grup e përkrahim propozimin e rregullores. Në të njëjtën kohë, e përshëndesim normalisht ekzekutivin, ose fillimin e punimeve për këtë rregullore. Mirëpo çka unë kisha propozuar dhe çka kisha kërkuar gjatë diskutimeve publike, përnjëmend me u përfshirë grupet e interesit që afektojnë në këtë rregullore, dhe jo me pasur ndoshta veç diskutim sipërfaqësor dhe mandej me pasur shumë vërejtje, shumë komente, mirëpo me u gjetur metoda me i përfshirë të gjitha këto grupe të cilat i afekton kjo rregullore. Ne si grup kemi identifikuar disa komente, të cilat po besoj shumë dhe po i shkojmë asaj rruge që në momentin që vjen pas diskutimit publik, me i dhënë këto propozime ose rekomandime tona.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Tash e hapim diskutimin.

Adrian Berisha.

Adrian Berisha: Unë veç kisha sugjeruar që me qenë të kujdesshëm dhe me i ftuar të gjitha palët e interesit në këto diskutime publike, d.m.th. me gjetur mënyrën më të mirë që me qenë të pranishëm të gjithë, p.sh. Shoqatën e Gastronomëve të Prishtinës, Shoqatën e Ndërtimtarëve të Prishtinës dhe të gjithë. Po ashtu, me na njoftuar edhe neve përmes e-mailit, apo sugjerim për administratën e Kuvendit që me na njoftuar edhe neve me qenë të pranishëm, për arsye se pasi që është diskutim publik, ne mundemi me i dhënë sugjerimet aty dhe nuk kemi nevojë këtu me humbur kohë.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Sokol Havolli.

Sokol Havolli: Praktikisht, kërkesa ime ishte e ngjashme me kërkesën e Adrianit, që të jemi pjesë e diskutimeve, por edhe të kemi sidomos kujdes me kafeteritë. Ata kanë pasur kërkesa, këto i kemi vërejtur edhe gjatë fushatës, edhe gjatë takimeve të rregullta me ta, që sidomos gjatë sezonit të verës, të konsiderohet madje edhe si sezon turistik, ku ata mundën me punuar deri me një orar shumë më të vonshëm sesa orari i rregullt, për shkak të një gjallërie shumë më të madhe në qytet që është gjatë asaj periudhe. Po bie pak keq edhe Komuna, edhe Inspektorati, po edhe vetë jeta e natës në qytet, kur po ndërpriten shumë herët aktivitetet, kështu që përveç konsultimeve intensive me Shoqatën e Gastronomëve, madje besoj që edhe disa prej neve në momentin që kishim me qenë të njoftuar me marrë pjesë në diskutime, kishim mundur me dhënë kontribut, se kurrëgjë-kurrëgjë, edhe ne dimë me e shijuar jetën e natës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Arbenita Murseli.

Arbenita Murseli: Pasi që ky propozimvendim do të ketë edhe konsulta paraprake në publik, unë jam e sigurt që kjo rregullore do të shqyrtohet, do të ketë supozime tjera, sugjerime, si nga bizneset, ashtu edhe nga ana e qytetarëve. Ajo që unë dua ta theksoj, është që këto rregulla të vlejné për të gjithë njësoj, si për biznese, mos të ketë privilegje vetëm për një pjesë të caktuar, ndërkaq të ketë ndëshkime vetëm për një pjesë tjetër, potencoj që Ligji i punës të vihet në pah dhe të ketë përpikmëri të zbatimit, duke i harmonizuar këtu kërkesat si nga ana e sindikatës, po ashtu edhe të menaxhmentit, e që jemi dëshmitarë se kërkesa e kësaj të parës shumë shpesh nuk zbatohen fare. Le të jetë ky një motiv shtesë për punonjësit, që puna e tyre e çmuar të shpaguhet. Kaq kisha,

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Shefqet Osmani.

Shefqet Osmani: Faleminderit, kryesues!

Mos me e zgjat shumë, unë mendoj që te neni 9, sektori ku thuhet, industria përpunuese, unë kurrkund nuk e pash këtu edhe industrinë prodhuese. Mendoj që kemi edhe industri prodhuese në komunën tonë, edhe besoj që është shumë diskriminuese në qoftë se kanë menduar në industri përpunuese, ku parashihen vetëm dy turne, a e dimë të gjithë se gjatë sezonit të verës ka nevojë edhe për tri turne. Pra, kurrkund nuk parashihet në industri qoftë përpunuese, ose prodhuese sezonale me pasur tri turne, dhe besoj që kjo do të shqyrtohet, ose do të analizohet edhe do të përmirësohet. Gjithkund i pash oraret e njëjta, kur dihet p.sh. që turni i tretë ka lehtësira si në rrymë, si në transport, si në gjithçka, besoj që do të bëhen disa korrigjime dhe do të futen te një nen i veçantë, sepse kurrkund nuk e pash që ka industri prodhuese, as nen të paraparë për industri prodhuese, kemi përpunuese, ka sektor tjerë, prodhuese nuk ka. Duke e parë industrinë përpunuese, u lidha me këtë sepse kurrkund nuk parashihet në asnjë sektor turni i tretë, ka qenë çdoherë, tash nuk është, ku është marrë për bazë kjo unë nuk e di. Kaq kisha.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Suzan Kika.

Suzan Kika: Duke e lexuar këtë material, parimisht duke e mbështetur, por unë personalisht e kam një vërejtje sa i përket kohëzgjatjes së punës për shoqëritë tregtare, hotelierit në brendinë e qytetit, ku përveç se janë parë kritere ku janë të hapura lokalet, nuk është menduar edhe aq shumë as kriteri i kohëzgjatjes së punës në hapësirën e banimit, ku qytetarët kanë nevojë të pushojnë, fëmijët, punëtorët, të moshuarit, si dhe kategoritë tjera, dhe ku janë të ekspozuar zhurmës së tepruar, për të cilën mendoj se është e rregulluar me ligj, atëherë kërkoj që nga e hëna në të premten, të kufizohet deri në orën 22:00. Po ashtu, kam një propozim që transporti furnizues duhet të kufizohet, apo të përcaktohet koha e furnizimit, ngase gjatë tërë ditës, edhe në pikën ku transporti është në dendësi maksimale, mjetet furnizuese shpeshherë janë pengesë e zhvillimit normal të transportit. Ky fakt tregon se krijohen edhe kolona, e në të njëjtën kohë kemi edhe ndotje të ambientit.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Veç desha me pyet se a ka ndonjë strategji Komuna, se qysh ka me i organizuar këto debate publike, se p.sh. e dimë është Shoqata e Gastronomëve, pra janë pronarë të dyqaneve, kështu është lehtë me i mbledhë këta, mirëpo problemi këtu dhe ky vendim ka me u marr kryesisht për punëtorët, kështu që qysh kemi me i kontaktuar kamerieret që punojnë nëpër kafe, qysh kemi me i kontaktuar punëtorët nëpër depo të ndryshme që janë në Prishtinë, që ju shkelen vazhdimisht të drejtat e punës dhe kurrkush nuk jep përgjegjësi për ta. Tek e fundit, janë ata për të cilët ne duhet të flasim dhe janë ata të cilët duhet të flasim vetë për vete dhe me na njoftuar për problemet e mëdha që i kanë, kërkoj një përgjigje prej kujtdo që është më përgjegjës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Nuk kemi dikë këtu që të na përgjigjet, po, hajde Osman.

Osman Bllaca: Pas vendimit për konsulta paraprake, kryetari e cakton tash një komision prej 5 anëtarëve, e ai komision i mban dëgjimet publike, ata në një periudhë prej 15 ditëve, e caktojnë një orar se sa dëgjime publike kanë me i organizuar. Varësisht tash nga natyra e rregullores ose veprimtarisë që bëhet në kuadër të asaj rregulloreje dhe thirren. Në këtë rast që po kërkon ju, është se ne i shpallim ato çka i kemi me ligj në ueb-faqen e Komunës, në vendet më të frekuentuara, dhe kudo që përcaktohen edhe me rregullore tjera, por në këtë rast i thërrasim edhe sindikatat që janë përkatëse të asaj veprimtarie, qysh është ajo prodhuese, që e përmendi ai të ujërave, pasi që e njoh, ose Shoqatën e taksive, ose varësisht çfarëdo që është rregullorja. Tash, në këtë rast të këtyre që e patëm

më herët rregulloren për ndarjen e subvencioneve, i ftojme edhe grupet e interesit të cilat kanë me u përfshirë në atë rregullore, pastaj ata i marrin vërejtjet, sugjerimet dhe çka do që dalin prej atyre dëgjimeve dhe i inkorporojnë. Veç të jemi shumë të sigurtë, që pak marrin pjesë në diskutime publike, sidomos ato që e kanë interesin e që i prekë më së shumti.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Leutrim Retkoceri.

Leutrim Retkoceri: Unë edhe njëherë sa i përket rregullores, përveç pikës 11, te ndërtimtaria e pata, edhe një pikë të diskutimit te neni apo te pika 10, sektori "e", është furnizimi me ujë, kanalizim, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave. Te kjo besoj që regjistrohet diku këtë që po e diskutojmë, mirëpo orari është prej orës 00:00-24:00, pra pa ndërprerë. Grumbullimi i mbeturinave vetëm këtu në qendër kur ndodhë prej këtyre kamionëve që i marrin kontejnerët, dinë me u krijuar rrëmujë e madhe në trafik, dhe për këtë e kisha lënë një kohë të caktuar pas orës 24:00. Ne e dimë në çfarë gjendje është menaxhimi i mbeturinave në kryeqytet, mirëpo ta lëmë në një kohë ku nuk i pengojnë qytetarët, nuk e pengojnë komunikacionin, edhe era nuk kundërmon kur ka lëvizje të madhe të qytetarëve, këtë kisha pas qejf me e pas parasysh. Ndërsa pika tjetër, po besoj tek veprimtaritë e kafeterive dhe jetës së natës, sigurisht që duhet me i kushtuar rëndësi të veçantë, pasi që kjo krijon të hyra të mëdha për kryeqytetin. Kaq pata.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Sami Borovci.

Sami Borovci: Jam deklaruar në emër të grupit, nuk u lëshuam ne në komente dhe detaje, mirëpo meqenëse veç u filluan këto prej pjesëmarrësve, i kam dy komente. Realisht, u nxita prej fjalës së zonjës Suzan Kika, me u pajtuar në konstatimin, ose në propozimin e saj që furnizimi me u rregulluar përnjëmend orari i lokaleve që furnizohen, sepse po krijojnë një kaos ndoshta në trafik, mirëpo në të njëjtën kohë me e kundërshtuar propozimin e saj, ose me jap mendimin tim kundër idesë që orari i kafeterive, ose i shërbimeve të gastronomisë me u kufizuar deri në orën 22:00, madje unë propozoj që ky orar me u zgatur edhe përtej kësaj rregulloreje veçanërisht në periudhën e verës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Drilon Pireva.

Drilon Pireva: Unë shumë shkurt desha me diskutuar, d.m.th. te kriteret për punën e caktimit të orarit, ishte dashur me e pasur parasysh vendin ku do të ndodhet veprimtaria, dhe koha, po mendoj kështu, që përveç që është i ndarë sezoni, është dashur me qenë

edhe për çfarë periudhe kohore ka për të ndodhur ajo. Unë kështu mendoj, që në bazë të këtyre kritereve është dashur me qenë edhe këto.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Naime Osmani.

Naime Osmani: Unë veç një pyetje e pata, te neni 7, Sektori a) bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, d.m.th. te fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të pylltarisë dhe prerja e druve, periudha verore prej orës 8:00-20:00, periudha dimërore prej orës 8:00-18:00. A është periudhë kohore kur prehen drutë në male, nëpër punëtori, apo në industrinë prodhuese? Këtë desha me thënë, duke e ditur që pyjet e kanë edhe njëfarë periudhe kohore kur prehen, si p.sh. në pranverë herët, pa u gjelbëruar, dhe dikur kah vjeshta.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Nol Nushi.

Nol Nushi: U nxita disa herë me diskutuar, por kam përshtypjen që ndoshta prej qejfit për me bërë përmirësime, plotë prej propozimeve nuk janë hiq pjesë e kësaj rregulloreje, kjo është shumë specifike, d.m.th. është veç për orarin e punës së një veprimtarie ekonomike qoftë kafe, qoftë dyqan, qoftë fabrikë ose diçka tjetër. Ndoshta prej diskutimeve vjen ideja që përnjëmend duhet me i saktësuar ndoshta rregullore të tjera, p.sh. se si Komuna mundet me i kushtëzuar, nuk e di sa është ligjore kjo, por p.sh. kompanitë e ndërtimit që marrin leje në Komunë me qenë të detyruara me i pas punëtorët e regjistruar në Trust Pensional ose punëtorë me kontrata pune. Kafenetë që marrin leje afariste, me pasur stafin e saj, e kafenesë ose kafiçit, ose çfarëdo veprimtarie hoteliere, me i pasur të regjistruar me kontrata pune. E kam përshtypjen se kjo është katastrofale. Deri tash asnjë punëtorë i këtij sektori, po e them asnjë, po e përgjithësoj, por 90% e punëtorëve të këtij sektori nuk kanë kontrata pune, 90% e punëtorëve të sektorit ndërtimor nuk kanë kontrata pune, edhe përgjithësisht, sidomos nëpër dyqane që kanë punëtorë shitës ose shitëse, nuk kanë kontrata pune, paguhen me kesh dhe bëjnë punë mjaftë të rëndë edhe jashtë orarit. Nuk e di, këtu e di që futet tash Inspektorati i Punës, vijnë kompetenca tjera, që ndoshta nuk janë të këtij niveli, po kish qenë detyrë e jona që me i maksimalizuar mundësitë brenda këtyre kompetencave që i kemi, që me pasur mundësi me ua përmirësuar edhe kushtet e punës, mirëpo edhe me pasur mundësi me e rregulluar sa më shumë këtë sistem. Edhe këto transportin kur bëhet furnizimi p.sh. i lokaleve, nuk është pjesë e kësaj rregulloreje, ne mundemi me propozuar këtu po këtu qartë është vetëm orari i punës, jo orari kur e bën transportin, ose p.sh. mbetjet qysh thamë më parë për gjellëtoren "Nazi", nuk janë veç gjellëtoret, janë mishtoret, janë një sërë aktiviteteve tjera që kanë mbetje, ose mbeturina gjatë ditës, për të cilat nuk ka një rregullativë se si të trajtohen. Kështu që prej këtij diskutimi mendoj se mundën me dalë edhe dy-tri rregullore tjera, për të cilat ne ish dashur që përgjatë mandatit të punës që e kemi, me i definuar dhe me i saktësuar sa më shumë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!
Rifat Deri.

Rifat Deri: Faleminderit!

Unë duke e shfletuar këtë propozimrregullore për zgjatjen e orarit të punës, e pash këtu në nenin 20.3, që për çdo orë të zgjatur të punës, p.sh. Sektori i minierave, 20 euro, Industria përpunuese, 20 euro për çdo orë, besoj se, mendoj se është tepër shumë, duhet me e gjetur ndonjë modus pak më të lehtë, për mos me i ngarkuar kaq shumë për çdo orë të zgjatur të orarit punës. Besoj që për këtë duhet edhe gjatë bisedave me shoqata, ose këta të tjerët, besoj që kemi me ra në ujdi me ta. Sa i përket kësaj për furnizimit me mall që bëhet kohë pa kohë nëpër qytet, herën e kaluar unë e kam paraqitur këtë pyetje, dhe drejtori Muhedin Nushi, më tha se janë duke punuar në këtë rregullore, besoj që shumë shpejtë edhe ajo do të na vjen, e do të çlirohet Prishtina prej këtij furnizimi kaotik, i cili bëhet çdo ditë dhe pengon komunikacionin.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Atëherë nuk kemi tjera diskutime.
Lus regjinë të përgatitet për votim.
Votojmë tash.

Atëherë, me 33 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim, konstatojmë se miratohet Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Shkojmë tutje.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Kryesuesi: Fjalën e ka drejtori Genc Bashota.

Genc Bashota: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, Sektori i mjedisit, i cili është në Drejtorinë e Planifikimit, po ju shpjegoj shkurt, kur një palë kërkon leje mjedisore, e cila është e fundit në kuadër të lejes ndërtimore, është dokumenti i fundit para se me e marrë lejen finale, atëherë ata i përmbushin të gjitha kriteret dhe në fund, nëse objekti i ka 450 m² e më shumë bazë, apo 1500 e më shumë m² ndërtim, i nënshtrohet pagesës prej 0.2% të vlerës investive, kjo është rregullorja. Mirëpo atë 0.2% ne e përcaktojmë në bazë të një paramase e paralogarie që pala e bien në Komunë, aty ka shumë çmime që janë duke i pru edhe ulët, unë edhe nuk

Faqe 77 nga 93

jam ekspert i përcaktimit të tyre, por doja edhe me e shmangur pak një hapësirë kur dikush vjen me një çmim që nuk është i pranueshëm, por edhe ligjërisht nuk mundem me i thënë rrite as zvogëlo, kështu që e kemi menduar me e bërë një rregullore që e përcakton një vlerë referente. Do të thotë, nëse metri katror, në këtë rast ekspertët e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, përfshirë edhe këta zyrtarët tanë, e kemi krijuar një komision dhe thonë që vlera investive le të jetë 300 euro për metër katror për objekte afariste, atëherë edhe zyrtari obligohet që atë 0.2% me e llogaritur në këtë vlerë, për arsye se po na vijnë paramasa e parallogari qesharake, me 120, 150 euro metri katror, edhe nuk kemi mundësi me e detyruar për me paguar më lart. E dyta, sa është ajo më larta, kështu që ky është interesi që Komuna me inkasuar diçka çka është realisht që i takon me e inkasuar e, në anën tjetër, as investitorin nuk besoj që e dëmtojmë, sepse duhet me u referuar pak a shumë në një lloj kalkulimi që është në treg, pra çmimet mesatare të tregut, kjo është ideja e kësaj rregulloreje.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!
Shkojmë me radhë me GP.
LDK-ja.

Halim Halimi: E njëjta gjë vlen edhe për këtë rregullore. Ne e kemi analizuar me që shkon në diskutim publik, mblidhen vërejtjen dhe sugjerimet, edhe ne parimisht jemi për miratimin e këtij vendimi, që të shkon kjo projektregullore në konsulta publike.

Kryesuesi: Faleminderit, shumë!
Nga Grupi i pavarur.

Vjosa Hamiti-Krasniqi: Faleminderit, kryesues!
Grupi i pavarur e përkrah vendimin për dërgim në konsulta paraprake publike të kësaj rregulloreje.

Kryesuesi: Faleminderit, shumë!
LVV-ja.

Vala Peshku: LVV-ja po ashtu e përkrah këtë propozim për konsulta paraprake publike lidhur me këtë rregullore.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
PDK-ja.

Florida Canolli: Ne si grup në parim e përkrahim këtë pikë.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
AAK-ja.

Valbona Ajeti: Edhe grupi ynë e përkrah Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projekteve të ndërtesave për pikën e tarifës për leje mjedisore komunale.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
AKR-AA.

Vesel Makolli: Edhe ne e përkrahim.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!
Diskutues po e shoh që nuk ka.
E hap diskutimin.
A ka dikush për të diskutuar!
Atëherë shkojmë me votim.
Regjia, gati.
Shkojmë tash.

Atëherë, 35 vota janë për, 0 kundër, 0 abstenime. Konstatohet se miratohet Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, më falni se e lexova gabim, Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Shkojmë tutje.

Pika e dhjetë

Diskutim rreth punimeve në sheshin "Adem Jashari".

Kryesuesi: Atëherë, vazhdojmë me shefat e GP-ve.
Halim Halimi.

Halim Halimi: Meqë kjo pikë e rendit të ditës hyri tash, ne nuk e kemi diskutuar, nuk jemi kundër, d.m.th. ishte për vendosjen e shtatores së Adem Jasharit, larg asaj, d.m.th. nuk besoj që dikush është kundër, mirëpo duke e pas parasysh që prej ekzekutivit nuk e kemi po mendoj drejtorin e Urbanizmit dhe nuk jemi as të përgatitur, por ne si LDK jemi për, d.m.th. për me u vendosur shtatorja e Adem Jasharit aty, e tash a ka pengesa, a nuk ka pengesa, është detyrë e ekzekutivit, le t'i sqarojë këto çështje. Ne jemi pro.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Atëherë, unë, realisht kjo nëse do të duhej të ishte si pikë e rendit të ditës, do të duhej të ishte një seancë ndoshta e zakonshme, të përgatitet, të futet në rend të ditës, të ftohen prej ekzekutivit, por duke qenë se kërkuan të futet në rend të ditës, unë e kam për obligim ta bëjë një propozim. Urdhëro, po, do të thotë proceduralisht unë isha i pafuqishëm, sepse

nuk, për hir të debatit, unë mendoj që më mirë ka qenë me u diskutuar, por tash kjo është futur si pikë e rendit të ditës.

Atëherë, të lutem, PDK-ja si propozues, le ta merr fjalën.

Migjen Shala.

Migjen Shala: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje, kolegë!

Ky shesh e ka marrë emrin nga kjo Asamble, në vitin 2005. Ky shesh asokohe kur e ka marrë emrin, e ka marrë edhe sheshi "Ibrahim Rugova", sheshi "Adem Jashari" ka mbet i pa rregulluar edhe pa shtatore. Unë mendoj, edhe ne si grup mendojmë që ky shesh është i vogël për me u quajtur "Adem Jashari". Adem Jashari është vetë emblema e UÇK-së, nuk është bë, nuk është bë nga pushteti i LDK-së, nga pushteti i LVV-së, kanë filluar tash punimet. Unë nuk e di si mundet me u quajtur ky shesh sheshi "Adem Jashari", kur aty është një monument që simbolizon bashkim-vëllazërimin e ish-komunizmit, prej hekurit dhe betonit. Ne mendojmë që janë dy rrugë këtu, ose t'i hiqet këtij sheshi emri i Adem Jasharit e të rivendoset diku tjetër, ose të hiqet ky monument prej hekuri dhe betoni. Këtu janë dy rrugë të kundërta. Unë me sa kam informacione, kjo nuk është në mbrojtjen e UNESCO-së ky objekt, edhe nuk na pengon neve me u heq dhe me u qit shtatorja e Adem Jasharit. Asnjë shesh nuk mundet me u quajtur Adem Jashari, ose sheshi Zahir Pajaziti, ose Ibrahim Rugova, ose ku ta di unë, pa shtatore. Mirëpo këtu për çudi, në krejt Kosovën, në çdo qytet është vendosur shtatorja dhe sheshi Adem Jashari, në Prishtinë jo, kështu që ne kërkojmë që ose t'i heqet këtij sheshi emri Adem Jashari, të zgjidhet një shesh tjetër. Nëse nuk është mundësia për me u hequr, nëse e pengon dikën, ose të hiqet ai monument prej betoni. Kaq pata dhe kërkoj ndihmën e të gjithëve, pavarësisht partive politike që jemi këtu, flamujve politikë, kjo është diçka tjetër, kjo nuk mundet me u quajtur, kjo është diçka e kundërt, unë nuk e di qysh ka mbetur deri më sot, dhe qysh kolegët e mi të PDK-së, dhe të LDK-së, asokohe, në vitin 2005, e kanë votuar këtë shesh që simbolizon bashkim-vëllazërimin, ish-komunizmin, me u quajtur sheshi "Adem Jashari" pa u rrëzuar ai monument.

Kaq pata.

Kryesuesi: Faleminderit!

Drejtori deshi përgjigje.

Yll Rugova: Kështu, unë veç kisha dashur me bërë një sqarim lidhur me këtë pikë. Ky monument që është tash këtu, njihet me emrin "Monumenti i lirisë" dhe është projektuar diku në vitin 1957, për të japë memorien ndaj luftës kundër nacizmit në Evropë. Pra, ka qenë monument për me e përkujtuar luftën, d.m.th. përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. Tash këtu duhet një informatë shtesë me e dhënë. Sheshi e ka pasur "Vëllazërim-Bashkimi" dhe emri i sheshit ka ndryshuar në sheshin "Adem Jashari" që për mua është në rregull, por monumenti vazhdon të mbetet monument i lirisë, që e përkujton përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. Tash ky mundet me qenë një diskutim tjetër i ri, çështja që nëse ne dëshirojmë, apo mendojmë ta kemi një shesh tjetër me emrin Adem Jashari, një shesh që ndoshta është më i mirë, më i denjë, madje unë po pajtohem

me juve, po pajtohem që është mirë me pasur edhe një memorial të ri për Adem Jasharin diku në Prishtinë, që do të jetë në një vend të denjë për këtë figurë, por deri atëherë besoj që nuk është shumë problematike nëse mbetet monumenti i lirisë dhe Adem Jashari si emër i sheshit në një vend, derisa ta gjejmë një lokacion të ri për këtë. Përndryshe, duhet ta kemi parasysh që në qytet, jo veç në Prishtinë, por në të gjitha qytetet nëpër botë, monumentet të cilat shënjojnë periudha të caktuara, nëse shënjojnë arkitekturë të caktuar, ato janë njëfarë lloj vlere për qytetin. Nëse aty monumenti kish me qenë shtatorja e Josip Broz Titos, apo shtatorja e Stalinit, atëherë unë besoj që po, kishte me qenë shumë e arsyeshme që të kërkohet zhvendosja. Pra, aty kemi të bëjmë me një monument abstrakt, i cili e shënjon një moment të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, që besoj se është vlerë e çmuar për qytetin e Prishtinës.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Në rregull.

Atëherë, fjalën e ka Egzon Azemi.

Egzon Azemi: Faleminderit!

E rëndësishme është që sa më parë të ndërtohet shtatorja e Komandantit Legjendar, Adem Jashari. Unë, personalisht, mendoj që është mirë pikërisht këtu me u ndërtuar, jo për shkak që është ajo përmendore, po pikërisht se është një ndër pjesët më të rëndësishme të kryeqytetit, është vend me rëndësi të veçantë, është në mes të Komunës dhe Kuvendit të Kosovës, dy institucioneve pothuajse kryesore në kryeqytet, kështu që besoj që është e udhës që shtatorja e heroit Adem Jashari, të vendoset pikërisht te ky shesh afër Komunës. Sa i përket, e sqaroi mjaft mirë Ylli, ai është një monument i cili nuk quhet i vëllazërim-bashkimit, është quajtur fillimisht Monument i lirisë. E rëndësishme është që të mos neglizhohet më shumë ky shesh dhe sa më parë të përfundoj shtatorja, kaq. Edhe diçka, më fal kryesues, e rëndësishme është edhe një send me u përmend. Gjatë fotografimeve dhe planit kur fillimisht është ndërtuar ky shesh, pra gjatë periudhës së kaluar, aty shihet që ka ekzistuar edhe një pistë e improvizuar për zbarkim të helikopterëve, për shkak që edhe nuk ka këso pista tjera në Prishtinë. Pra, këtë pyetje desha me ia bërë dikujt, pikërisht këtu te sheshi ka ekzistuar, shihet prej fotografimit nga lart që ka ekzistuar një hapësirë e tillë që ka qenë për zbarkimin e helikopterëve, edhe desha me i pyet organet kompetente që a do të ekzistoj kjo edhe në planin e ri, apo jo?

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, nuk është dikush.

Po, Gëzim Mehmeti.

Gëzim Mehmeti: Do të thotë, Egzon, tash ne nuk e dimë ku ka qenë i vendosur aerodromi për helikopterë, po nuk është paraparë në projektin e ri. Do të thotë, këtu e keni projektin, nuk është i paraparë, do të thotë nëse dëshironi disa informata rreth sheshit, mundem me ua dhënë, nëse jo, herën tjetër. Pra, është paraparë vlera e kontratës, është diku rreth 311 mijë e 850 euro, 90 ditë pune, punimet e demolimit do të jenë, do të thotë do të jenë diku përafërsisht, pllakat ndërrohen, 3450 m², vendoset mermer.

Shtatorja, kështu do të thotë ne nuk e prekim këtë Monumentin e lirisë dhe është, po, dëgjomë, ne po flasim, nuk mundën me marrë vendim Investimet Kapitale për shtatore, të lutem. Unë po flas veç çka ka në projekt, dhe unë personalisht mendoj se duhet me qenë një shesh tjetër me shtatore, ndoshta më i denjë, ky është mendimi im.

Kryesuesi: Faleminderit!
Drejtori, Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj: Kërkesa e asamblistit Migjen Shala është shumë e qartë, por ne duhet me e pasur parasysh që Shtatorja e lirisë, e ashtuquajtur, dhe shtatorja “Adem Jashari”, nuk shkojnë në një vend, janë dy periudha të ndryshme, që nuk kanë të bëjnë shumë me njëra tjetrën. Sheshi “Adem Jashari” dhe sheshi “Vëllazërim-Bashkim” nuk shkojnë në një vend, por është një vendim i kësaj Asambleje, i legjislacionit të kaluar, që ky shesh është emëruar sheshi “Adem Jashari”. Andaj, ne e kemi për obligim që ta zbatojmë këtë vendim derisa nuk e ndërrojmë, aty duhet të vendoset shtatorja e Adem Jasharit, me vetë faktin që ky objekt i lirisë apo i çlirimit nuk është i mbrojtur me ndonjë konventë ndërkombëtare. Unë mendoj që edhe me e rrëzuar nuk prish punë, dhe me u vendosur shtatorja. Ka vende të tjera këtu në Kosovë që simbolizojnë simbolet e Luftës Nacionalçlirimtare, p.sh. e kemi përmendoren te Varrezat e Dëshmorëve, nuk besoj që duhet me pasur shumë të tjera, nuk shkojnë. Jo, këto janë tema tjera, se nuk po hyj në atë se kishat ortodokse kanë qenë tonat, të shqiptarëve ortodoksë, por ne nuk i kemi mbrojtur, është pjesë tjetër ajo, e vazhdojmë atë debat kur të doni, por sot këtu në sheshin Adem Jashari duhet me qenë Adem Jashari, nuk prishim punë me e heq atë simbol, sepse Lufta e Dytë Botërore nuk ka përfunduar në këtë shesh, edhe nuk ka kurrfarë simbolike kjo punë, kaq.

Kryesuesi: Faleminderit!
Ylli e ka fjalën.

Yll Rugova: Kisha dashur veç edhe diçka me shtuar. Nëse ka qenë ndonjë veçori shumë e dëmshme në kohën që e njohim si koha e socializmit, apo modernizmit, apo qysh do që e quajmë, ka qenë kjo ideja që duhet ta shkatërrojmë të vjetrën dhe duhet ta ndërtojmë të renë. Unë po besoj që kjo praktikë tash me neve duhet të ndryshojë. Qytetet gjithkund në botë i ruajnë periudhat edhe shtresat e ndryshme të historisë. Ne në qytetin tonë kemi objekte të kohës otomane, megjithëse otomanët kanë qenë pushtues, besoj që pajtoheni, por ne i ruajmë ato objekte, sepse, megjithatë janë vlerë e trashëgimisë kulturore. Në këtë kontekst, ne ende nuk jemi në UNESKO, do të thotë ka pas votim për këtë punë, nuk jemi në UNESKO, andaj asnjë objekt në Kosovë në përjashtim të objekteve ortodokse serbe, të cilat i ka mbrojtur shteti serb, ne nuk i kemi asnjë objekt në mbrojtje të UNESKO-së, por për t’u futur në UNESKO, ne duhet të tregojmë maturi për gjëra të tilla. Duhet, edhe pse nuk jemi në UNESKO, ta mbrojmë trashëgiminë tonë e çfarëdo periudhe që është, derisa është trashëgimi që e mbron një vlerë të caktuar. Kështu që unë po besoj që prapë vlerë shumë e madhe është Adem Jashari, unë po besoj që Adem Jashari padyshim që duhet ta ketë një monument madhështor, në të cilin ne i tregojmë vlerat e sotme në atë monument,

por atë duhet ta bëjmë në një lokacion tjetër, apo ta gjejmë një modalitet tjetër të veprimit, ku mund të integrohen të gjitha bashkë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Adrian Berisha.

Adrian Berisha: Unë pajtohem me Yllin plotësisht, ne si shoqëri duhet me ditur që duhet ta ruajmë memorien kolektive, d.m.th. Prishtina nuk njihet që ka ndonjë trashëgimi kulturore që me thënë me u krenuar edhe kish me qenë shumë e rëndësishme me e ruajtur si monument. Për ata që nuk e dinë në vendin ku ndodhet Zahir Pajaziti, kanë qenë të vendosura xhamia, kisha dhe sinagoga. Çka ka ndodh aty? Ka ardhur pushtimi, që të tria kanë qenë, hyni këqyrni edhe e shihni që e kam shumë mirë, d.m.th. ka ardhur pushtimi fashist dhe i ka rrënuar ato. Paramendojeni nëse ne tash në këtë periudhë do t'i kishim pasur ato të tria, pra kishim pas shumë mundësi edhe turistët çka me pa. Te ne turistët nuk kanë çka të shohin. D.m.th., unë kisha propozuar që ky Kuvend të marrë vendim që të gjendet një lokacion dhe të quhet sheshi "Adem Jashari. Pra, kemi mundësi, besoj që kishim mundur me gjetur, kishim mundur, sa i përket bustit kishim mundur edhe me e vendos në Pallatin e Rinisë, apo d.m.th. që quhet edhe Adem Jashari. Ne mundemi d.m.th. me gjetur, por unë jam plotësisht kundër që me e rrënuar ose me e zhvendos Monumentin e lirisë, dhe kisha sugjeruar që ky shesh me u quajtur Sheshi i lirisë, me ju kthyer emri kish me qenë mirë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Nol Nushi.

Nol Nushi: Mendoj që jemi ngutur kur e kemi futur këtë pikë në rend të ditës, sepse asambleja nuk jam i sigurt që duhet me diskutuar për çështje, tash detaje, të projektit ku me vendos një shtatore, çfarë ngjyre, sa e madhe, sa e vogël, këto nuk janë çështje të asamblesë, këto janë më shumë çështje, neve na vjen një propozim këtu, nëse është për votim ai propozim, e votojmë ose jo, por e kam përshtypjen se ai projekt nuk vjen as në asamble hiq. Thjesht, Komuna e ekzekuton, edhe nëse është i mirë ka me i marr votat, nëse nuk është i mirë nuk ka me i marrë votat në zgjedhje, e asambleja ka shumë pak kompetencë këtu, bile nuk duhet me diskutuar hiq për këso çështje, se kjo nëse mundem me ...(Fjala nuk kuptohet) është gati njësojë si me thënë hajde ta diskutojmë edhe rregullimin e shkallëve të Dragodanit. Është asi projekti investiv, është Sheshi "Adem Jashari" aktualisht, jo si projekt investiv është ky, kurrkund nuk shkruan aty që ka me pasur bust ose diçka. Ky është rregullim i një sheshi të Prishtinës, çka është çështja? Çka është çështja? Jo, jo, mirë, mirë Leutrim, a bënë ta kryej? Replikom, mirë.

Kryesuesi: Leutrim, Leutrim, të lutem!

Nol, të lutem fokusohu në diskutim.

Nol Nushi: Prishtina ka nevojë për një bust ose një muze, qysh tha Ylli, monument i cili përfaqëson, i tregon shumë mirë vlerat e luftës, sepse kur vjen në Prishtinë nuk ke shumë, janë shtatorët, por nuk mundesh me mësuar veç prej shtatoreve çka ka ndodhur në Kosovë në luftën e fundit. Mendoj që si pjesë e një memorialit të UÇK-së në Prishtinë, që kish qenë pikë shumë prioritare turistike, kish mundur me u përfshirë edhe shtatorja e Adem Jasharit, edhe krejt historia e luftës së fundit. Dhe kjo, se aty ka qenë objekt jugosllav, e tash është emri i Adem Jasharit, mua bash po më duket tregues qysh ka shkuar historia, ka qenë Jugosllavia këtu edhe sot e mban emrin e një simboli të luftës tonë për çlirim dhe, rrjedhimisht ne jemi çliruar, për atë e ka emrin Adem Jashari aty. Nëse këqyrim kështu, Qeveria e Kosovës është në një objekt jugosllav, Policia e Kosovës është në objekt të SUP-it, pra aty ku janë rrah shqiptarët, nuk i kemi rrëzuar këto objekte. Fakti që sot ne jemi në ato objekte si shtet, është fitore ndaj atij sistemi edhe është problem me bë me i rrëzuar, kështu me kap këtë logjikë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj: Ju kisha lut, unë veç pak, ne nuk duhet të bëjmë këso krahasimesh. Nëse ne e kemi ruajtur trashëgiminë otomane, ato kanë qenë hamame, xhamia e gjëra tjera, nuk është ndërtuar asnjë përmendore e Turqisë këtu në emër të çlirimit, ose në emër të diçkasë. Unë ju them që këto simbolet, Nol, simbolet e komunizmit për dike janë të dhimbshme, e për dike ndoshta nuk janë të dhimbshme. Simbolet e komunizmit, shumica e shqiptarëve kanë përjetuar tmerr, vrasje, nuk e besoj që në asnjë luftë nuk ka pasur më shumë viktime shqiptar sesa lufta e komunizmit. Jo, tu kisha lutur, është problem tjetër ai, nuk po flas për Aushvicin, po flas për shqiptarë, unë e kam pas të njëjtën.

Kryesuesi: Ju lutem, t'i përmbahemi diskutimit, ju lutem, se kem secili diçka me thënë, por t'i përmbahemi.

Brahim Mehmetaj: Pa marrë parasysh, ju i dini viktimat e Tivarit sa shqiptarë janë vrarë, edhe këtu t'u kisha lutur, është e njëjshme kjo, për atë arsye po them për dike është e dhimbshme, për dike jo. Unë me pasur mundësi e zhduki, dhe jo veç këtë, sepse babagyshi im është i vrarë, Shefki Gashit iu kanë vrarë një numër i madhe i familjarëve, dhe shumë anëtarëve këtu ju kanë vrarë familjarët prej atij simboli aty, kështu që kjo është e ndjeshme.

Kryesuesi: Faleminderit!

Migjen Shala.

Migjen Shala: Kolegë, a bënë veç pak? Shikoni, na shumë mirë që e propozuam për rend të ditës, dhe propozova, thash që nëse nuk mundemi me e hequr këtë, ta marrim një shesh tjetër, shumë e qartë është kjo. Ky monument me u quajtur sheshi "Adem Jashari", nuk mundet me u quajtur, te ky monument përball tij me u vendos shtatorja e Adem

Jasharit, luftëtarët e UÇK-së nuk lejojnë, nuk ka me u gjuajtur ajo me ve, shtatorja e Adem Jasharit nuk lejohet me u qitur aty nga luftëtarët e UÇK-së derisa është ky monument. Por, nëse nuk ka zgjidhje, nuk kemi rrugë ligjore ne me e hequr këtë monument, e gjejmë një shesh tjetër. Edhe për këtë shesh ka folur kjo asamble, ti zotëri, koleg, që dhe nuk e flasim ne, nuk e kemi ne veç me votuar me ja bërë qejfin kryetarëve ose njerëzve e shoqatave të ndryshme. Jo, nuk ka shesh, çdo shesh duhet me e pasur shtatoren e vetë, të lutem, veç pak. A e ke Sheshin “Zahir Pajaziti”, ngadalë, ma more, se ndal, shiko,

Kryesuesi: Noli, Noli, veç pak.

Migjen Shala: Koleg, unë dhe Bimi, ne jemi profesionistë në këtë drejtim, se sa vjet merremi me organizata të dala nga lufta me këtë çështje, a po kupton, ne e dimë çka është sheshi, ne e dimë çka është shtatorja, e vetmja është Prishtina qe 20 vjet po bëhet që ka përfunduar lufta, nuk ka shtatore të Adem Jasharit, edhe ia vlen me biseduar edhe 10 ditë të tëra për sheshin dhe shtatoren e Adem Jasharit, po nëse nuk kemi zgjidhje, ta gjejmë një shesh të mirë dhe ta quajmë Adem Jashari, dhe ta vendosim shtatoren e Adem Jasharit. Sepse ky monument i ish një sistemi tjetër në këtë sistemin e luftës të UÇK-së, që i ka pri Adem Jashari, nuk ka të bëjë, janë dy kahe të kundërta, a po kupton? Edhe këtu kanë hyrë bagerat me punuar, ne normal që duhet të bisedojmë, për këtë punë na i kemi marrë votat me bisedu për probleme, për gropa, për të gjitha ato. Unë po e shpreh edhe mllefin e luftëtarëve, sinqerisht po e them, se nuk lejojnë me u qitur shtatorja e Adem Jasharit, nuk duam me pas konflikte, nuk jemi të interesuar me pasur konflikte me u gjuajtur me ve, me gurë e me revole, a ku ta di unë. Shtatore të Adem Jasharit pranë atij monumenti nuk lejojnë luftëtarët me u vendosur, o zotëri, se janë dy regjime, dy kahe të kundërta. Ne dikush këtu e kemi larë në mënyra të ndryshme këtë punë, nuk do të thotë që ju se keni larë pse jeni parti tjetër, por ndryshe i përjetojmë, shkurt, jo me i përjetuar njëjtë, ndoshta nuk kishe diskutuar ti ashtu. Kaq pata.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Leutrim Retkoceri.

Adrian, Adrian, veç, të lutem, të jemi korrekt me rregullore.

Regjia, në rregull, vazhdo Leutrim.

Leutrim Retkoceri: Pasi që jemi edhe në pikën e fundit të rendit të ditës, mirëpo nuk është e fundit për kah rëndësia, unë e ndjeva të nevojshme dhe obligim me dal këtu para foltores. I nderuari kryesues, unë e kamë këtu një fjalim që e kam përgatitur mu në 20 vjetorin e rënies së familjes së Adem Jasharit, dhe po e ndej të nevojshme me ua rikujtuar disave prej kolegëve këtu.

20 vite më parë, familja Jashari përcaktoi fatin e vendit, duke flijuar jetën e tyre, komandanti Adem Jashari dha shembullin më sublim se si qohet përpara amaneti i të parëve, për t’u flijuar për lirinë e vendit tonë. Flijimi i familjes Jashari sqaroi të gjitha dilemat se rruga e vetme për çlirimin e vendit tonë është lufta e UÇK-së, ani pse unë dhe bashkëmoshatarët e mi 20 vite më parë ishim fëmijë, komandanti Adem Jashari dhe ushtarët e UÇK-së ishin engjëjt tanë mbrojtës që neve sot na mundësohet që të jetojmë e të

ëndërrojmë të lirë. 20 vite pas rënies së heroit Adem Jashari, kryeqyteti ynë, Prishtina, ende nuk ka shtatore të heroit Adem Jashari. Shtatore ka vendosur Tirana, e besa do të vendos edhe Shkupi, derisa ish-kryetarët dhe kryetarët e tanishëm të Prishtinës, fshihen pas arsyeve të kota për mos përmbushjen e këtij obligimi moral e atdhetar. Për shkak të rëndësisë historike të shtatores Adem Jashari, nuk meriton që kjo asamble sot të ndahet në atë se a duhet të vendoset, apo jo, diskutimi më i mirë dhe më i sigurtë do të na bënte nderë pikësëpari neve këtu si kolegë asamblistë dhe pastaj ta përmbushim këtë obligim. Unë e pash këtu se për disa sheshi "Adem Jashari" është mirë kur ju ka vendos emri, është mirë kur është premtuar se do të vendoset shtatorja "Adem Jashari", mirëpo ky premtim është sot ende në mjegull, nuk dihet se a do të vendoset, apo nuk do të vendoset. Nuk është hera e parë që heronjtë manipulohen politikisht duke ju vendos emrat nëpër sheshe, kur vjen puna te shtatoret kemi dilema të ndryshme. Adrian, po të drejtohem edhe ty, nuk mundesh me pasur ti mocionin e njëjtë si ne, as ne si ti, për ty ai simbol këtu në këtë shesh është simbol i lirisë, mirëpo nëse e cilëson Jugosllavinë si liri për shqiptarët, unë të garantoj që nuk është. Jemi moshatar afërsisht, mirëpo me këtë pohim tëndin ti tregon shumë gjëra. Unë e them edhe një, ne jemi pse sot duhet me i ruajtur shtatoret e Jugosllavisë, dhe shtatoret e lirisë, si e thotë edhe drejtori i juaj këtu, me vlera madhore kombëtare. Përderisa ju flisni për bashkim kombëtar, ju nuk keni asnjë vlerë atdhetare, dhe për këtë ju duhet të jeni të kujdesshëm që sot ju të kurseheni nga patriotizmi fasadues, dhe ta keni vëmendjen se sheshi "Adem Jashari",

Kryesuesi: Ju lutem, ju lutem, le ta kryejë ky, e merrni fjalën, mos, ju lutem, sepse minutazha i takon, e merr fjalën dhe fol ti, po edhe ne nganjëherë nuk jemi të obliguar me ju dëgjuar juve.

Leutrim Retkoceri: Kërkesa e GP të PDK-së është, zonjë, e di që ju dhemb, zonjë, mirëpo ky është realiteti dhe e mbron këtu.

Kryesuesi: Replikë, po, pasi që ta ka përmendur emrin.
Urdhëro edhe 10 sekonda i ke.

Leutrim Retkoceri: Pasi që ta përfundoj unë Adrian, se nuk besoj që ke me thënë diçka të madhe. Qëndrimi i GP të PDK-së është i qartë, sheshi "Adem Jashari" nëse e mban këtë emër, duhet ta ketë edhe shtatoren, përndryshe nuk shkon...(Jashtë mikrofonit).

Kryesuesi: ...(Jashtë mikrofonit) Është çështje e ndjeshme, shumë e ndjeshme, edhe sheshi nga ky kuvend, jo ndoshta nga krejt këta njerëz këtu, por Kuvendi i Komunës ka vendos që të quhet sheshi Adem Jashari, kurrkush nuk besoj që ka kundër kësaj, por me që është çështje e ndjeshme, ka hy në rend dite qysh hyni, unë mendoj që për sot jemi të pa përgatitur për këtë çështje. Unë prej këtu e ftoj edhe kryetarin e Komunës këtu me qenë, sepse është çështje e ekzekutivit, ku po e dimë ne a ka pengesa, a nuk ka pengesa, me u vetë ne këtu, ne edhe kishën atje nuk e kishim lënë. Po i dhamë një kohë, një distancë kohore ekzekutivit, le ta mendon mirë këtë çështje, po sheshi nga ky kuvend është emërtuar Sheshi Adem Jashari. Na mundemi këtu me u paraqit patriotë mbi patriotë, por

duhet me e dit në çfarë suate po jetojmë, ku po jetojmë, unë nuk isha lidhë këtu a me heq hiq këtë këtu, por kisha menduar që të hiqet kisha, por a mundemi me e heq? Ju lutem, kaq, jo ndërhyrje ju lutem, e qetësojmë situatën e merr fjalën. Unë kisha thënë ta dëgjojmë ekzekutivin më së miri, pas ekzekutivit e merr fjalën, ta dëgjojmë ekzekutivin çka flet pastaj e ka fjalën Adriani.

Yll Rugova: Veç kisha dashur edhe një herë, d.m.th. që me u munduar mos me qenë patetik në diskutimin dhe ligjëratën tonë. D.m.th. është normale dhe po besoj që kurrkush në këtë sallë nuk ka dyshime në vlerat e Adem Jasharit, dhe nuk është diskutimi këtu a është vlerë Adem Jashari, apo jo. Ne krejt atë po e dimë, çështja është po me këtë shesh i cili e ka këtë emër, dhe a duhet ta ketë këtë emër apo mund ta ndryshojmë, është ky kuvend që ia ka jap këtë emër, prandaj unë nuk po e shoh që është ndonjë problem shumë i madh, nëse vendosim me e ndërruar e ndërrojmë. Sa i përket çështjes çfarë vlera ka ky objekt, më duhet veç diçka me ju treguar. Ai objekt monument e shënjon luftën kundër nazizmit, edhe unë tash po ju këqyri të gjithëve, nëse dikush prej juve mendon që lufta kundër nazizmit nuk ka qenë luftë e mirëfilltë e lirisë, atëherë unë nuk e di çfarë problemi kemi ne si shoqëri. Pra, nazizmi ka qenë po ashtu një regjim i vështirë, i cili krejt Evropën e ka shkatërruar, d.m.th. arsyeja pse Millosheviqi është krahasuar me atë regjim, është edhe arsyeja pse është intervenuar në Kosovë. Millosheviqi pra, ka qenë një lloj krahasimi me nazizmin. Tash nëse ju mendoni që nazizmin ne duhet me e pasur si vlerë edhe çlirimin ndaj nazizmit mos me e shënjuar në qytetin tonë. Atëherë, unë nuk e di në çfarë shoqërie jemi duke jetuar, sinqerisht, nuk e di në çfarë shoqërie jemi duke jetuar.

Kryesuesi: Ta dëgjojmë, Adriain, e merrni fjalën, pastaj nënkryetari.
Urdhëro Adrian, urdhëro!

Adrian Berisha: Është shumë e dhembshme, patetike, paragjykuese, me menduar që unë apo çdonjëri këtu, jemi kundër familjes Jashari, apo bustit, apo sheshit "Adem Jashari"! Unë asnjëherë nuk e thash që jam kundër, unë thash na duhet me gjetur zgjidhje, duke i mbrojtur monumentet historike, duke e ruajtur memorien kolektive. Ndërsa sa i përket gjykimit, ne të LVV-së, apo cilitdo grup, partisë të cilës i takon zotëria atje në fjalë, nuk e lejon asnjë përfaqësues me hy në odën e familjes Jashari tash e pesë vite, asnjë nuk munden me hy, a po e din, tash pasi po më shtynë me fol.

Kryesuesi: Po, po, mos të komentoj unë, veç dijani që është i emëruar ai shesh.
Fjalën e ka nënkryetari.
Urdhëro!
Të dëgjohemi.

Nënkryetari, Selim Pacolli: Unë mendoj që ishte një vullnet i mirë, dhe po japim një konotacion të pahijshëm pikërisht figurës më të rëndësishme të kombit tonë. Unë plotësisht e përkrah mendimin e Migjenit, plotësisht, po edhe unë jam i mendimit që Adem Jashari nuk mund të jetë në krahë të një përmendoreje, e cila është ngritur ndoshta për një bashkim-vëllazërim, apo, që tha edhe Ylli, që ajo na qenka një përmendore e cila

është ngritur kundër nazizmit. Në kohën e nazizmit, ne jemi të gjithë dëshmitar që e kemi dëgjuar së paku prej baballarëve tanë, që ne i kemi pasur dy grupe të cilat kanë luftuar aty, por e kemi pasur një realitet që në atë kohë i kemi pasur të gjitha trojet etnike në një kufi, edhe kjo ka qenë, Ylli, një realitet tjetër. Unë jam i atij mendimi, që ndoshta do ishte mirë që të mendojmë që diku tjetër ta gjejmë sheshin e Adem Jasharit, ose ajo duhet të hiqet, definitivisht, se figura e Adem Jasharit nuk e ka vendin krah për krah, ose duhet ta ngremë më të madhe dhe më të lartë sesa ajo që është aty, nëse ne jemi të mendimit, nëse jemi ata të cilët ngrehim shtatoren e Adem Jasharit më të lartë se ajo që është aty, atëherë unë sigurisht që jam i mendimit që të bisedojmë në një rrafsh tjetër. Mirëpo një shtatore e Adem Jasharit sado qoftë e madhe, nuk mund të jetë e barabartë me atë që ne sot e kemi aty. Nuk dua të paragjykojë të kaluarën e askujt, mirëpo unë e di që në të gjitha sistemet e kaluara ky popull ka vuajtur, mos t'i numëroj të gjitha masakrat rend ku kanë ndodhur, edhe ajo që e ceku Bimi, e Tivarit, e Bihorit, është edhe e Novi Pazarit, e Drenicës, e Gollakut, e kemi Prapashticën, e sa e sa që vetëm për 4 net 1081 vetë janë masakruar, janë djegur aty, kemi shumë të shumta, kemi aq vuajtje, sa që unë nuk besoj që ajo është një vlerë e cila i mbron interesat e kombit tonë aty. Mirëpo, mbi të gjitha, unë nuk jam për ta shkatërruar të kaluarën tonë, qoftë edhe të hidhur, qoftë edhe të hidhur, kemi me çka duhet një ditë t'i vendosim pllakat e përkujtimeve tona dhe të kaluarën tonë. Në këtë rast, çështja e sheshit Adem Jashari, ju jeni ata, ju, nuk po flas personalisht, por ky kuvend, i cili e ka vendosur emrin e atij burri, e atij heroit tonë, por nuk e di me çfarë mendimi e ka pas, thjesht, që duhet të vendoset pikërisht në atë vend aty, dhe ajo shtatore aty të jetë, ose ai obelisk apo përmendore, a si ta quaj. Në këtë rrafsh, unë ju them që ndoshta sonte ne mundemi të bisedojmë deri në mëngjes, por nuk mund të marrim vendime, sigurisht. Unë prapë po kthehem dhe po them që duhet të mendojmë mirë, nuk jemi duke folur për një "X" person, mirëpo jemi duke folur për figurën qendrore të UÇK-së, luftë e cila neve na solli liri. Unë e kam thënë edhe para disa ditëve këtu, pikërisht në këtë foltore, që lirinë e kemi fituar vetë ne, është gjaku ynë, është gjaku i atyre dëshmorëve, i atyre martirëve, i atyre nënave dhe motrave tona, të cilët, unë jam njëri nga ata që e kanë varros një nënë me të dy këmbët e këputura prej mitralozëve të serbëve, dhe një fëmijë të saj e kam gjetur 100 m më poshtë, e ne sot po bisedojmë ende se çka ne duhet të bisedojmë, apo çka ne duhet të mendojmë për përmendoret e partizanëve këtu! Jo, në asnjë mënyrë, jo! Po flasim për Adem Jasharin, të lutem, është pikë shumë e ndjeshme.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar!

Fjalën e ka Sami Borovci.

Urdhëro!

Sami Borovci: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, diskutimi im nuk ka të bëjë, ose nuk ka me qenë folklorik, mirëpo unë veç po dua me jap një kontribut timin në lidhje me këtë temë. Mirë që e propozoi Migjeni këtë temë, edhe pse normalisht është, se jemi të pa përgatitur ndoshta edhe ne edhe ekzekutivi me diskutuar, por do të mundohemi që disa rekomandime tona me i dhënë në këtë rrafsh. E para, unë mendoj që ka kaluar koha që në emër të familjes, ose familjeve të

dëshmorëve, ose të dëshmorëve, ose në emër të luftës me përfituar politikisht. Këtë nuk guxojmë asnjëri prej neve me e përdor ose me e përmend këtë për interesa të caktuar, të cilat mundën me qenë edhe politike. Unë personalisht mendoj që ndoshta se edhe për atë duhet me qenë shumë të kujdesshëm çfarë vendimit të marrim, se ndoshta mundemi me e marrë në qafë të ardhmen e Prishtinës. Qenka marrë ky vendim në vitin 2005, që me u quajtur sheshi "Adem Jashari", ndoshta edhe unë nuk pajtohem shumë që ky shesh me u quajtur sheshi "Adem Jashari". Prandaj unë, nëse ka hapësirë po e them ligjore dhe nëse është e mundur, kisha rekomanduar që me iu ndërruar emri këtij sheshi, le të quhet në çfarëdo forme. Gjithashtu, besoj shumë që një shtatore e Adem Jasharit duhet patjetër me qenë në Prishtinë, mirëpo Prishtina duhet me e planifikuar shumë kujdesshëm këtë. Ka pas p.sh. zëra që nuk e di saktë nëse ka diçka konkrete, mirëpo kemi pasur zëra se do të vazhdohet sheshi prej hotelit "Grand" deri te katedralja, ndoshta ky shesh mundet me u quajtur Adem Jashari dhe pikërisht në këtë shesh me u vendos busti i heroit tonë Adem Jashari. Prandaj, unë kisha kërkuar që në një seancë të ardhshme, ekzekutivi me i marrë parasysh këto rekomandime tona, edhe me u trajtuar ndoshta shumë më kujdesshëm që me i pa të gjitha format, ndoshta mundemi me e nderuar emrin, ndoshta mundemi me e gjetur një zgjedhje më të mirë, mirëpo as unë nuk po pajtohem që është zgjidhja më e mirë që me u ndërtuar një shesh i cili quhet Adem Jashari, i cili nuk e ka një bust, mirëpo është kontestuese edhe me e vendosur bustin në situatën aktuale në të cilën është ky shesh se si planifikohet me u ndërtuar.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Veç ta kemi parasysh, d.m.th. një herë për një pikë të rendit të ditës me e marrë fjalën e jo 2, 3, 4, e 5 herë, se do të mbesim deri vonë.

Urdhëro, Egzon!

Egzon Azemi: U ndërlidh me atë që e thash në fillim, pa e dit që ka me përfunduar debati kështu. Mos t'i japim rëndësi veç kësaj simbolikes, a e din, këtij imazhit, hajde ta bëjmë një shtatore dhe le tani aty se u krye, ia kryem borxhin Ademit. Më herët, në fillim thash qysh, po përmendorja e Zahirit ekziston fatmirësisht, është në shesh aty, mirëpo fatkeqësisht qysh e thash edhe më herët, prej asaj shtatoreje nga institucionet tona, fatkeqësisht, të cilat partia e juve është në këtë rast në pushtet, u largua flamuri dhe kurrkush nuk jep përgjegjësi, as nga institucionet këtu kurrkush nuk e ka ngritur këtë rast, as nuk kanë kërkuar leje as kurrgjë, veç e kanë tërhequr flamurin kombëtar. A duhet me u shqetësuar edhe për këtë punë, apo veç me tentuar me përfituar politikisht Leutrim? Qe 20 vjet, sidomos ju, keni përfituar në emër të Adem Jasharit, familjes Jashari, derisa, qysh e tha edhe Adriani, tash familja ua ka mbyllë derën përfaqësuesve të juaj partiakë. Nuk e keni fajin as ti as Migjeni për këtë çështje, e di unë atë punë, a më të paktën po dua me të thënë, mos u mundo me përfituar me këto sende politikisht. Po kur ja nisë me akuzuar, ju jeni ashtu, ju kështu, ti kështu, kurrkush nuk ke kundër, thjesht, ishim duke diskutuar ku më mirë a aty, a këtu, këtë debat mundemi me e bërë, por jo asi akuza të ulëta, jo je duke bërë debat të ulët, është e pandershme. Prandaj po kërkoj që përveç që të ketë shtatore të dëshmorëve, komuna, Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria e

Shërbimeve Publike, të kenë kontroll të vazhdueshme ndaj tyre, edhe në mirëmbajtjen e tyre. E kemi sot pllakën e Rexhep Malës e Nuhi Berishës në Kodër të Trimave, e cila ka mbetur aty qe sa vjet e vendosur, asnjëherë kurrkush nuk shkon me këqyrë në çfarë gjendje është, as me e fshi se le më diçka tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit!

Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit.

Urdhëro, drejtor!

Brahim Mehmetaj: Egzon i nderuar, unë me qëllim desha me e lënë nën pikën “Të ndryshme” këtë, por po e them tash që te shtatorja “Zahir Pajaziti” momentalisht nuk është asnjë flamur dhe aty do të vendosen shumë shpejt flamuri kombëtar dhe flamujt tjerë që i takojnë asaj shtatoreje. Kjo përkujdesje do të bëhet edhe për vendet tjera ku janë ndërtuar komplekset e dëshmorëve që janë në komunën e Prishtinës, pavarësisht që është një agjension apo institut për mbrojtjen e monumenteve historike, që nuk po merret me këto tema, po tash e tutje kjo çështje ka me u zgjedhur. Unë do të jem në përkujdesje të kësaj pune nonstop. Shumë shpejtë do të vendosen flamujt te sheshi “Zahir Pajaziti”, i kam fotografitë tash të çastit prej aty, që mi kanë dërguar, që nuk është asnjë flamur aty, kështu që kjo punë do të zgjidhet shpejt.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Besnik Mujeci!

Besnik Mujeci: Askush nuk e mohon luftën çlirimtare dhe nevojën që në Prishtinë të vendoset një shtatore e heroit tonë kombëtar Adem Jashari. Adem Jashari ka mbetur në kujtesën tonë si figura kryesore e lirisë tonë, sheshi do të rinovohet, monumentet nga e kaluara që kanë mbetur nga koha e ish-Jugosllavisë, e cila për neve shqiptarëve ka qenë shtypëse, besoj që duhet të mbesin, sado pak që të na përkujtojnë të kaluarën tonë. Që nga Lufta e Dytë Botërore, historia e jonë kolektive është shkatërruar sistematikisht, njëherë nga serbët, pastaj nga keq qeverisjet e pasluftës. Pak monumente kanë mbetur nga periudha otomane, pak nga koha e ish-Jugosllavisë, duke vazhduar që të shkatërrojmë monumente, në të ardhmen rrezikojmë që të humbim edhe kujtesën kolektive. Andaj, kisha propozuar që sheshit Adem Jashari t’i ndërrohet vendi, pasi që nuk po dëshirojnë që aty të vendoset shtatorja e tillë dhe të bëhet një shesh me emrin dhe me shtatoren e tij, dhe ky të mbetet si Sheshi i lirisë dhe të mbetet ajo përmendore nga e kaluara.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Mimoza Sylejmani.

Mimoza Sylejmani: Faleminderit, kryesues!

Unë veç desha me u ndërlidh, pasi i takoj edhe profesionit, jam arkitekthe e urbaniste me profesion. Ne fatkeqësisht nuk kemi sheshe të mirëfillta, këto nuk janë sheshe, janë mini

sheshe, nëse një sheh nuk ka distancë qysh e ka sheshi "Ibrahim Rugova" prej sheshit "Skënderbeu". Unë atëherë isha studente dhe kam qenë kundër idesë të vendosjes së shtatorës së Skënderbeut në atë lokacion, fillimisht ka qenë në gropë, unë mendoj që Skënderbeu është shumë i madh për tu futur në gropë. E dyta, këto monumente nuk vendosen nëpër gropa dhe afër ndërtesave të larta, qysh e kemi ndërtesën e Qeverisë në këtë rast, kështu që nuk vihet re Skënderbeu, është shumë i madh. Prandaj desha me u ndërlidhur edhe te sheshi "Adem Jashari". Këtu bëhet vetëm një ndërrim i pllakave, nuk është diskutuar, unë mendoj që ose të futet në referendum për me e vendosur, unë nuk jam për me e hequr, se nëse e shohim në Berlin është Muzeu i jevrejve, i cili kujton memorien e vuajtjeve të jevrejve, atëherë unë mendoj që fillimisht ju ka lënë gabimisht emri, unë së paku personalisht mendoj kështu. Po ashtu, Ibrahim Rugova është njeri i madh ndoshta për me pasur distancë aq me Skënderbeun, po ashtu edhe Zahir Pajaziti, por në mungesë të lokacioneve i kemi futur kështu dhe po i quajmë sheshe, në fakt nuk janë sheshe. E dyta, unë shumë jam brengosur kur kam dëgjuar që ju ka lënë tek rrethrotullimi tek flamuri, aty emri Adem Demaçi, aty thjeshtë është një kryqëzim i rrugëve, dhe në të ardhmen kur nuk ka me qenë më, dhe t'i ndërtojmë ndoshta një bust, nuk është vendi i qëlluar, se tashmë aty është edhe Parku i sapo të martuarve. Kaq kisha, veç desha me ju shpjeguar që këto asnjë nuk janë sheshe sipas urbanizmit. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Fjalën e ka Leutrim Retkoceri.

Urdhëro!

Leutrim Retkoceri: Faleminderit, kryesues!

Unë e ndjeva obligim pak me sqaruar pas këtyre diskutimeve. Ideja për me e shmangur këtë çështjen e kësaj që e ngritëm në gjëra minore, sigurisht e ka një prapavijë, dhe kjo është për me të ardhur keq. Tjetra, disa kolegë këtu, si Egzoni p.sh., kur na drejtohet neve për vlerat e luftës, është mirë me e ditur me kanë po flasin edhe çka po flasin dhe kush po i manipulon vlerat e luftës, kush i manipulon ndjenjat kombëtare, është mirë edhe këtë me e ditur. Është mirë me e ditur për çka ju kanë vrarë njerëz në shesh juve, edhe ku janë sot ata? Duhet me e ditur edhe këtë, duhet me e ditur se kur fol për flamurin kombëtar, duhet më e ditur që më i rëndësishëm është,

Kryesuesi: Leutrim, të lutem, rreth pikës së rendit të ditës të

Leutrim Retkoceri: Heroi i atij flamuri, tani flamuri, edhe kur t'i dinë këto gjëra, atëherë është mirë me fol sinqerisht në atë që e ndien, përndryshe të bënë me u skuqur dhe me të ardhur keq prej fjalëve që i fol. Kalofsh mirë, se kjo është përgjigjja më e mirë që ju jep ti këtyre temave dhe këtyre vlerave. Çështja është shumë e thjeshtë në atë që e ngritëm, mirëpo duhet një vullnet politik i sinqertë për me e qar një çështje që 20 vjet i mungon kryeqytetit, shtatorja e Adem Jasharit. Nuk është shumë as pak, është një obligim moral thash për të gjithë, të gjithë neve, mirëpo dikush kur flitet për këtë temë, më mirë i konvenon me dal jashtë se sa me ndej edhe me diskutuar.

Faleminderit!

Kryesuesi: Ardian, ti je në sallë të Kuvendit, Ardian.
Fjalën e ka Mustafë Krasniqi, edhe ndoshta je i fundit se

Mustafë Krasniqi: Po shpresoj që do ti japë fund këtij debati që u zhvillua dhe mirë që u caktua si rend dite, së paku si debat që u zhvillu këtu. Unë e kuptova arsyen që ndoshta informacionet nuk kanë qenë edhe të kolegëve edhe tonat se çka në fakt është kah ndërtohet. Tash prej drejtorit ne e morëm vesh që thjeshtë është një investim për mirëmbajtje të këtij sheshi, do të thotë rregullimi i pllakave, dhe assesi nuk diskutohet për vendosjen e shtatores së Adem Jasharit. Unë plotësisht pajtohem që, pavarësisht që si shesh është emëruar në vitin 2005, që nuk kam qenë në atë mandat, mirëpo ndoshta nuk ka pasur hapësirë tjetër, megjithëse është diskutuar dhe është kërkuar ndoshta edhe prej GP të PDK-së në atë kohë, është menduar që mund të jetë adekuat si shesh që mund të vendoset emri i heroit kombëtar Adem Jashari. Tash a shkon shtatorja dhe sheshi me këtë pjesën tjetër çka simbolizon, edhe unë mendoj që jo, tash a ia vlen të rrënohet apo jo, ajo është temë tjetër, mirëpo unë këtu mendoj që gjithsesi duhet të vjen një kërkesë prej neve, ose prej kujtdo qoftë prej këtyre që e ngritën çështjen, dhe të merret të analizohet mirë ku mund të gjendet një shesh adekuat, me përmasa edhe më të mëdha që kishte me iu përgjigj tamam edhe si shesh “Adem Jashari”, por edhe të punohet shtatorja në atë vend. E këtu le të rregullohet, le të shërbejë për qytetarët ashtu siç ka shërbyer deri tash.
Faleminderit, kryesues!

Kryesuesi: Faleminderit shumë.
Atëherë, kalojmë,
A e deshe fjalën nënkryetar?

Selim Pacolli:...(Jashtë mikrofonit) zgjidhet, jo, jo nuk ka problem, që të jetë si inicim i sigurimit të një zone diku për sheshin “Adem Jashari”, do të thotë kjo që e tha edhe Mustafa, kjo veç është iniciativa e Migjenit dhe kjo çështje duhet të zgjidhet. Ne nuk mund të kemi sot një kryeqytet dhe mos ta kemi një shesh të heroit kombëtar, siç është Adem Jashari. Tash, a e lëmë na këtu apo diku tjetër, unë vetëm një e di, që ajo përmendore aty me Adem Jasharin nuk kanë të bëjnë me kurrëgjë të përbashkët, definitivisht unë nuk jam për me e rrëzuar, por jam për mos me i lënë bashkë aty, sepse nuk shkojnë të dy bashkë. Këtu janë dy kohëra të ndryshme, nuk dua të paragjykoj as të kaluarën, as të ardhmen, mirëpo sheshi Adem Jashari duhet të ekziston në kryeqendrën e Prishtinës. Është e vërtetë që ne e kemi një rrugë që e kemi shndërruar në shesh, e kemi 15 shtatori, deri në fund atje, por ajo që është më kryesore, pa dashur që të minimizohet vepra e askujt, ne nuk e kemi, nuk e kemi. Pati edhe propozime tjera, dikush tha te katedralja, te katedralja është sheshi, nëse nuk gaboje “Xhorxh Vashington Bush”, po sigurisht edhe është diku në procesverbale, që në vitin 2009, kam qenë pikërisht unë që e kam kundërshtuar emërimin e atij sheshi, aty kam kërkuar që të jetë emri i Adem Jasharit, ndoshta në këtë legjislacion do ta kthejmë emrin e tij aty.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar!

Zotëri, Halim Halimi.

Halim Halimi: Tash nuk kemi edhe kuorum, është mirë që u biseduar për këtë çështje, mirëpo gjithmonë duke e pas parasysh që sheshi është emëruar "Adem Jashari". Unë jam dëshmitar i asaj kohe, vend më të mirë atëherë nuk ke pas kurrkund, se atëherë nuk i kemi pasur këto sheshet që i kemi, po analizojeni mirë, sidomos, se ne e dëgjuam edhe prej drejtorit, plotësisht pajtohem, analizojeni mirë këtë punë, është çështje shumë, shumë e ndjeshme. Edhe njëherë po them, të gjithë ne jemi që për Adem Jasharin është pak ai vend, po ne jemi në këtë qytet, unë dëgjova se nuk është shesh, nuk është, po ne nuk kemi sheshe tjera, këto tri sheshe i kemi, atë rrugë e kemi, dhe ne i quajmë sheshe. Kështu që le ta analizojë mirë ekzekutivi që ka far mundësie, që nuk kemi ndonjë far pengese qysh e dimë ne, pse jo, le të jetë veç sheshi "Adem Jashari" aty. Nëse ka pengesa, pengesa prej Institutit të Trashëgimisë së Kosovës, apo UNESCO, apo këtu përzihen shumë, analizojeni mirë, është mirë që biseduam, dëshira e secilit këtu është që sheshi të jetë i Adem Jasharit, dhe veç shtatorja e Adem Jasharit aty, por ekzekutivi le ta analizojë këtë çështje, e jo ne të ngutemi, pa u përgatitur të marrim vendime, se vendimi është sheshi "Adem Jashari" dhe, kuptohet që në sheshin "Adem Jashari" duhet të jetë vetëm shtatorja e Adem Jasharit, dhe unë mendoj që është e pakuptim që sheshin "Adem Jashari" me e qitur përballë atij trekëndëshi.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, zoti Halimi!

Atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Të ndryshme.

Kryesuesi: A ka dikush diçka?

Nuk ka.

Faleminderit shumë!

Atëherë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 16:55.